


RAPORTI VJETOR 2025

Inspektimi i Punës në Epokën Digjitale
VEPRIM, INOVACION, INTEGRITET



Raporti Vjetor 2025 i Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore paraqet rezultatet kryesore të veprimtarisë inspektuese dhe zhvillimet institucionale gjatë vitit raportues.

Dokumenti pasqyron progresin në garantimin e zbatimit të legjislacionit të punës, mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve dhe forcimin e standardeve të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Përmes këtij publikimi, **ISHPSHS** synon të rrisë transparencën institucionale dhe të kontribuojë në ndërtimin e një tregu pune më të drejtë dhe më të sigurt.

PËRMBAJTJA

7.....	Përmbledhje e Përgjithshme
12.....	Hyrje
15.....	Qëllimi dhe Metodologjia
17.....	Përgjegjësitë Specifike Institucionale
21.....	Arritjet Kryesore
26.....	Përbërja Organizative dhe Organigrama
30.....	Analiza e Çështjeve sipas Kompetencave të ISHPSHS
30.....	Planifikimi i Inspektiveve
35.....	Inspektimi i Marrëdhënieve të Punës dhe Administrimi i Ankesave
49.....	Siguria dhe Shëndeti në Punë
57.....	Analiza e Treguesve Statistikorë të Inspektimit
98.....	Komunikimi dhe Informimi Publik
105.....	Buxheti dhe Menaxhimi Financiar
108.....	Inspektimi i Standardeve të Shërbimeve Shoqërore
112.....	Aktivitete dhe Publikime
114.....	Sfida të Hasura
115.....	Objektivat Kryesore Strategjike (2026)



Delina IBRAHIMAJ

Ministër i Ekonomisë dhe Inovacionit

Formalizimi dhe Siguria në Punë, Një Hap Përpara për Shqipërinë.

Viti 2025 konfirmon angazhimin e palëkundur të Qeverisë Shqiptare për forcimin e formalizimit të ekonomisë, luftën kundër informalitetit dhe garantimin e standardeve më të larta të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Përmes politikave të integruara dhe zbatimit të strategjive kombëtare, si Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (NEES) dhe dokumenti strategjik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, si dhe përmes reformave ligjore, përfshirë reformën në fushën e inspektimeve, dhe mbështetjes së vazhdueshme institucionale ndaj Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, prioritet mbetet ndërtimi i një tregu pune të drejtë, transparent dhe konkurrues.

Formalizimi i marrëdhënieve të punës, rritja e ndërgjegjësimit të punëdhënësve dhe punëmarrësve, si dhe forcimi i kulturës së parandalimit në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë përbëjnë elementë kyç të vizionit tonë për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe mbrojtje efektive të të drejtave të punëmarrësve në Shqipëri, në përputhje të plotë me agjendën dhe angazhimet e vendit në kuadër të procesit të integrimit në Bashkimit Evropian.



Eljo MUCAJ

Kryeinspektor

Inspektimi i Punës në Shërbim të një Tregu Pune të Drejtë dhe të Sigurt.

Viti 2025 shënon një fazë të rëndësishme në konsolidimin dhe modernizimin e sistemit të inspektimit të punës në Shqipëri. Si Kryeinspektor, ritheksoj angazhimin e plotë të Inspektoratit Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore për forcimin e kapaciteteve institucionale, rritjen e cilësisë dhe profesionalizmit të inspektimeve, si dhe thellimin e dixhitalizimit të proceseve të punës.

Përdorimi i teknologjive të avancuara, përfshirë sistemet e analizës së riskut dhe mjetet digjitale në terren, ka rritur objektivitetin, transparencën dhe efektivitetin e veprimtarisë inspektuese. Lufta ndaj informalitetit, në të gjitha format e tij, si dhe forcimi i masave për zbatimin e standardeve të sigurisë dhe shëndetit në punë, veçanërisht në sektorët me risk të lartë do të vijojnë të jenë në qendër të çdo ndërhyrjeje inspektuese.

Njëkohësisht, bashkëpunimi me autoritetet ligjzbatuese në vend dhe me partnerët ndërkombëtarë do të mbetet një shtyllë e rëndësishme në përmbushjen e misionit tonë për mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve dhe ndërtimin e një tregu pune të drejtë, të sigurt dhe konkurrues.

SUBJEKTE TË INSPEKTUARA JANAR - DHJETOR 2025

9,532

Subjekte të inspektuara

8,086

Subjekte të inspektuara mbi bazë risku

19,679

Subjekte të reja janë këshilluar për të drejtat dhe detyrimet nga Legjislacioni Punës

963

Inspektim për shkak Ankesë, **40%** më shumë krahasuar me 2024, **70%** në favor të punëmarrësve.

4,192

Paralajmërimë **132%** më shumë

1,269

Pezullime

A photograph of a construction site at dusk or dawn. In the foreground, a white traffic cone with red diagonal stripes and a yellow light on top is the central focus. Other similar cones are visible in the background, receding into the distance. The ground is dark asphalt with red lines. The background shows a blurred building and trees. The overall lighting is dim, with a warm glow from the sky.

NJË TREG PUNE MË I DREJTË DHE MË I SIGURT

Rezultatet dhe Transformimi Institucional 2025

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, në Raportin Vjetor 2025, paraqet në mënyrë të përmbledhur rezultatet e veprimtarisë inspektuese zhvillimet institucionale, përdorimin e teknologjive të avancuara dhe sfidat që shoqërojnë procesin e inspektimit të punës në Republikën e Shqipërisë. Për hartimin e raportit janë përdorur të dhëna statistikore dhe analiza teknike të detajuara, të mbështetura në metodologji bashkëkohore për mbledhjen, përpunimin, vlerësimin dhe interpretimin e informacionit.

Misioni i ISHPSHS mbetet garantimi i kushteve të denja, të sigurta dhe të shëndetshme të punës, nëpërmjet një sistemi inspektimi profesional, transparent dhe të përgjegjshëm. Gjatë vitit 2025, institucioni ka vijuar të forcojë kapacitetet institucionale, njerëzore dhe teknike, duke rritur cilësinë e inspektimeve të bazuara në risk, vlerësimin të vazhdueshëm të indikatorëve të performancës dhe duke avancuar procesin e digjitalizimit të funksioneve inspektuese dhe monitoruese.

Një prej zhvillimeve më të rëndësishme ka qenë zbatimi i Sistemit MIRA – Matrica e Inteligjencës dhe Analizës së Riskut, platformë moderne e bazuar në teknologjitë e inteligjencës artificiale si data mining dhe machine learning. Ky sistem ka mundësuar standardizimin e vlerësimit të shkeljeve, unifikimin e vendimmarrjes inspektuese dhe automatizimin e programimit të inspektimeve mbi bazë risku. Integrimi i proceseve në një sistem të vetëm ka rritur ndjeshëm efikasitetin institucional dhe ka lehtësuar identifikimin e sektorëve apo subjekteve që kërkojnë vëmendje të shtuar dhe ndërhyrje prioritare.

Gjatë vitit 2025 janë inspektuar 205,196 vende pune në 9,532 subjekte, duke shënuar një rritje prej 27.7% të inspektimeve në subjekte të reja. Një kontribut të rëndësishëm në këtë rritje ka dhënë planifikimi i bazuar në risk, si dhe bashkëpunimi i përmirësuar ndërinstucional, veçanërisht me DPT dhe QKB. Fokus i veçantë i inspektimeve ka qenë identifikimi i informalitetit në marrëdhëniet e punës, i shfaqur në të gjitha format e tij, si dhe zbatimi i standardeve të sigurisë dhe shëndetit në punë në sektorët me risk të lartë. Gjithashtu, janë intensifikuar kontrollet për zbatimin e legjislacionit për punëmarrësit nën 18 vjeç dhe për punëtorët e huaj.

Në kuadër të luftës kundër informalitetit, gjatë vitit 2025 janë identifikuar 2,591 punëmarrës informalë, ku 98% e tyre janë formalizuar brenda procesit inspektues. Gjithashtu, janë konstatuar 2,999 punëmarrës pa kontrata pune, çka përfaqëson një ulje prej 24% krahasuar me vitin 2024. Formalizimi i marrëdhënieve të punës ka sjellë një kontribut shtesë prej 28,245,960 lekë në muaj në skemat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, duke reflektuar ndikim të drejtpërdrejtë pozitiv në qëndrueshmërinë e këtyre skemave.

Për shkelje të rënda ose të përsëritura të legjislacionit të punës janë vendosur 268 gjoba, me vlerë totale prej 64,584,000 lekë, duke shënuar rritje si në numër (28%) ashtu edhe në vlerë (20%) krahasuar me vitin 2024.

Niveli i ankimit të vendimeve administrative vijon të jetë në rënie të qëndrueshme, ku vetëm 21% e gjobave të vendosura gjatë vitit 2025 janë ankimuar administrativisht, në vijim të trendit ulës të evidentuar gjatë viteve 2020–2024. Nga 28 ankime të shqyrtuara nga trupa kolegjiale, 19 vendime janë lënë në fuqi, ndërsa vetëm 9 çështje janë dërguar për shqyrtim gjyqësor, duke përfaqësuar një reduktim të ndjeshëm krahasuar me vitin paraardhës.

Numri i ankesave dhe kërkesave të depozituara nga qytetarët arriti në 1,179 raste, duke shënuar një rritje prej 259 rastesh krahasuar me vitin paraardhës. Shkeljet më të shpeshta të evidentuara lidhen me mospagimin e ditëve të festave zyrtare, pushimeve javore, orëve shtesë, si dhe me mungesën e kontratave të punës. Nga totali i ankesave të trajtuara, **70%** janë zgjidhur në favor të punëmarrësve, ndërkohë që 100% e kërkesave për sqarime ligjore janë trajtuar brenda afateve ligjore.

Për vitin 2025 janë regjistruar 275 raste aksidentesh në punë, me 212 persona të aksidentuar, nga të cilët 48 me pasojë fatale, duke reflektuar një rritje krahasuar me vitin 2024. Si pasojë, inspektimet e kryera për shkak aksidenti janë rritur me 23%, ku në 100% të rasteve janë marrë masa administrative ndaj subjekteve, përfshirë raste të aplikimit të masave të shumëfishta për një subjekt të vetëm. Analiza e të dhënave tregon se pjesa më e madhe e rritjes së përgjithshme të aksidenteve lidhet me aksidentet rrugore të klasifikuara si aksidente në punë. Duke përjashtuar këtë kategori, rritja e aksidenteve të ndodhura drejtpërdrejt në vendin e punës rezulton e kufizuar, çka evidenton efektin parandalues të inspektimeve dhe masave të marra në sektorët me risk të lartë.

ISHPSHSH ka vazhduar të mbajë një rol dhe pozicion të rëndësishëm në proceset e integritetit evropian, duke kontribuar në hartimin e strategjive kombëtare, planeve të veprimit, përfrimit ligjor dhe dokumenteve të raportimit për kapitujt përkatës të acquis të Bashkimi Evropian. Paralelisht, institucioni ka dhënë kontribut thelbësor dhe të vazhdueshëm në përgatitjen e raporteve dhe angazhimeve ndërkombëtare ndaj organizatave si ILO, OKB/CESCR dhe UPR, duke forcuar përputhshmërinë e kuadrit kombëtar me standardet ndërkombëtare të punës dhe të të drejtave të njeriut. Në planin ndërkombëtar dhe rajonal, **ISHPSHSH** ka vijuar të luajë një rol aktiv përmes bashkëpunimit me organizata, institucione homologe dhe partnerë rajonalë, duke marrë pjesë në projekte mbështetëse, programe trajnimi dhe shkëmbim praktikash të mira. Një moment i rëndësishëm ishte nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit në maj 2025 me Inspektorati Qendror i Punës i Republikës së Kosovës, i ndjekur nga ai me Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi, me fokus forcimin e koordinimit rajonal dhe mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve në kushtet e lëvizshmërisë ndërkufitare. Bashkëpunimi me Organizatën Ndërkombëtare të Punës, me organizmat e Kombet e Bashkuara dhe me Departamenti Amerikan i Shtetit ka kontribuar në forcimin e kapaciteteve të inspektimit të punës, avancimin e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe përfrimin e mëtejshëm me standardet ndërkombëtare.

Bashkëpunimi ndër-institucional ka vijuar të jetë thelbësor për veprimtarinë e Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, duke forcuar koordinimin operacional, shkëmbimin e informacionit dhe efektivitetin e inspektimeve. Në këtë kuadër, bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Qendrën Kombëtare të Biznesit, Agjencinë Kombëtare të Punësimit, Komisionerin për mbrojtjen nga diskriminimi, Autoritetin e Mediave Audiovizive ka kontribuar në adresimin e punës së padeklaruar, informimin e subjekteve, mbrojtjen nga diskriminimi dhe përjashtimin e subjekteve të sanksionuara nga prokurimet publike. Në tërësi, këto mekanizma kanë harmonizuar veprimet institucionale dhe kanë rritur mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve. Gjithashtu, **ISHPSHSH** ka pasur një rol qendror në zbatimin e Ligjit nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përgatitjen e kuadrit nënligjor për garantimin e funksionimit efektiv të Inspektoratit Qendror


të Punës, duke kontribuar në konsolidimin institucional dhe rritjen e eficiencës së sistemit të inspektimit.

Në fushën e komunikimit publik, **ISHPSHSH** ka zbatuar një sërë fushatash sensibilizuese dhe ka forcuar ndjeshëm platformën informative, me synim rritjen e ndërgjegjësimit dhe përmirësimin e aksesit në informacion për subjektet e punës. Në këtë kuadër, janë krijuar seksione të posaçme në faqen zyrtare të institucionit, të dedikuara për punëmarrësit e huaj, punëtorët e postuar, punën nga shtëpia dhe telepunën, duke ofruar informacion praktik, të strukturuar dhe shumëgjuhësh mbi të drejtat e punëmarrësve, detyrimet e punëdhënësve dhe mekanizmat institucionale të mbrojtjes.

Paralelisht, përmes platformës e-Albania janë informuar 16,396 subjekte të reja, të cilat kanë marrë njoftime dhe orientime mbi detyrimet dhe të drejtat që rrjedhin nga legjislacioni i punës, duke kontribuar në rritjen e transparencës dhe parandalimin e shkeljeve.

Drejtoria e Inspektimit të Standardeve të Shërbimeve Shoqërore ka vijuar të luajë një rol thelbësor në garantimin e cilësisë dhe përputhshmërisë së shërbimeve sociale, duke kryer 134 inspektime në qendrat e përkujdesit shoqëror gjatë vitit 2025. Krahas trajtimit të ankesave dhe kërkesave të paraqitura nga përfituesit e shërbimeve dhe nga institucionet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, drejtoria ka ushtruar funksione vlerësuese edhe në lidhje me plotësimin e kriterëve të licencimit për subjektet e reja ofruese të shërbimeve shoqërore. Si rezultat i monitorimit dhe vlerësimit të përputhshmërisë me standardet ligjore dhe profesionale, është propozuar revokimi i licencës për 13 subjekte jopublike që nuk përmbushnin kriteret e përcaktuara.

Në tërësinë e tij, viti 2025 konfirmon forcimin e rolit institucional të Inspektoratit Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore si një aktor kyç në garantimin e standardeve të sigurisë dhe





 Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore

ARRITJET KRYESORE:

- ✓ Zbatimi i platformës e-inspektimit dhe integrimi i saj me sisteme të tjera
- ✓ Fuqizimi i planifikimit të inspektimeve të bazuara në risk
- ✓ Rritja e numrit të inspektimeve me 17.4%



 Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore

VLERËSIMI I RISKUT ME PËRDORIMIN E AI NËPËRMJET PLATFORMËS “MIRA”

Duke Përmirësuar Zbulimin e Punës së Padeklaruar me **30%**

✓

PROGrame të Përmirësuara Trajnimi për Inspektorët e Punës

shëndetit në punë, mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve dhe luftën kundër informalitetit. Përmes një qasjeje të bazuar në risk, rritjes së efektivitetit inspektues, përmirësimit të transparencës dhe forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, institucioni ka dhënë një kontribut të matshëm në përmirësimin e kushteve të punës dhe formalizimin e tregut të punës. Njëkohësisht, angazhimi aktiv në zbatimin e reformave ligjore dhe në proceset e integritetit evropian e pozicionon **ISHPSHSH** si një aktor thelbësor në harmonizimin e kuadrit kombëtar me standardet dhe kërkesat e Bashkimit Evropian, duke konsoliduar rolin e tij si garant i interesit publik dhe i një zhvillimi të qëndrueshëm institucional.

Një moment i rëndësishëm gjatë vitit 2025 ka qenë edhe vlerësimi pozitiv i bërë nga OECD në raportin Western Balkans Competitiveness Outlook 2024, i publikuar në vitin 2025, ku evidentohet progresi i Inspektoratit Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore në planifikimin e bazuar në risk, digjitalizimit dhe përdorimin e inteligjencës artificiale përmes platformës MIRA. Raporti thekson gjithashtu rritjen e kapaciteteve përmes programeve të përmirësuara të trajnimit për inspektorët e punës dhe forcimin e bashkëpunimit institucional. Megjithatë, ai nënvizon se vijimi i investimeve në forcimin e kapaciteteve, thellimin e digjitalizimit dhe konsolidimin e bashkëpunimit ndërinstitucional mbetet thelbësor për rritjen e përputhshmërisë dhe përmirësimin e kushteve të punës në Shqipëri.



**PËRMIRËSIMI I KUSHTEVE TË PUNËS-
THEMEL I PUNËS SË DENJË**

HYRJE

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore është autoriteti shtetëror përgjegjës për ushtrimin e funksioneve të inspektimit në fushën e marrëdhënieve të punës dhe shërbimeve shoqërore. Raporti i analizës vjetore hartohet në zbatim të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i cili hyri në fuqi më 13 maj 2025, dhe paraqet aktivitetet, rezultatet dhe arritjet e realizuara gjatë vitit 2025.

Veprimtaria inspektuese e **ISHPSHSH** shtrihet në të gjithë territorin e vendit dhe organizohet përmes gjashtë Drejtorive Rajonale, me 13 sektorë funksionalë në strukturën e tyre, duke garantuar mbulim të plotë territorial dhe operacional. Procedurat inspektuese realizohen në mënyrë elektronike përmes sistemit “e-Inspektimi”, i cili siguron transparencë, gjurmueshmëri dhe standardizim të procesit inspektues në kohë reale dhe në prani të subjektit të inspektuar. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 99/2024 dhe procesin e përditësimit të sistemit “e-Inspektimi” në përputhje me kërkesat e reja ligjore, një pjesë e procedurave inspektuese është zhvilluar përkohësisht në formë dokumentacioni të printuar (“inspektim shkresor”), i cili më pas ngarkohet në modulën përkatës elektronik. Kjo metodë e përkohshme është zbatuar për të garantuar vijimësinë e funksioneve inspektuese deri në përfundimin e harmonizimit të plotë të sistemit.

MISIONI

Misioni i **ISHPSHSH** është të sigurojë respektimin dhe zbatimin e legjislacionit të punës dhe standardeve të sigurisë dhe shëndetit në punë, përmes inspektimeve dhe kontrolleve që garantojnë kushte të sigurt të punës, respektimin e orarit, pagave dhe detyrimeve ligjore të palëve. Përmes masave administrative, këshillimit dhe ndërgjegjësimit, institucioni synon të promovojë një kulturë të zbatimit të ligjit dhe të përmirësojë kushtet e punës dhe mirëqenien e punëmarrësve.

DEKLARATA E MISIONIT

Të garantojë vende pune të denja, të sigurt dhe të shëndetshme përmes një sistemi inspektimi profesional dhe të përgjegjshëm, si dhe të promovojë kulturën e zbatimit të legjislacionit të punës në të gjithë vendin.

Në zbatim të ligjit nr. 9634, datë 30.10.2006 “Për Inspektimin e Punës”, (i ndryshuar me ligjin nr. 57/2017), **ISHPSHSH** ka këto përgjegjësi kryesore:

- Sigurimin e zbatimit të dispozitave ligjore që lidhen me kushtet e punës, mbrojtjen e punëmarrësve, kohën e punës, pagat, sigurimin, higjienën, mirëqenien, punësimin e fëmijëve, të miturve, grave dhe kategorive të tjera të veçanta.
- Ofrimin e informacionit teknik dhe këshillimit për punëdhënësit dhe punëmarrësit mbi mënyrat më efektive për zbatimin e legjislacionit të punës.
- Njoftimin e autoriteteve përgjegjëse për mangësi apo abuzime që nuk mbulohen në mënyrë specifike nga legjislacioni, si dhe propozimin e masave për përmirësimin e situatës.



**QARTËSI NË QËLLIM.
SAKTËSI NË VEPRIM.**

QËLLIMI DHE METODOLOGJIA

ISHPSHSH, si institucion ekzekutiv, ka për qëllim garantimin e zbatimit të ligjit në të gjitha proceset inspektuese dhe sigurimin e koherencës së veprimtarisë së trupës inspektuese me objektivat strategjike të institucionit. Objektivat kryesorë janë:

- Rritja e efektivitetit të procesit të inspektimit për të siguruar zbatimin e legjislacionit në subjektet e të gjithë vendit;
- Identifikimi dhe adresimi i rasteve të punësimit në kundërshtim me ligjin, si dhe referimi i tyre pranë institucioneve përgjegjëse;
- Monitorimi dhe raportimi i vazhdueshëm i cilësisë së procesit inspektues;
- Zhvillimi i sistemeve digjitale që rrisin profesionalizmin dhe mbështesin teknikisht inspektimin;
- Garantimi i transparencës dhe integritetit institucional gjatë procedurave inspektuese;
- Promovimi i kulturës parandaluese për vende pune të sigurtë e të shëndetshme, përmes këshillimeve dhe përdorimit të kanaleve digjitale.

Raporti vjetor për vitin 2025 paraqet treguesit kryesorë të inspektimit, arritjet dhe problematikat e evidentuara gjatë ushtrimit të detyrave inspektuese. Raporti përfshin gjithashtu konkluzione dhe rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë institucionale dhe për përcaktimin e objektivave për periudhën pasuese.

Metodologjia e hartimit të raportit bazohet në:

- Përpunimin e të dhënave statistikore të inspektimeve të kryera nga 6 drejtoritë rajonale;

- Analizën e problematikave të identifikuar nga gjetjet inspektuese;
- Krahasimin e trendeve pozitive dhe negative në zbatimin e legjislacionit të punës dhe standardeve të shërbimeve shoqërore;
- Konsultimin me legjislacionin për të identifikuar boshllëqe ose situata të pazbatueshme në praktikë, si dhe adresimin e tyre tek autoritetet përkatëse;
- Zhvillimin e metodologjive dhe platformave inovative që synojnë përmirësimin e proceseve inspektuese.

Instrumentet e mbledhjes së të dhënave në fushën e punës:

- Numri i inspektimeve të realizuara nga çdo inspektor;
- Lloji i inspektimeve të kryera;
- Lloji i aktivitetit ekonomik;
- Numri i aksidenteve në punë;
- Numri i ankesave;
- Treguesit e informalitetit;
- Punësimi i kategorive të veçanta (të mitur, të huaj);
- Shkeljet e dispozitave ligjore dhe masat administrative të vendosura.

Instrumentet e mbledhjes së të dhënave në fushën e shërbimeve shoqërore:

- Të dhëna mbi kapacitetet e qendrave të përkujdesit;
- Pyetësorë për menaxherët dhe drejtuesit e qendrave;
- Pyetësorë për punonjësit socialë;
- Intervista me përfituesit.

A construction site at dusk or dawn, featuring a large yellow crane in the background and a building under construction. In the foreground, three workers in safety vests and hard hats are reviewing blueprints. The ground is covered with rebar and red safety lines.

**AUTORITET, INTEGRITET
DHE KOORDINIM**

PËRGJEGJËSI SPECIFIKE INSTITUCIONALE

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore në zbatim të kompetencave të tij ligjore, garanton zbatimin e legjislacionit të punës, të sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe standardevë të shërbimeve shoqërore. Përmes ushtrimit të funksioneve inspektuese, monitoruese dhe këshilluese, institucioni synon mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve, forcimin e përputhshmërisë dhe rritjen e integritetit institucional.

SIGURIMI I INFORMACIONIT DHE ANALIZËS INSPEKTUESE

Mbledh, përpunon dhe analizon të dhëna mbi kushtet e punës, zbatimin e kohës së punës dhe pagesës, mbrojtjen e punëmarrësve, sigurinë dhe shëndetin në punë, higjienën dhe standardet në vendin e punës, si dhe mbi punësimin e të miturve dhe të huajve, përfshirë edhe hetimin e aksidenteve në punë. Të dhënat e analizuara shërbejnë për identifikimin e problematikave, vlerësimin e trendeve dhe orientimin e veprimtarisë inspektuese mbi bazë risku, me synim rritjen e efektivitetit dhe parandalimin e shkeljeve

PARANDALIMI I SHKELJEVE DHE QASJA KËSHILLUESE

Institucioni synon parandalimin e shkeljeve të ligjit përmes informimit dhe ndërgjegjësimit të punëdhënësve e punëmarrësve, duke promovuar përputhshmëri ligjore dhe reduktimin e shkeljeve të përsëritura.

MBROJTJA E KATEGORIVE VULNERABËL

ISHPSHSH siguron mbrojtje të posaçme për punëmarrësit nën 18 vjeç, punëmarrëset shtatzëna, personat me aftësi të kufizuara, si dhe punëmarrësit e huaj e migrantë, duke garantuar trajtim të barabartë dhe kushte të sigurta pune, në përputhje me legjislacionin dhe standardet e BE-së.

LUFTA KUNDËR INFORMALITETIT

Institucioni identifikon dhe adreson format e informalitetit, përfshirë punën e padeklaruar, mungesën e kontratës së punës dhe informalitetin në pagë, përmes inspektimeve të orientuara me risk, masave administrative dhe bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse.

TRAJTIMI I ANKESAVE DHE GARANTIMI I AKSESIT INSTITUCIONAL

ISHPSHSH shqyrton ankesat dhe kërkesat e punëmarrësve e subjekteve në mënyrë transparente dhe brenda afateve ligjore, duke kontribuar në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të punës dhe forcimin e besimit publik.

BASHKËPUNIMI DHE KOORDINIMI NDËRINSTITUCIONAL

Bashkëpunon me autoritetet kombëtare, partnerët socialë dhe organizatat ndërkombëtare, duke shkëmbyer informacion dhe ndërmarrë veprime të përbashkëta kundër shkeljeve të ligjit dhe formave të shfrytëzimit.

INFORMIMI DHE TRANSPARENCA PUBLIKE

Siguron publikimin e informacionit ligjor mbi të drejtat dhe detyrimet ligjore të palëve të marrëdhënies së punës, përmes platformave digjitale, materialeve informuese dhe komunikimit institucional.

RAPORTIMET KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE

Kontribuon direkt duke mbajtur një peshë të rëndësishme në raportimet e integritetit evropian dhe ato ndaj Organizatës Ndërkombëtare të Punës dhe mekanizmave të tjerë ndërkombëtarë të monitorimit, duke ndjekur edhe zbatimin e rekomandimeve përkatëse.

MONITORIMI I CILËSISË DHE INTEGRITETIT TË PROCESIT INSPEKTUES

Standardizon procedurat, unifikon praktikat inspektuese dhe forcon profesionalizmin e trupës inspektuese, me qëllim rritjen e efektivitetit, transparencës dhe besueshmërisë së veprimtarisë inspektuese.

BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL, NDËRKOMBËTAR DHE KONTRIBUTI NË PROCESIN E INTEGRIMIT EUROPIAN

ISHPSHSH ka vijuar forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel kombëtar, me qëllim rritjen e koordinimit operacional, shkëmbimin e informacionit dhe përmirësimin e efektivitetit të veprimtarisë inspektuese. Ky bashkëpunim është zhvilluar mbi bazën e marrëveshjeve dhe memorandumeve të bashkëpunimit, duke kontribuar në një qasje më të integruar të zbatimit të ligjit. Në këtë kuadër, bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve ka qenë i fokusuar në shkëmbimin e të dhënave mbi punësimin, deklarimin e kontributeve dhe adresimin e punës së padeklaruar. Me Qendrën Kombëtare të Biznesit, **ISHPSHSH** ka bashkëpunuar për informimin paraprak të subjekteve të reja mbi detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni i punës dhe standardet e sigurisë dhe shëndetit në punë. Bashkëpunimi me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive ka qenë i orientuar drejt çështjeve të punëmarrësve të huaj, ndërmjetësimin në tregun e punës dhe monitorimit të lëvizshmërisë së punonjësve. Po ashtu, **ISHPSHSH** ka bashkëpunuar me Agjencinë e Prokurimit Publik për shkëmbimin e informacionit mbi subjektet e sanksionuara dhe përjashtimin e tyre nga procedurat e prokurimit publik, në përputhje me kuadrin ligjor. Me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bashkëpunimi është fokusuar në parandalimin dhe trajtimin e rasteve të diskriminimit në marrëdhëniet e punës, ndërsa me Autoritetin e Mediave Audiovizive është intensifikuar monitorimi i kushteve të punës në sektorin e medias. Këto bashkëpunime kanë kontribuar në harmonizimin e veprimeve institucionale dhe në rritjen e mbrojtjes së të drejtave të punëmarrësve.

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR DHE RAJONAL

Gjatë vitit 2025, **ISHPSHSH** ka vijuar bashkëpunimin aktiv me organizata ndërkombëtare, institucione homologe dhe partnerë rajonalë, duke marrë pjesë në aktivitete të përbashkëta, projekte mbështetëse, programe trajnimi dhe shkëmbim praktikash të mira. Një moment i rëndësishëm ka qenë nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit më Maj 2025 me Inspektoratin Qendror të Punës të Republikës së Kosovës, për tu vijuar më pas me Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi, me synim forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve në kontekstin e lëvizshmërisë ndërkufitare të fuqisë punëtore. Bashkëpunimi me Organizatën Ndërkombëtare të Punës (ILO) ka vijuar në kuadër të projekteve për forcimin e inspektimit të punës, sigurinë dhe shëndetin në punë dhe përafrimin me standardet ndërkombëtare. Gjithashtu, **ISHPSHSH** ka bashkëpunuar me partnerë europianë dhe rajonalë në kuadër të projekteve të Bashkimit Evropian, si dhe me organizata joqeveritare vendase dhe ndërkombëtare, përfshirë ESAP, GIZ, OSCE, AFD, ASDO, CLR dhe GADC, me fokus mbrojtjen e të drejtave të punës, trajtimin e kategorive vulnerabël dhe parandalimin e shfrytëzimit në punë. Këto bashkëpunime kanë ndikuar drejtpërdrejt në forcimin e kapaciteteve profesionale dhe modernizimin e proceseve inspektuese.

KONTRIBUTI NË PROCESIN E INTEGRIMIT NË BASHKIMIN EUROPIAN

ISHPSHSH ka vijuar angazhimin e tij të strukturuar në procesin e integrimit evropian, duke kontribuar në hartimin, raportimin dhe zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kapitujt e negociatave, veçanërisht Kapitulli 19 (Politikat Sociale dhe Punësimi), Kapitulli 2 (Lëvizja e Lirë e Punëtorëve), Kapitulli 20 (Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale), Kapitulli 23 dhe 24 (Drejtësia, Liria dhe Siguria), si dhe Kapitulli 28 (Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit). Institucioni ka marrë pjesë gjithashtu në punimet e nënkomiteteve sektoriale të BE-së, duke siguruar kontribute teknike dhe institucionale në përputhje me *acquis communautaire*.

RAPORTIMET KOMBËTARE DHE NËRKBËTARE

Gjatë vitit 2025, **ISHPSHSH** ka përbushur në mënyrë të plotë detyrimet për raportim periodik ndaj institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, duke ofruar raporte të sakta dhe brenda afateve të përcaktuara pranë ILO, Kombeve të Bashkuara (CESCR), Departamentit të Shtetit Amerikan, Komitetit për të Drejtat e Njeriut (UPR), si dhe strukturave kombëtare për luftën kundër trafikimit të personave. Këto raportime kanë kontribuar në rritjen e transparencës institucionale, harmonizimin e politikave publike dhe forcimin e mekanizmave të mbrojtjes së të drejtave të punës.


ZBATIMI I DETYRIMEVE QË RRJEDHIN NGA CLOSING BENCHMARK

Në kuadër të përbushjes së kërkesave të Closing Benchmark për forcimin e sistemit të inspektimit të punës, gjatë vitit 2025 **ISHPSHSH** ka ndërmarrë një sërë masash strukturore dhe operative, përfshirë konsolidimin ekuadritligjor dhe institucional, qartësimin e strukturës organizative dhe procedurave operative, përgatitjen e projekt-VKM-së për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Punës, si dhe rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale përmes rekrutimeve dhe trajnimeve të specializuara. Një fokus i veçantë i është kushtuar avancimit të digjitalizimit, për të siguruar në një kohë sa më të afërt ndëreveprimin ndërmjet sistemit MIRA dhe platformës qendrore “e-Inspection”.



mira

INTELIJENCË DHE ANALIZË RISKU



**ARRITJET
KRYESORE**

Gjatë vitit 2025, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore ka vijuar procesin e konsolidimit të funksioneve inspektuese në nivel kombëtar, duke rritur ndjeshëm cilësinë, transparencën dhe efikasitetin e veprimtarisë së inspektimit. Rezultatet e arritura reflektojnë zbatimin koherent të politikave institucionale, përmirësimin e mekanizmave të planifikimit të bazuar në risk dhe forcimin e bashkëpunimit me institucionet partnere. Treguesit kryesorë të performancës dëshmojnë një progres të qëndrueshëm krahasuar me vitin paraardhës, veçanërisht në drejtim të digjitalizimit të proceseve, identifikimit dhe adresimit të informalitetit, mbrojtjes së kategorive të veçanta të punëmarrësve dhe rritjes së ndërgjegjësimit publik, duke konsoliduar rolin e institucionit në garantimin e standardeve të punës dhe të shërbimeve shoqërore.

DIGJITALIZIMI I PROCESIT TË INSPEKTIMIT DHE MODERNIZIMI INSTITUCIONAL

- Sistemi MIRA – Matrica e Inteligjencës dhe Analizës së Riskut është konsoliduar si një mjet bazë pune për inspektorët e punës, duke mundësuar standardizimin e vlerësimit të shkeljeve, analizën e të dhënave në kohë reale dhe automatizimin e programimit të inspektimeve mbi bazë risku, me qëllim rritjen e objektivitetit, transparencës dhe efektivitetit të veprimtarisë inspektuese.
- Mbi 50% e inspektimeve të programuara janë orientuar nga sistemi MIRA, ndërsa 76% e inspektimeve të programuara mbi bazë risku kanë rezultuar me gjetje shkeljesh, duke dëshmuar saktësinë dhe efektivitetin e analizës së riskut.
- Portofoli i subjekteve të reja të inspektuara është rritur në nivelin 27.7% të totalit të inspektimeve, duke shënuar një përmirësim të konsiderueshëm krahasuar me vitin 2024 dhe duke reflektuar një qasje më proaktive dhe gjithëpërfshirëse të planifikimit inspektues.

INSPEKTIMET NË FUSHËN E PUNËS DHE REZULTATET KRYESORE

- Janë inspektuar 205,196 vende pune në 9,532 subjekte, me rritje prej 8% të vendeve të punës të verifikuara krahasuar me vitin e kaluar.
- Norma e zbulimit të punës së padeklaruar (Strike Rate) është rritur sistematikisht:
 - ▶ **20%** në vitin 2023;
 - ▶ **26%** në vitin 2024;
 - ▶ **27%** në vitin 2025, duke reflektuar orientim të saktë drejt sektorëve me risk të lartë.
- **98%** e punëmarrësve informal të konstatuar janë formalizuar gjatë procesit inspektues përmes masave administrative, kryesisht “Pezullim aktiviteti”.
- Janë evidentuar 2,999 punëmarrës pa kontratë pune, ose 24% më pak se në vitin 2024.
- Është shtuar kontrolli për kategoritë e veçanta të punëmarrësve, duke rezultuar në verifikimin e:
 - ▶ **165** punëmarrësve nën moshën 18 vjeç (+33%);
 - ▶ **2,484** punëmarrësve të huaj (+62%).

SIGURIA DHE SHËNDETI NË PUNË

- Të gjitha inspektimet për shkak aksidenti janë shoqëruar me masa administrative (100% e rasteve).
- Është rritur niveli i raportimit nga punëdhënësit: 96% e aksidenteve janë njoftuar nga subjektet, me rritje prej 6% kundrejt vitit 2024.
- Ka rritje të raportimit të incidenteve në vendin e punës (aksidente pa pasoja në njerëz): nga 3 raste në vitin 2024 në 7 raste në vitin 2025.

ANKESAT, KËSHILLIMI DHE NDËRVEPRIMI ME SUBJEKTET DHE PUBLIKUN

- Janë trajtuar **1,179** ankesa / kërkesa, ose 259 më shumë se një vit më parë, ku 70% e ankesave janë zgjidhur në favor të punëmarrësve.
- **82%** e inspektimeve të kryera nga ankesa janë shoqëruar me masa administrative.
- **100%** e kërkesave për sqarime ligjore janë trajtuar brenda afateve.
- Janë këshilluar **19,679** subjekte të reja të regjistruara në QKB, duke rritur ndërgjegjësimin mbi të drejtat dhe detyrimet ligjore.

MASAT ADMINISTRATIVE DHE EKZEKUTIMI I GJOBAVE


- Janë vendosur **268** gjoba me vlerë totale 64,584,000 lekë, duke shënuar rritje prej 28% në numër dhe 20% në vlerë në raport me vitin 2024.
- Vetëm **21%** e gjobave janë ankimuar administrativisht, një përqindje më e ulët krahasuar me mesataren e tre viteve të fundit.
- Nga vendimet e vitit 2025, vetëm 1 vendim gjobe është shfuqizuar nga gjykata.
- **45%** e gjobave janë ekzekutuar, me pritshmëri për rritje pas përfundimit të procedurave administrative e gjyqësore.

INFORMIMI PUBLIK, NDËRGJEGJËSIMI DHE MBROJTJA E PUNËMARRËSVE

- Një seksion i dedikuar për punëmarrësit e huaj në faqen zyrtare **www.inspektoratipunes.gov.al**, i shoqëruar me broshura informuese në 7 gjuhë, të publikuara online dhe në zyrat e **ISHPSHSH**, AKPA dhe Zyrës së Migracionit.
- Janë shpërndarë 500 fletëpalosje për sigurinë dhe shëndetin në punë, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.
- Është pasuruar informacioni për “posting of workers”, në përputhje me praktikat e Bashkimit Europian.

FORCIMI INSTITUCIONAL, REFORMA LIGJORE DHE BURIMET NJERËZORE

- Janë rekrutuar 11 punonjës të rinj, duke plotësuar vendet vakante dhe rritur kapacitetet profesionale të institucionit.
- Buxheti i vitit 2025 është realizuar në masën 99%, duke dëshmuar menaxhim efikas financiar.
- **ISHPSHSH** ka kontribuar në hartimin e projektligjeve, akteve nënligjore dhe manualeve procedurale për njoftimin e akteve, ankimin administrativ dhe ekzekutimin e vendimeve.
- Janë përgatitur propozimet për strukturën, organikën dhe klasifikimet në kuadër të ligjit nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
- Është punuar në vijimësi në përmbushje të kërkesave të procesit të integritetit dhe forcimit të sistemit të inspektimit në përputhje me standardet e BEsë.



STRUKTURA ORGANIZATIVE

(Përbërja organizative dhe organigrama)

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore ka ushtruar veprimtarinë e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi për administratën publike dhe shërbimin civil, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, duke garantuar menaxhimin e burimeve njerëzore sipas parimeve të ligjshmërisë, profesionalizmit dhe vazhdimësisë institucionale. Struktura organizative e **ISHPSHSH** për vitin 2025 ka qenë ajo e miratuar me Urdhrin nr. 174, datë 10.09.2024, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së **ISHPSHSH**”, e cila parashikon organizimin dhe funksionimin e institucionit në dy nivele:

- niveli qendror, me funksione drejtimi, koordinimi dhe mbështetjeje metodologjike;
- niveli rajonal, me funksione zbatimi operacional të veprimtarisë inspektuese në territor.

Në përfundim të vitit 2025, **ISHPSHSH** ka pasur në organikë 163 punonjës, të shpërndarë ndërmjet strukturave qendrore dhe 6 drejtorive rajonale, duke siguruar mbulim territorial të plotë dhe ushtrimin e pandërprerë të kompetencave inspektuese. Dinamika e stafit, gjatë këtij viti ka regjistruar 11 nëpunës të emëruar dhe 7 largime për arsye të ndryshme, si dorëheqje, plotësim i moshës për pension, pezullim i statusit të nëpunësit civil ose lëvizje paralele. Në fund të vitit 2025, rezultojnë 7 pozicione vakante.

Ligji nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka hyrë në fuqi në maj 2025, parashikon një reformim të thelluar të sistemit të inspektimit, përfshirë strukturën institucionale, forcimin e rolit inspektues dhe rishikimin e procedurave të inspektimit. Megjithatë, gjatë vitit raportues, aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji dhe struktura e re organizative nuk kanë hyrë ende në fuqi. Për rrjedhojë, gjatë vitit 2025 **ISHPSHSH** ka vijuar ushtrimin e veprimtarisë me strukturën ekzistuese, ndërkohë që procesi i analizës, riorganizimit institucional, rishikimit të organikës dhe përafrimit me kërkesat e ligjit nr. 99/2024 ka qenë në fazë përgatitore dhe planifikimi. Ky konfigurim tranzitor ka garantuar stabilitet institucional, vazhdimësi funksionale dhe efektivitet në ushtrimin e veprimtarisë inspektuese, duke krijuar njëkohësisht bazën e nevojshme për zbatimin e reformës së parashikuar nga kuadri i ri ligjor.

NIVELI QENDROR

DREJTORIA E INSPEKTIMIT TË PUNËS

Struktura teknike qendrore përgjegjëse për drejtimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së inspektimit të punës në shkallë kombëtare. Ajo siguron zbatimin e legjislacionit të punës, sigurisë dhe shëndetit në punë, trajtimin e ankesave, hetimin e aksidenteve në punë, si dhe analizën e të dhënave dhe treguesve inspektues, në përputhje me parimet e inspektimit të bazuar në risk. Drejtoria funksionon përmes sektorëve përkatës, të cilët mbulojnë:

- analizën dhe vlerësimin e riskut;
- marrëdhëniet e punës;
- sigurinë dhe shëndetin në punë;
- përpunimin dhe analizën statistikore të të dhënave inspektuese.

DREJTORIA E INSPEKTIMIT TË STANDARDEVE TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE


Kjo drejtori ushtron funksionet e inspektimit dhe vlerësimit të qendrave dhe shërbimeve të përkujdesit shoqëror, publike dhe jopublike. Veprimtaria e saj fokusohet në verifikimin e respektimit të standardeve ligjore, cilësisë së shërbimeve dhe mbrojtjes së të drejtave të përfituesve, si dhe në mbështetjen e proceseve të licencimit dhe monitorimit të shërbimeve shoqërore.

DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse siguron mbështetjen administrative, financiare, juridike dhe të burimeve njerëzore për veprimtarinë e institucionit, duke kontribuar në funksionimin e rregullt dhe efikas të strukturave inspektuese.

NIVELI RAJONAL

Në nivel territorial funksionojnë 6 Drejtori Rajonale, të cilat ushtrojnë kompetencat inspektuese në fushat e marrëdhënieve të punës, sigurisë dhe shëndetit në punë, shërbimeve shoqërore, trajtimit të ankesave dhe hetimit të aksidenteve në punë. Drejtoritë rajonale zbatojnë planifikimin vjetor dhe periodik të inspektimeve, realizojnë inspektimet në terren dhe raportojnë në mënyrë të strukturuar pranë njësive qendrore, duke garantuar zbatim të unifikuar, proporcional dhe të standardizuar të legjislacionit në fuqi. Struktura organizative e **ISHPSHSH** gjatë vitit 2025 ka siguruar një ndarje të qartë ndërmjet funksioneve të drejtimit strategjik dhe koordinues në nivel qendror dhe funksioneve të zbatimit operacional në nivel rajonal. Ky model organizativ ka garantuar ushtrimin efektiv të veprimtarisë inspektuese, stabilitet institucional dhe vijimësi funksionale, duke përgatitur institucionin për zbatimin e reformës strukturore dhe funksionale të parashikuar nga ligji nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.



Organigrama e strukturës së ISHPSHSH-së



**PLANIFIKIMI MBI
BAZË RISKU**

ANALIZA E ÇËSHTJEVE SIPAS KOMPETENCAVE TË ISHPSHSH

Gjatë vitit 2025, Inspektorati i Punës ka ushtruar kompetencat e tij ligjore për mbikëqyrjen dhe garantimin e zbatimit të legjislacionit të punës dhe të sigurisë dhe shëndetit në punë, në një kontekst të karakterizuar nga dinamika të shtuara të marrëdhënieve të punës, kompleksitet i problematikave të evidentuara dhe nevojë për inspektime të orientuara mbi bazë risku. Analiza në vijim paraqet në mënyrë të strukturuar çështjet kryesore të trajtuara gjatë vitit raportues, sipas fushave të kompetencës së Inspektoratit të Punës, duke u mbështetur në të dhëna faktike, tregues inspektues dhe vlerësim të shkeljeve dhe tendencave të konstatuara. Ky trajtim synon të pasqyrojë nivelin e përputhshmërisë ligjore, shkaqet kryesore të problematikave të evidentuara dhe ndikimin e veprimtarisë inspektuese, si bazë për përmirësimin e planifikimit, forcimin e rolit parandalues dhe rritjen e efektivitetit të ndërhyrjeve inspektuese në vijim.

PLANIFIKIMI I INSPEKTIMEVE

Analiza dhe Planifikimi i inspektimit mbi bazë risku ka për mision të sigurojë një proces inspektimi të orientuar drejt sektorëve dhe subjekteve me probabilitet të lartë shkeljesh, duke përdorur metodologji të standardizuara dhe sisteme inteligjente. Ky sektor është themelor në hartimin e planeve mujore e vjetore, në profilizimin e riskut për çdo subjekt dhe në garantimin e një procesi inspektues të unifikuar, objektiv dhe të matshëm. Gjatë vitit 2025, përmes analizës së riskut është siguar mbështetje e vazhdueshme për trupën inspektuese. Analiza e të dhënave ka evidentuar problematikat kryesore të tregut të punës, ka identifikuar modelet e shkeljeve dhe sektorët me risk të lartë, duke ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së planifikimit.

ROLI STRATEGJIK I PLATFORMËS MIRA

Platforma MIRA është shndërruar në instrument qendror për modernizimin e procesit inspektues dhe rritjen e integritetit të veprimtarisë së **ISHPSHSH**. Ky sistem përfaqëson një arkitekturë të re inspektimi, të standardizuar sipas kërkesave të BE-së. Përmes teknikave të inteligjencës artificiale (data mining, machine learning), sistemi MIRA:

- standardizon vendimmarrjen inspektuese;
- automatizon planifikimin mbi bazë risku;
- rrit transparencën dhe objektivitetin;
- përmirëson kulturën e përputhshmërisë.

PRIORITETET STRATEGJIKE TË VITIT 2025

- Inspektime në subjekte me risk të lartë për sigurinë dhe shëndetin në punë (me fokus ndërtimin dhe industrinë).
- Inspektime në subjekte me risk të lartë për moszbatim të legjislacionit të punës (marrëdhënie pune, informalitet).
- Inspektime për herë të parë, për zgjerimin e mbulimit të tregut dhe rritjen e transparencës.

STRUKTURA E PLANIFIKIMIT

Planifikimi vjetor i inspektimeve është ndërtuar mbi parimin e orientimit mbi bazë risku, duke marrë në konsideratë analizën e treguesve të shkeljeve, ankesave dhe të dhënave historike të inspektimit. Kjo qasje synon përdorimin më efikas të burimeve inspektuese dhe rritjen e ndikimit parandalues të veprimtarisë inspektuese.

Inspektime për herë të parë (27.7%)

Përfshirja e një përqindjeje të konsiderueshme inspektimesh për herë të parë synon zgjerimin e mbulimit të tregut të punës dhe identifikimin e subjekteve që nuk kanë qenë më parë objekt kontrolli. Kjo kategori kontribuon në parandalimin e shkeljeve që në fazat e hershme të veprimtarisë së subjekteve.

Inspektime në fushën e marrëdhënieve të punës (33.7%)

Pjesa më e madhe e inspektimeve është orientuar drejt marrëdhënieve të punës, duke reflektuar nivelin e lartë të shkeljeve të konstatuara në këtë fushë. Ky fokus synon forcimin e formalizimit të punësimit dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të punëmarrësve.

Inspektime për informalitetin (10%)

Inspektimet e planifikuara në fushën e informalitetit janë bazuar në analizën e riskut dhe treguesve të deklarimit të punësimit. Ky orientim mbështet përpjekjet për reduktimin e punës së padeklaruar dhe përmirësimin e konkurrencës së ndershme në tregun e punës.

Inspektime në sigurinë dhe shëndetin në punë (28.6%)

Një peshë e konsiderueshme e planifikimit është dedikuar inspektimeve në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, në funksion të parandalimit të aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale. Ky fokus synon garantimin e standardeve minimale të sigurisë dhe mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punëmarrësve.

Sa më sipër, shpërndarja e inspektimeve sipas fushave prioritare siguron një balancë të qëndrueshme ndërmjet formalizimit të marrëdhënieve të punës dhe adresimit të riskut teknik. Kjo strukturë planifikimi mbështet objektivat e inspektimit të bazuar në risk dhe rrit efektivitetin e ndërhyrjeve inspektuese.

ARRITJET KRYESORE NË KËTË ASPEKT PËRFSHIJNË:

- Identifikimin më të saktë të sektorëve me risk të lartë, nëpërmjet analizës së integruar të të dhënave të inspektimit, ankesave dhe treguesve të sigurisë e shëndetit në punë mundësua orientimin më efektiv të veprimtarisë inspektuese drejt fushave me risk dhe impakt më të lartë.
- Zgjerimin e hartës së subjekteve të monitoruara. Spektër i zgjeruar i subjekteve të përfshira në monitorim, duke rritur mbulimin e aktiviteteve ekonomike dhe formave të ndryshme të punësimit duke kontribuar në forcimin e rolit parandalues të inspektimit dhe në rritjen e transparencës institucionale.
- Vendosjen e një balance funksionale ndërmjet riskut teknik dhe juridik. Planifikimi i inspektimeve u mbështet në një vlerësim të kombinuar të riskut teknik dhe juridik, duke siguruar ndërhyrje të proporcionale dhe të argumentuara ligjërisht. Kjo qasje ka ndihmuar në rritjen e cilësisë së vendimmarrjes inspektuese.
- Rritjen e koherencës ndërmjet Drejtorisë Qendrore dhe Drejtorive Rajonale duke forcuar koordinimin institucional dhe standardizimin e praktikave përmes udhëzimeve të unifikuara, monitorimit të zbatimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet niveleve qendrore dhe ato rajonale.
- Përmirësimin e efikasitetit në zbulimin e shkeljeve përmes përdorimit të metodologjive të bazuara në risk dhe analiza më e strukturuar e të dhënave rriti aftësinë për të identifikuar shkelje me ndikim të drejtpërdrejtë në kushtet e punës. Si rezultat, veprimtaria inspektuese u bë më e fokusuar dhe me efekt parandalues më të theksuar.

ANALIZË DHE IMPLIKIME PËR PLANIFIKIMIN E VEPRIMTARISË INSPEKTUESE 2026

Rezultatet e inspektimeve të vitit 2025, ku 79% e subjekteve rezultuan me shkelje dhe vetëm 21% në përputhje me dispozitat ligjore, tregojnë një nivel ende të lartë të riskut të mospërputhshmërisë në tregun e punës. Këto të dhëna përbëjnë bazë objektive për orientimin e planifikimit të inspektimeve për vitin 2026.

Dominimi i shkeljeve në fushën e marrëdhënieve të punës (39.6%) dhe të sigurisë dhe shëndetit në punë (34.8%) evidenton sektorë dhe procese me risk të shtuar, të cilët kërkojnë ndërhyrje të strukturuar dhe të vazhdueshme inspektuese. Në këtë kuadër, planifikimi për vitin 2026 do të fokusohet në adresimin e këtyre fushave prioritare, duke kombinuar masat parandaluese me ato korrektuese, në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

Prania e konsiderueshme e informalitetit (18.5%) konfirmon nevojën për forcimin e bashkërendimit institucional dhe përdorimin e analizës së riskut si instrument kyç për identifikimin e subjekteve me probabilitet të lartë shkeljeje. Ky tregues mbështet vijimin e qasjes së inspektimit të bazuar në risk, siç parashikohet edhe nga ligji nr. 99/2024, duke synuar rritjen e efektivitetit dhe përdorimin racional të burimeve inspektuese.

Shkeljet në kushtet e punës (4.6%) dhe rastet e mosnjohimit të aksidenteve në punë (1.1%), ndonëse me incidencë më të ulët, paraqesin ndikim të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve dhe në vlerësimin real të riskut profesional. Këto tregues do të trajtohen në mënyrë të integruar në planifikimin e inspektimeve për vitin 2026, përmes monitorimit të vazhdueshëm dhe forcimit të komponentit parandalues.

Në përfundim, treguesit e vitit 2025 konfirmojnë se orientimi i veprimtarisë inspektuese mbi bazë risku, i kombinuar me standardizimin e praktikave dhe rritjen e koherencës institucionale, mbetet thelbësor për përmbushjen e objektivave të ligjit nr. 99/2024. Planifikimi për vitin 2026 do të ndërtohet mbi këto rezultate, me synimin për rritjen e përputhshmërisë ligjore, forcimin e funksionit parandalues dhe përmirësimin e sigurisë dhe kushteve të punës.



**NGA ANKESA
TE ZGJIDHJA**

INSPEKTIMI I MARRËDHËNIEVE TË PUNËS DHE ADMINISTRIMI I ANKESAVE

QASJA INSTITUCIONALE DHE ROLI I ADMINISTRIMIT TË ANKESAVE

Administrimi i ankesave dhe inspektimi i marrëdhënieve të punës janë trajtuar si procese të ndërlidhura, në funksion të garantimit të zbatimit të legjislacionit të punës dhe mbrojtjes efektive të të drejtave të punëmarrësve. Ky funksion inspektues ka për qëllim të garantojë respektimin e legjislacionit të punës dhe mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve, duke kontrolluar marrëdhëniet e punës në të gjitha aspektet e tyre. Procesi përfshin verifikimin e kontratave, orarit, pagesave dhe kushteve të punës, si dhe trajtimin e ankesave të paraqitura nga punëmarrësit dhe palët e interesuara. Administrimi i ankesave siguron një mekanizëm transparent dhe objektiv për adresimin e problematikave, duke forcuar besueshmërinë e institucionit. Në këtë mënyrë, inspektimi dhe menaxhimi i ankesave përbëjnë një shtyllë të rëndësishme për rritjen e përputhshmërisë ligjore dhe mbrojtjen efektive të të drejtave në tregun e punës.

Gjatë vitit 2025, administrimi i ankesave nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore është realizuar përmes sistemit “Rregjistri i Ankesave”, i cili ka garantuar regjistrimin, gjurmueshmërinë dhe trajtimin e standardizuar të çdo ankesë, denoncimi apo kërkesë për informacion, si në nivel qendror ashtu edhe rajonal. Në total janë regjistruar 1,179 ankesa dhe 135 kërkesa për informim, duke reflektuar një volum të konsiderueshëm ndërveprimi midis institucionit dhe punëmarrësve apo palëve të interesuara. Nga totali i rasteve të depozituara, 90% janë paraqitur drejtpërdrejt pranë **ISHPSHSH** përmes kanaleve zyrtare të komunikimit, ndërsa 10% janë referuar nga Platforma e Bashkëqeverisjes.

Profili i ankesave tregon se 90% e tyre lidhen me shkelje të marrëdhënieve të punës dhe denoncime për mosrespektim të dispozitave ligjore, ndërsa 10% përbëhen nga kërkesa për informim dhe sqarime ligjore. Fakti që 100% e kërkesave për sqarime ligjore janë trajtuar brenda afateve ligjore përbën një tregues të qartë të nivelit të profesionalizmit, transparencës dhe rolit këshillues të institucionit në orientimin e punëmarrësve dhe punëdhënësve.

Trajtimi i ankesave është kryer kryesisht përmes procedurave të plota të inspektimit, duke mundësuar verifikim të gjithanshëm të fakteve dhe vendimmarrje të mbështetur në legjislacionin e punës. Një pjesë e rasteve është adresuar përmes përgjigjeve të argumentuara, bazuar në dokumentacionin dhe të dhënat e disponueshme, në përputhje me natyrën e çështjes dhe kompetencat ligjore të institucionit. Ky proces ka kontribuar jo vetëm në zgjidhjen konkrete të problematikave të ngritura, por edhe në zbutjen e konflikteve potenciale, rritjen e ndërgjegjësimit për detyrimet ligjore dhe përmirësimin e marrëdhënieve të punës në nivel kombëtar.

Administrimi i ankesave ka shërbyer gjithashtu si një burim i rëndësishëm informacioni për identifikimin e tendencave të shkeljeve dhe fushave me risk të lartë, duke mbështetur drejtpërdrejt planifikimin e inspektimeve mbi bazë risku dhe orientimin e politikave inspektuese për vitet në vijim. Në këtë kuptim, ankesa nuk është trajtuar vetëm si një instrument procedural, por si një element analitik thelbësor i veprimtarisë inspektuese.

Në aspektin territorial, shpërndarja e ankesave tregon një përqendrim të theksuar në zonat urbane, ku aktiviteti ekonomik dhe dinamika e tregut të punës janë më intensive. Numri më i madh i ankesave është trajtuar nga Drejtoria Rajonale Tiranë (76%), e ndjekur nga Drejtoria Rajonale Vlorë (11%), Korçë dhe Shkodër (nga 4% secila), Dibër (2%) dhe Gjirokastër (1%). Ndërkohë, 2% e rasteve janë trajtuar në nivel qendror, kryesisht kërkesa për sqarime ligjore. *Kjo shpërndarje territoriale pasqyron përqendrimin e bizneseve dhe intensitetin më të lartë të marrëdhënieve të punës në rajonet urbane, duke mbështetur nevojën për orientim të diferencuar të veprimtarisë inspektuese.*

Arsyeja e Ankesës	Nr. raste	Zgjidhje (%)
Cënim i marrëdhënieve të punës	193	67%
Mospagesë e pagave të prapambetura	316	70%
Mospagesë e kontributeve të sigurimeve shoqërore	119	81.5%
Punësim i paligjshëm	25	64%
Ndërprerje e marrëdhënieve të punës	207	65.7%
Mosnjohim i aksidentit në punë	15	86.6%
Kushte të pasigurta pune	23	56.5%
Mos pagesë e raporteve mjekësore	39	74.3%
Trajtim i pabarabartë në vendin e punës	3	33.3%
Zbatim i kontratave kolektive / pushimeve kolektive	33	87.8%
Moslidhje kontrate & mosrespektim i orarit	33	84.8%
Punësim i paligjshëm i të huajve	12	66.6%
Diskriminim dhe ngacmim seksual	8	62.5%
Dhunë në vendin e punës	8	37.5%
Të tjera	145	52.4%
TOTALI	1,179	70%

Tabela 1. Ankesat sipas arsyes dhe përqindja e zgjidhjes

ANALIZA E TENDENCAVE DHE MANGËSIVE KRYESORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS

Siç paraqitet në Tabelën 1 “Ankesat sipas arsyes dhe përqindja e zgjidhjes përmes veprimtarisë inspektuese, viti 2025”, analiza e rasteve të trajtuara gjatë vitit 2025 evidenton një sërë problematikash të përsëritura në marrëdhëniet e punës, të cilat reflektojnë mangësi strukturore në zbatimin e legjislacionit dhe nevojën për ndërhyrje të vazhdueshme inspektuese të orientuara mbi bazë risku.

Kategoria me peshën më të lartë të ankesave lidhet me mospagesën e pagave dhe detyrimeve financiare, e evidentuar në 316 raste, duke përbërë burimin kryesor të ndërhyrjeve inspektuese. Ky tregues, i pasqyruar në Tabelën 1, tregon se një pjesë e konsiderueshme e subjekteve punëdhënëse nuk zbatojnë detyrimet për pagesën e pagave në kohë dhe në përputhje me kërkesat e Kodit të Punës, duke cënuar sigurinë ekonomike të punëmarrësve dhe duke gjeneruar konfliktualitet të lartë në marrëdhëniet e punës.

Në vijim, mospagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, e konstatuar në 119 raste, paraqet një problematikë me impakt të lartë social, pavarësisht nivelit relativisht të lartë të zgjidhjes (81.5%), siç rezulton nga Tabela 1. Kjo situatë reflekton fenomenin e informalitetit gri dhe cenimin e të drejtave sociale të punëmarrësve, duke kërkuar ndërhyrje të koordinuara dhe monitorim të vazhdueshëm.



Inspektori Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore

Paga kalon vetëm nëpërmjet sistemit bankar, si mënyra e vetme për deklarim real të pagës për punën e kryer.

PAGESA NË DORË ËSHTË E PALIGJSHME!

Informohu mbi llogaritjen e pagës sipas kontratës së punës dhe sigurohu që të marrësh të drejtat e tua të plota.

Për më shumë informacion, vizitoni: www.inspektoriatipunes.gov.al

Një tjetër tregues domethënës është ndërprerja e marrëdhënieve të punës, e evidentuar në 207 raste, e cila, sipas të dhënave tabelare, lidhet shpesh me mosrespektim të procedurave ligjore, mungesë të arsytimit apo mosnjohim brenda afateve ligjore. Këto praktika cenojnë sigurinë juridike të punëmarrësve dhe rrisin numrin e ankesave me karakter konfliktual.

Rastet e moslidhjes së kontratave individuale të punës dhe shkeljeve të orarit të punës, të evidentuara në 33 raste, përfaqësojnë një tregues të drejtpërdrejtë të mungesës së formalizimit në sektorë me informalitet të lartë operacional. Siç

pasqyrohet në Tabelën 1, këto shkelje kërkojnë ndërhyrje të shtuar inspektuese dhe masa parandaluese të fokusuara.

Në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, të dhënat tabelare tregojnë raste të mosnjohimit të aksidenteve në punë dhe konstatime për kushte të pasigurta pune, të cilat dëshmojnë mungesë të kulturës së raportimit dhe moszbatim të detyrimeve teknike të sigurisë dhe shëndetit në punë. Këto shkelje paraqesin rrezik të drejtpërdrejtë për jetën dhe shëndetin e punëmarrësve dhe kërkojnë ndërhyrje parandaluese të vazhdueshme.

Së fundi, edhe pse numerikisht më të kufizuara, rastet që lidhen me diskriminimin, ngacmimin seksual dhe dhunën në vendin e punës, të pasqyruara në Tabelën 1, kanë ndjeshmëri të lartë sociale dhe ligjore. Trajtimi i tyre kërkon qasje të specializuara dhe të koordinuar, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë dhe standardet për mbrojtjen e dinjitetit dhe barazisë në punë.

Në vijim të tendencave të evidentuara nga analiza e ankesave, gjatë vitit 2025 rezulton se pjesa më e madhe e denoncimeve të adresuara pranë Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore lidhej me shkeljet e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës dhe detyrimet e punëdhënësve ndaj punëmarrësve. Këto shkelje kanë pasur kryesisht karakter procedural dhe ekonomik dhe kanë përfshirë mospagesën e punës së kryer në ditë festash zyrtare, mosrespektimin e ditëve të pushimit javor, moskompensimin e orëve shtesë, moslidhjen e kontratës individuale të punës, si dhe ndryshimin e kushteve të punës pa dakordësinë e palëve. Këto praktika cenojnë drejtpërdrejt të drejtat themelore të punëmarrësve dhe përbëjnë burim të vazhdueshëm konfliktualiteti në marrëdhëniet e punës, duke justifikuar ndërhyrjen inspektuese dhe rolin korrektues të institucionit.

Në këtë kontekst, trajtimi i ankesave ka përbërë një proces të rëndësishëm institucional për garantimin e zbatimit të kuadrit ligjor, përmirësimin e marrëdhënieve të punës dhe zbutjen e konflikteve të mundshme. Gjatë inspektimeve dhe komunikimit me palët, Inspektorati i Punës ka theksuar domosdoshmërinë e lidhjes së kontratës individuale të punës si instrument bazë i sigurisë juridike, duke informuar dhe këshilluar punëmarrësit për rëndësinë mbrojtëse që kjo kontratë ka në çdo fazë të marrëdhënies së punës. Në kushtet e rritjes së digjitalizimit dhe shfaqjes së formave të reja të punësimit, nevoja për transparencë, informacion të saktë dhe komunikim të qartë, të shkruar dhe të menjëhershëm mbi të drejtat dhe detyrimet e palëve është bërë edhe më e domosdoshme. Këshillimi i vazhdueshëm i punëmarrësve gjatë trajtimit të ankesave ka kontribuar në rritjen e transparencës, forcimin e besimit ndërmjet palëve dhe uljen e rrezikut të abuzimeve apo konflikteve të ardhshme, duke përmirësuar ndjeshëm sigurinë juridike dhe sociale të punëmarrësve.

EFEKTIVITETI I INSPEKTIMEVE MBI BAZË ANKESË

Në tabelën e mëposhtme paraqitet numri i inspektimeve bazuar në indicje / denoncim / ankesë dhe masat / dënimet administrative që rezultojnë të jenë aplikuar në këto inspektime


Nr. Inspektimeve për Ankesa	Pezullim	Paralajmërim	Gjobë	Vlera e Gjoba (000 lekë)
963	115	588	82	16,800

Siç pasqyrohet në tabelën e mësipërme, inspektimet e kryera gjatë vitit 2025 kanë rezultuar veçanërisht efikase në evidentimin dhe adresimin e shkeljeve në marrëdhëniet e punës. Nga gjithsej 963 inspektime të kryera mbi bazë ankese, rezulton se 82% e subjekteve të inspektuara kanë qenë objekt i masave administrative, një tregues i drejtpërdrejtë i nivelit të lartë të problematikave reale të raportuara nga punëmarrësit dhe palët e interesuara. Kjo përçindje konfirmon se ankesa përbën një instrument të besueshëm dhe të orientuar drejt riskut për identifikimin e shkeljeve me impakt të drejtpërdrejtë në të drejtat e punëmarrësve.

Struktura e masave administrative të vendosura pas këtyre inspektimeve tregon një përdorim të diferencuar dhe proporcional të kompetencave inspektuese, në funksion të natyrës dhe rëndësisë së shkeljeve të konstatuara. Gjatë vitit 2025 janë vendosur 115 masa pezullimi, 588 paralajmërime dhe 82 gjoba, me një vlerë totale prej 16.8 milionë lekësh, duke reflektuar një qasje që synon jo vetëm ndëshkimin, por edhe korigjimin e sjelljeve të paligjshme dhe parandalimin e shkeljeve të mëtejshme. Dominimi i masës “paralajmërim” dëshmon orientimin e veprimtarisë inspektuese drejt përmirësimit të përputhshmërisë ligjore dhe forcimit të rolit parandalues të inspektimit të punës.

Në këtë kontekst, ankesa vijon të jetë një burim thelbësor për identifikimin e praktikave të paligjshme në tregun e punës dhe një mekanizëm efektiv për adresimin e tyre në mënyrë të shpejtë dhe të targetuar. Analiza vjetore e ankesave dhe e marrëdhënieve të punës për vitin 2025 tregon një nivel të lartë të shkeljeve në fusha thelbësore të marrëdhënieve të punës, por njëkohësisht edhe një rritje të sensibilizimit të punëmarrësve për të raportuar shkeljet, si dhe rritje të efikasitetit institucional në trajtimin e ankesave dhe marrjen e masave administrative.

Këto gjetje nënvizojnë domosdoshmërinë për forcimin e mëtejshëm të transparencës së kushteve të punës, veçanërisht në kontekstin e formave të reja të punësimit dhe ndryshimeve strukturore në tregun e punës. Njëkohësisht, ato përbëjnë bazën analitike për përcaktimin e prioriteteve inspektuese për vitin 2026, me fokus të shtuar në formalizimin e marrëdhënieve të punës, garantimin e kontratave individuale të punës, respektimin e orarit dhe pagesave, si dhe forcimin e masave parandaluese ndaj shkeljeve të përsëritura.



**FORCIMI I TË DREJTAVE TË
PUNËS PËR PUNËMARRËSIT E
HUAJ LARG ÇDO DISKRIMINIMI**

TRAJTIM I BARABARTË, KUSHTE PUNE TË SIGURTA

Gjatë vitit 2025, **ISHPSHSH** ka vijuar të ketë në fokus të shtuar mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve të huaj, për të siguruar trajtim të barabartë, kushte pune të sigurta dhe zbatim pa diskriminim të standardeve ligjore. Në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Migracionin dhe Planin e Veprimit 2024–2030, institucionit i është kushtuar vëmendje e veçantë monitorimit të kushteve të punës, respektimit të kontratave të punës, procedurave të rekrutimit etik dhe parandalimit të shkeljeve që cenojnë integritetin dhe dinjitetin e punëmarrësve migrantë.

Paralelisht, institucionit i është dhënë prioritet ngritjes së kapaciteteve të punëmarrësve migrantë përmes projektit “Fuqizimi i punëtorëve migrantë përmes një kuadri 3R”, i zbatuar në bashkëpunim me ASDO dhe GIZ Albania. Ky projekt ka synuar rritjen e njohurive të punëmarrësve të huaj mbi të drejtat e tyre në marrëdhëniet e punës, procedurat administrative dhe mekanizmat mbrojtës institucionalë, nëpërmjet trajnimeve, aktiviteteve ndërgjegjëse dhe përgatitjes së materialeve informuese shumëgjuhëshe.

Në nivel rajonal, është thelluar bashkëpunimi me vendet e Ballkanit Perëndimor. Më 22 maj 2025 u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit midis Inspektoratit të Punës të Republikës së Shqipërisë dhe Inspektoratit Qendror të Punës të Republikës së Kosovës, duke krijuar bazën për inspektime të koordinuara, shkëmbim informacioni dhe standardizimin e praktikave për mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve migrantë. Gjithashtu, janë zhvilluar takime bilaterale në Podgoricë dhe Shkup dhe një takim rajonal në Tiranë, ku u formalizua një marrëveshje bashkëpunimi trepalësh për:

- menaxhimin e rregullt të migracionit ndërkufitar;
- kryerjen e inspektimeve të përbashkëta;
- shkëmbimin e praktikave të mira mbi mbrojtjen e punëtorëve migrantë;
- promovimin e standardeve të punës së denjë në rajon.

Për të rritur aksesin në informacion, **ISHPSHSH** ka krijuar një seksion të dedikuar për punëmarrësit e huaj në faqen zyrtare dhe ka publikuar udhëzues praktikë në 7 gjuhë, me mbështetjen e GIZ, për të informuar punëmarrësit migrantë mbi të drejtat e tyre ligjore dhe rrugët e sigurta të punësimit. Broshurat janë shpërndarë në **ISHPSHSH**, AKPA dhe Zyrat e Migracionit.


Këto nisma, së bashku me informimin e vazhdueshëm përmes kanaleve digjitale, kanë krijuar një mjedis më transparent, duke u ofruar punëmarrësve të huaj mekanizma realë për të raportuar shkeljet dhe për të kërkuar ndërhyrje institucionale. Si rezultat i këtyre veprimeve:

- është regjistruar rritje e ndjeshme e numrit të ankesave nga punëmarrësit e huaj;
- janë identifikuar më shumë raste të shkeljeve në vendin e punës;
- është përmirësuar monitorimi dhe ndërhyrja institucionale në sektorët me risk;

- janë ulur rastet e trajtimeve të pabarabarta;
- është forcuar barazia sociale, siguria ligjore dhe integrimi i punëtorëve migrantë në tregun e punës.

Këto rezultate janë në përputhje me efektivitetin e proceseve inspektuese të **ISHPSHSH** gjatë vitit 2025, përfshirë inspektimet e planifikuara mbi bazë rrisht dhe inspektimet mbi bazë ankese, të cilat kanë kontribuar ndjeshëm në identifikimin dhe adresimin e shkeljeve ndaj punëmarrësve të huaj dhe në promovimin e një tregu pune të ndershëm, të sigurt dhe të aksesueshëm për të gjithë.

Gjatë vitit 2025 ka një rritje me 4% të ankesave të paraqitura nga punëmarrësit e huaj krahasimisht me vitin 2024. Kjo rritje reflekton jo vetëm ndërgjegjësimin e shtuar të punëmarrësve të huaj për të drejtat e tyre, por edhe angazhimin e institucionit për ofruar mbrojtje nga çdo formë shkeljeje apo diskriminimi në vendin e punës.



MBROJTJA DHE RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË PUNËMARRËSVE NË SEKTORIN E MEDIAS

Gjatë vitit 2025, **ISHPSHSH** ka intensifikuar veprimtarinë inspektuese dhe bashkëpunimin ndër-institucional për garantimin e të drejtave të punëmarrësve në sektorin e medias, një sektor me rëndësi të veçantë për funksionimin e demokracisë dhe lirinë e shprehjes. Inspektimet e kryera kanë treguar se marrëdhëniet e punës në këtë sektor formalizohen përmes kontratave individuale të punës me afat të caktuar apo të pacaktuar, si edhe formave të tjera të ligjshme të angazhimit profesional.



Inspektorati i Punës ka marrë pjesë aktive në platformën e dialogut të projektit BE / Këshilli i Evropës “Promovimi i Lirisë së Shprehjes në Shqipëri përmes Dialogut të Hapur”, duke kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit institucional mbi standardet evropiane të punës së gazetareve dhe forcimin e koordinimit me aktorët kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Në maj 2025, është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit me Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA), me fokus rritjen e transparencës, informimit dhe respektimit të detyrimeve ligjore në marrëdhëniet e punës në subjektet e medias audiovizive. Në kuadër të këtij bashkëpunimi është hartuar dhe publikuar Fleta Informuese “Punë Dinjitoze në Sektorin e Medias”, e cila u shpërnda pranë 205 subjekteve nën juridiksionin e AMA-s dhe në kanalet zyrtare të komunikimit.



Në korrik 2025 u zhvillua një aktivitet informues i përbashkët **ISHPSHSH**–AMA, ku u prezantua përdorimi i sistemit MIRA për inspektimet e bazuara në risk, me qëllim rritjen e transparencës dhe qasjes parandaluese në sektorin e medias.

Gjatë vitit 2025, **ISHPSHSH** ka trajtuar 17 ankesa që lidhen me sektorin e medias, të depozituara nga punonjës të mediave ose organizata profesionale brenda dhe jashtë vendit. Ankesat janë fokusuar në:



- mosrespektimin e procedurave ligjore të ndërprerjes së marrëdhënies së punës;
- vonesa apo mosshlyerje të pagave;
- moskompensim të orëve shtesë;
- presion psikologjik në vendin e punës.

Nga këto raste, 76% janë zgjidhur plotësisht ose pjesërisht në favor të punonjësve, duke reflektuar efektivitetin e mekanizmave të kontrollit dhe ndërhyrjes së institucionit.

Përmes veprimtarisë inspektuese, bashkëpunimeve ndërinstitucionale dhe aktiviteteve të ndërgjegjësimit, **ISHPSHSH** ka forcuar rolin e tij si garant i të drejtave të punës në sektorin e medias dhe kontribuoi në krijimin e një mjedisi pune më të sigurt, më të drejtë dhe më dinjitoz për gazetarët dhe punonjësit e medias.

Gjatë vitit 2025, **ISHPSHSH** ka vijuar të luajë një rol thelbësor në garantimin e lirive dhe të drejtave sindikale, në një periudhë kur konfliktet kolektive rezultuan më të shpeshta dhe më të ndjeshme krahasuar me vitet paraardhëse. Institucioni ka vepruar në mënyrë të paanshme dhe në përputhje me kompetencat ligjore, duke kontribuar në parandalimin dhe zbutjen e konflikteve përmes kontrolleve të ushtruara, ndërhyrjeve këshilluese dhe pjesëmarrjes në tryeza të dialogut social, sa herë që është kërkuar nga palët ose institucionet e tjera shtetërore. Në këtë kuadër, **ISHPSHSH** ka ruajtur një rol neutral, duke lehtësuar komunikimin midis punëdhënësve, sindikatave dhe punëmarrësve, dhe duke informuar palët mbi kuadrin ligjor të zbatueshëm dhe kufijtë e ndërhyrjes së inspektimit të punës. Institucioni nuk është përfshirë në vlerësimin e vetë konfliktit kolektiv, por ka kontribuar në mënyrë profesionale për të garantuar respektimin e ligjit dhe të procedurave të parashikuara.

Gjatë vitit 2025, pranë **ISHPSHSH** janë paraqitur 33 ankesa/kërkesa që lidhen me liritë dhe të drejtat sindikale. Pretendimet kryesore konsistuan në mosrespektimin e procedurave për fillimin e bisedimeve për lidhjen e kontratave kolektive, moszbatimin e dispozitave të kontratës kolektive, ndërprerjen e marrëdhënies së punës për përfaqësues sindikalë, ndryshimin e kushteve të punës pa pëlqimin e sindikatës, si dhe raste të mosrespektimit të të drejtave të anëtarëve të sindikatave, përfshirë orët shtesë dhe punën në ditë festash.

Për verifikimin e këtyre rasteve, **ISHPSHSH** ka hapur 15 procedura inspektimi, gjatë të cilave janë lënë detyra, janë bërë konstatime dhe janë lëshuar rekomandime për zbatimin e ligjit, kontratave kolektive dhe kontratave individuale të punës. Në 74% të rasteve janë vendosur masa administrative – kryesisht “Paralajmërim” dhe “Gjobë” – si rezultat i shkeljeve të konstatuara. Përmes këtyre ndërhyrjeve, në 80% të rasteve është arritur zgjidhja e konflikteve dhe rivendosja e të drejtave të punëmarrësve të përfaqësuar nga sindikatat.

Kërkesat e depozituara janë trajtuar rast pas rasti dhe janë shoqëruar me përgjigje të argumentuara, duke sqaruar kompetencat e inspektorit të punës dhe duke ofruar këshillime teknike mbi mënyrën më të efektshme të zbatimit dhe interpretimit të dispozitave ligjore. Nëpërmjet këtij angazhimi, **ISHPSHSH** ka forcuar mbrojtjen e lirive dhe të drejtave sindikale, ka kontribuar në zhvillimin e dialogut social dhe ka mbështetur krijimin e një mjedisi pune të drejtë, të sigurt dhe në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të punës.

KATEGORITË E VEÇANTA TË PUNËMARRËSVE

12 QERSHOR
**DITA BOTËRORE KUNDËR
PUNËS SË FËMIJËVE**

Fëmijët nuk duhet të punojnë - ata duhet të mësojnë,
të luajnë dhe të rriten të sigurt.
Vendi i tyre është në shkollë, jo në punë.

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve
Shoqërore angazhohet çdo ditë për të parandaluar
shfrytëzimin e fëmijëve në punë.

RAPORTO ÇDO RAST:
☎ +355 4 236 8466
✉ info@sil.gov.al
🌐 www.inspektoriatipunes.gov.al



Një fokus i vazhdueshëm i veprimtarisë inspektuese ka qenë monitorimi i zbatimit nga ana e subjekteve punëdhënëse të dispozitave të legjislacionit të punës që lidhen me mbrojtjen e kategorive të veçanta të punëmarrësve, në veçanti punëmarrësit nën moshën 18 vjeç, gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë në gji. Gjatë kontrolleve të ushtruara, inspektimet janë përqendruar në verifikimin e kushteve të punës, orarit të punës, natyrës së veprimtarisë së kryer, si dhe në respektimin e të drejtave specifike të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për këto kategori. Si rezultat i veprimtarisë inspektuese, është siguruar marrja e masave përkatëse nga ana e punëdhënësve, me qëllim garantimin e kushteve të përshtatshme dhe të sigurta të punës, në përputhje me kërkesat ligjore. Këto ndërhyrje kanë kontribuar në parandalimin e shkeljeve, në rritjen e nivelit të mbrojtjes së grupeve vulnerabël në

tregun e punës, si dhe në forcimin e zbatimit efektiv të standardeve të punës së denjë.

Gjatë vitit 2025 në bashkëpunimi me OSBE u hartua një manual “Udhëzues mbi inspektimin e punës së fëmijëve”, përmes të cilit synohet të arrihet në një qasje më efektive, të ndjeshme dhe të standardizuar në mbrojtje të fëmijëve nga format e dëmshme të punës. Siguria, shëndeti dhe mirëqenia e fëmijëve që janë në një marrëdhënie pune (punëmarrës nën 18 vjeç). Ky manual ka të pasqyruar në mënyrë të detajuar rreziqet me të cilat përballen fëmijët që punojnë, indikatorët për të punësuarit nën 18 vjeç që vlerësohen nga inspektorët e punës gjatë procesit të inspektimit në subjekte ku evidentohet punësimi i kësaj kategorie punëmarrësish si dhe identifikimi dhe vlerësimi i veprimeve konkrete të ndërmarra nga inspektorët e punës në raste të mospërputhjes së detyrimeve ligjore sipas indikatorëve.

p Inspektorati Shtetëror i Punës
dhe Shërbimeve Shoqërore



UDHËZUES MBI INSPEKTIMIN E
PUNËS SË FËMIJËS

OSCE Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Presenca në Shqipëri

20
25



AGJENCITË PRIVATE TË PUNËSIMIT DHE REKRUTIMI ETIK PUNËTORËVE

Gjatë vitit 2025, Inspektorati i Punës ka ushtruar funksionet e tij mbikëqyrëse dhe rregullatore në monitorimin e veprimtarisë së agjencive private të punësimit, me qëllim sigurimin e ligjshmërisë së aktivitetit të ndërmjetësimit për punësim, respektimin e parimeve të rekrutimit etik dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, përfshirë punëtorët migrantë. Në zbatim të ndryshimeve në kuadrin nënligjor dhe të Udhëzimit nr. 757/2024 të ministrit përgjegjës për çështjet e punës, është forcuar kontrolli institucional ndaj këtij sektori, duke e bërë monitorimin e agjencive private të punësimit një proces të strukturuar dhe të vazhdueshëm.

Në zbatim të ndryshimeve ligjore të vitit 2024 dhe të Udhëzimit nr. 757, datë 30.09.2024, **ISHPSHSH** ka kryer kontrole paraprake në 71 subjekte private që kërkojnë licencim për ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit në tregun e punës, për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të posaçme ligjore. Këto kontrole kanë pasur për qëllim garantimin e proceseve të rregullta, transparente dhe të sigurta të rekrutimit për punëmarrësit e huaj që jetojnë dhe punojnë në Shqipëri.

Gjatë vitit 2025 ka një rritje me 4% të ankesave të paraqitura nga punëmarrësit e huaj krahasimisht me vitin 2024. Kjo rritje reflekton jo vetëm ndërgjegjësimin e shtuar të punëmarrësve të huaj për të drejtat e tyre, por edhe angazhimin e institucionit për ofruar mbrojtje nga çdo formë shkeljeje apo diskriminimi në vendin e punës.

Gjatë vitit 2025 janë depozituar 4 ankesa ndaj subjekteve që ushtronin veprimtarinë si agjenci private punësimi. Si rezultat i inspektimeve të kryera, u identifikuan shkelje të legjislacionit në fuqi në tre (3) agjenci, konkretisht të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 101, datë 23.02.2018, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencive Private të Punësimit" (i ndryshuar). Inspektorati Shtetëror i Punës mori masa administrative në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, të cilat kanë për qëllim zbatimin e ligjit dhe parandalimin e praktikave të paligjshme.

Në tërësi, veprimtaria e **ISHPSHSH**-së gjatë vitit 2025 dëshmon një qasje të qëndrueshme rregullatore, të orientuar drejt respektimit të legjislacionit në fuqi, mbrojtjes së të drejtave të punëmarrësve dhe përfrimit me standardet evropiane në fushën e ndërmjetësimit për punësim.

The image shows a construction site at sunset. In the foreground, two construction workers wearing hard hats are silhouetted against the bright orange and yellow sky. They appear to be in conversation, with one worker pointing towards the right. In the background, the skeletal structure of a building under construction is visible, including a large crane arm extending across the top of the frame. A hook hangs from the crane. The overall scene is a high-contrast silhouette against a vibrant sunset sky.

**SIGURIA DHE
SHËNDETI NË PUNË**

Siguria dhe shëndeti në punë përbëjnë një komponent thelbësor të marrëdhënieve të punës dhe një detyrim ligjor për subjektet punëdhënëse. Garantimi i kushteve të sigurta dhe të shëndetshme të punës ndikon drejtpërdrejt në parandalimin e aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale, në përmirësimin e produktivitetit dhe në forcimin e marrëdhënieve të qëndrueshme të punës. Në këtë kuadër, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore ushtron rolin e tij mbikëqyrës dhe kontrollues për zbatimin e legjislacionit në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë (SSHP), me fokus në parandalimin e rreziqeve dhe në rritjen e përputhshmërisë me kërkesat ligjore.

Gjatë vitit 2025, në të gjitha kategoritë e aktiviteteve ekonomike, konstatohet rritje e nivelit të përputhshmërisë formale të subjekteve me kërkesat ligjore në fushën e SSHP-së. Konkretisht, është evidentuar rritje e përqindjes së subjekteve që disponojnë Dokument të Vlerësimit të Riskut (DVR), që kanë caktuar Koordinator të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, që kanë ngritur Këshilla të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, si dhe që ofrojnë shërbimin e Mjekut të Ndërmarrjes. Këto të dhëna pasqyrojnë përmirësim të nivelit të respektimit të kërkesave ligjore krahasuar me vitin 2024.



Paralelisht me rritjen e përputhshmërisë formale, **ISHPSHSH** ka vijuar punën në drejtim të rritjes së efektivitetit praktik të zbatimit të legjislacionit për sigurinë dhe shëndetin në punë. Vëmendje e veçantë i është kushtuar forcimit të rolit funksional të Koordinatorit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, funksionimit real të Këshillave të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, rolit të Mjekut të Ndërmarrjes, si dhe zbatimit të plotë të masave të përcaktuara në Dokumentin e Vlerësimit të Riskut. Në këtë kuadër, vihet re ulje e përqindjes së subjekteve që disponojnë DVR të pjesshëm krahasuar me vitin 2024, duke treguar një përmirësim në cilësinë e hartimit dhe zbatimit të këtij dokumenti.



Gjatë veprimtarisë inspektuese është monitoruar dhe ndjekur zbatimi i masave të mbrojtjes kolektive dhe individuale, përfshirë pajisjet mbrojtëse individuale, masat teknike dhe organizative të mbrojtjes kolektive, sinjalistikën e sigurisë, si dhe trajnimin dhe informimin e punëmarrësve mbi rreziqet në vendin e punës. Po ashtu, është verifikuar ofrimi i shërbimit

të ndihmës së parë dhe kryerja e kontrolleve periodike shëndetësore për punëmarrësit. Në tërësi, masat e ndërmarra gjatë vitit 2025 synojnë konsolidimin e një qasjeje parandaluese dhe sistematike në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, përmirësimin e treguesve të SSHP-së, uljen e rrezikut të aksidenteve në punë dhe forcimin e kulturës së sigurisë në vendin e punës.

Treguesit e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (SSHP) të konstatuar gjatë inspektimeve të vitit 2025 krahasimisht me inspektimet e vitit 2024

Tregues të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë	2025 (%)	2024 (%)
Subjekte që disponojnë Dokument të Vlerësimit të Riskut	72	66
Subjekte me Dokument të Vlerësimit të Riskut (i pjesshëm)	5	8
Subjekte me Këshill Sigurie dhe Shëndeti në Punë	18	16
Subjekte me shërbim mjeku ndërmarrjeje (kohë e pjesshme)	46	40
Subjekte me shërbim mjeku ndërmarrjeje (kohë e plotë)	3	4
Subjekte me masa mbrojtëse kolektive	87	85
Subjekte me masa mbrojtëse individuale	91	89
Subjekte me shërbim të ndihmës së parë	84	81
Subjekte ku kryhen kontrolle periodike shëndetësore	78	72

AKSIDENTET NË PUNË

Aksidentet në punë përbëjnë një nga treguesit kryesorë për vlerësimin e nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe të efektivitetit të masave parandaluese të zbatuara në vendet e punës. Gjatë vitit 2025, aksidentaliteti në punë ka vijuar të mbetet një çështje me rëndësi të veçantë, veçanërisht në sektorët me risk të lartë, duke evidentuar nevojën për forcimin e mëtejshëm të masave teknike, organizative dhe mbikëqyrëse. Në këtë kuadër, Inspektorati i Punës ka trajtuar aksidentet në punë jo vetëm nga këndvështrimi i reagimit dhe hetimit administrativ, por edhe si një instrument analitik për identifikimin e shkaqeve rrënjësore, mangësive në sistemet e sigurisë dhe orientimin e ndërhyrjeve parandaluese, me synim uljen e frekuencës dhe pasojave të aksidenteve, si dhe mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punëmarrësve.

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME DHE KUADRI I KLASIFIKIMIT TË AKSIDENTEVE NË PUNË

Gjatë vitit 2025 janë regjistruar gjithsej 275 raste aksidenti në punë, për të cilat janë hapur çështje inspektimi dhe është kryer verifikim administrativ i plotë. Pas procesit të hetimit dhe vlerësimit ligjor, rezulton se 93,9% e rasteve janë klasifikuar si aksidente në punë, ndërsa 6.1% e rasteve nuk janë vlerësuar si të tilla, në përputhje me kriteret dhe përkufizimet e parashikuara nga legjislati në fuqi. Ky tregues dëshmon një proces të konsoliduar verifikimi, i cili synon të garantojë saktësi në klasifikimin e ngjarjeve dhe trajtim të njëtrajtshëm administrativ.

Njoftimi i aksidenteve në punë është realizuar përmes burimeve të ndryshme, përfshirë punëdhënësit, punëmarrësit ose familjarët e tyre, si dhe institucione të tjera shtetërore, si Policia e Shtetit, Prokuroria dhe media. Nga totali i rasteve të njoftuara, 96% janë raportuar nga punëdhënësit, duke shënuar një rritje prej rreth 6% krahasuar me vitin 2024. Ky zhvillim përbën një indikator pozitiv të rritjes së ndërgjegjësimit të subjekteve punëdhënëse për detyrimin ligjor të deklarimit të aksidenteve pranë Inspektorati i Punës. Në të njëjtën kohë, vërehet edhe një rritje prej 1,9% e njoftimeve për aksidente nëpërmjet ankesave dhe raportimeve nga vetë punëmarrësit ose familjarët e tyre, krahasuar me vitin 2024.



PASOJAT, TENDENCAT DHE REAGIMI INSTITUCIONAL

Nga 275 rastet e regjistruara gjatë vitit 2025, janë evidentuar 212 punëmarrës të aksidentuar në punë, përfshirë 48 aksidente me pasojë fatale, duke reflektuar një rritje krahasuar me vitin 2024. Paralelisht, inspektimet e kryera për shkak aksidenti në punë janë rritur me rreth 23%, çka tregon një reagim më të shpejtë dhe më intensiv institucional ndaj ngjarjeve të raportuara.

Nga inspektimet e realizuara për shkak aksidenti në punë gjatë vitit 2025, rezulton se 100% e rasteve janë shoqëruar me masa administrative, duke reflektuar një reagim të menjëhershëm dhe rigoroz të **ISHPSHSH**-së ndaj shkeljeve të konstatuara. Në një pjesë të subjekteve të inspektuara janë vendosur më shumë se një masë administrative, pasi gjatë procesit inspektues janë evidentuar shkelje të ndryshme të cilat kanë kërkuar trajtim të diferencuar dhe proporcional, në përputhje me natyrën dhe rëndësinë e secilës shkelje. Ky fakt shpjegon diferencën ndërmjet numrit të inspektimeve dhe numrit total të masave të

vendosura, pa cenuar qartësinë e treguesit se çdo rast aksidenti ka rezultuar me ndërhyrje administrative. Qasja e ndjekur konfirmon orientimin institucional drejt zbatimit efektiv të ligjit, forcimit të përgjegjshmërisë së punëdhënësve dhe garantimit të standardeve të sigurisë dhe shëndetit në punë.



Krahasuar me vitin e shkuar, konstatohet një rritje prej rreth 35% e numrit total të punëmarrësve të aksidentuar dhe 15 punëmarrës më shumë me pasojë fatale. Megjithatë, analiza e detajuar tregon se kjo rritje nuk lidhet në mënyrë proporcionale me një përkeqësim të kushteve të brendshme të sigurisë në vendet e punës, por në një masë të konsiderueshme me aksidentet rrugore, të cilat, në përputhje me legjislacionin në fuqi, klasifikohen si aksidente në punë. Në vitin 2025, aksidentet rrugore përbëjnë rreth

17% të aksidenteve totale në punë dhe 19% të aksidenteve fatale, ndërkohë që në vitin 2024 këto përqindje ishin përkatësisht 14% dhe 9%. Kjo rritje tregon një ndryshim të strukturës së riskut, me peshë më të lartë të faktorëve të jashtëm ndaj vendit të punës, veçanërisht riskut rrugor, i cili ndikon drejtpërdrejt në treguesit e përgjithshëm.

Duke përjashtuar aksidentet rrugore nga analiza, rezulton se aksidentet e ndodhura drejtpërdrejt në vendin e punës kanë shfaqur një rritje të kufizuar krahasuar me vitin 2024. Ky fakt sugjeron se rritja e përgjithshme e aksidenteve gjatë vitit 2025 lidhet kryesisht me ndryshimin e profilin të riskut dhe jo me një përkeqësim proporcional të masave të brendshme të sigurisë dhe shëndetit në punë në subjektet e inspektuara. Në këtë kontekst, qasja institucionale e **ISHPSHSH**-së është e diferencuar. Për aksidentet e lidhura drejtpërdrejt me kushtet e punës, fokusi mbetet në forcimin e masave parandaluese, kontrollin rigoroz të zbatimit të detyrimeve ligjore dhe marrjen e masave administrative proporcionale. Ndërkohë, për aksidentet rrugore të klasifikuara si aksidente në punë për shkak të parashikimeve ligjore, ndërhyrja institucionale orientohet drejt analizës së riskut, ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional, me qëllim reduktimin e këtij fenomeni në rritje.

Gjithashtu, gjatë vitit 2025 janë regjistruar 7 incidente në punë, praktikë që ka rezultuar pozitive gjatë tre viteve të fundit për identifikimin paraprak të rreziqeve dhe marrjen e masave parandaluese në subjektet përkatëse. Regjistrimi dhe trajtimi i incidenteve pa pasoja përbën një element të rëndësishëm të kulturës së parandalimit dhe një instrument efektiv për uljen e probabilitetit të aksidenteve të rënda në të ardhmen.





PËRMIRËSIM I TREGUT TË PUNËS

Nga **34,712** punëmarrës me pagë minimale në vitin **2024**,
në vetëm **8,637** në **2025**. **75%** më pak.

ANALIZA E SEKTORËVE TË EKONOMISË E AKSIDENTEVE NË PUNË

Analiza sektoriale e aksidenteve në punë për vitin 2025, e mbështetur në klasifikimin e Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), evidenton një përqendrim të konsiderueshëm të aksidenteve pa pasojë fatale në disa sektorë ekonomikë specifikë. Numrin më të lartë e zë kategoria “Aktivitete të tjera” me 29,5%, e cila, ndonëse heterogjene në përbërje, përfaqëson një peshë të konsiderueshme në totalin e aksidenteve. Brenda kësaj kategorie, një pjesë e rëndësishme e rasteve lidhet me aksidente rrugore të ndodhura gjatë kohës së punës, çka ndikon ndjeshëm në rritjen e përgjithshme të aksidenteve për vitin 2025. Kjo kategori pasohet nga sektori i ndërtimit (22,6%), prodhimi (20,7%) dhe sektori minerar (14,6%). Në tërësi, shpërndarja sektoriale konfirmon se aksidentet në punë mbeten të përqendruara në sektorë me rrezik të lartë operacional dhe organizativ, duke nënvizuar nevojën për masa të synuara parandaluese, forcim të kulturës së sigurisë dhe ndërhyrje inspektuese të bazuara në risk, me fokus të veçantë në sektorët që kontribuojnë në peshën më të madhe të aksidenteve.

Ndryshe nga aksidentet pa pasoja fatale, aksidentet me pasojë vdekje paraqesin një shpërndarje më të përqendruar në sektorët me risk të lartë profesional. Të dhënat tregojnë se 37,5% e aksidenteve fatale kanë ndodhur në sektorin e ndërtimit, 18,7% në sektorin minerar dhe 16,6% në kategorinë “Aktivitete të tjera”. Ky profilizim konfirmon se rreziku fatal lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punës, kushtet teknike të kryerjes së aktivitetit dhe nivelin e zbatimit të masave të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Në sektorin minerar, trajtimi i aksidenteve në punë zhvillohet në një kuadër të veçantë ligjor dhe institucional. Inspektimet në nëntokë rregullohen nga legjislacioni i posaçëm dhe janë në kompetencë të Autoritetit Kombëtar të Sigurisë dhe Emergjencave në Miniera (AKSEM). Në këtë kuadër, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore ushtron bashkëpunim institucional me AKSEM për shkëmbimin e informacionit, analizën e rasteve të aksidenteve dhe koordinimin e ndërhyrjeve, me qëllim garantimin e një qasjeje të integruar dhe efektive për parandalimin e rreziqeve në këtë sektor me ndjeshmëri të lartë.

SEKTORI I NDËRTIMIT

Sektori i ndërtimit vijon të mbetet një nga sektorët me riskun më të lartë për sigurinë dhe shëndetin në punë, për shkak të natyrës së aktivitetit, përdorimit të punës në lartësi, ekspozimit ndaj rreziqeve mekanike dhe dinamikës së lartë të fuqisë punëtore. Gjatë vitit 2025 janë regjistruar 48 punëmarrës të aksidentuar në këtë sektor, nga të cilët 18 aksidente me pasojë fatale, ndërkohë që në vitin 2024 ishin regjistruar 37 punëmarrës të aksidentuar, prej të cilëve 11 me pasojë vdekje. Kjo rritje e ndjeshme e aksidenteve, veçanërisht atyre fatale, përbën një sinjal alarmi për nevojën e ndërhyrjeve më të forta parandaluese dhe inspektuese.

Analiza e shkaqeve të aksidenteve fatale në sektorin e ndërtimit tregon se ato lidhen kryesisht me rëniet nga lartësia (45,4%), rënien e objekteve nga lartësia (27,2%), si dhe me mungesën ose zbatimin e pamjaftueshëm të masave mbrojtëse kolektive dhe individuale.

Këto gjetje evidentojnë mangësi serioze në planifikimin e sigurisë, organizimin e vendit të punës dhe kulturën e parandalimit të rrezikut, veçanërisht në kantieret e përkohshme ose me afate të shkurtra.



Rritja e aksidenteve në këtë sektor lidhet gjithashtu me zgjerimin e aktivitetit ndërtimor në nivel kombëtar. Sipas të dhënave të INSTAT, numri i subjekteve aktive në ndërtim është rritur me rreth 7–8% gjatë viteve 2024–2025, veçanërisht në zonat urbane dhe turistike. Ky zgjerim ka sjellë rritje të ekspozimit ndaj rreziqeve profesionale, shtim të fuqisë punëtore dhe angazhim të punonjësve sezonalë ose të patrajnuar mjaftueshëm, duke rritur probabilitetin e aksidenteve në mungesë të masave të forta parandaluese.

Gjatë vitit 2025, Inspektorati Shtetëror i Punës ka intensifikuar vizitat inspektuese me bazë këshillimi dhe informimi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Këto vizita janë fokusuar në forcimin e kulturës së sigurisë dhe shëndetit në punë, duke pasur në qendër sektorin e ndërtimit, si sektor me zhvillim të shpejtë dhe nivel të lartë rrisht profesional. Paralelisht, vizitat këshilluese janë zhvilluar edhe në sektorë të tjerë ekonomikë, në përputhje me vlerësimin e riskut dhe problematikat e konstatuara gjatë veprimtarisë inspektuese, duke synuar rritjen e ndërgjegjësimit të subjekteve, përmirësimin e zbatimit të masave parandaluese dhe forcimin e kushteve të sigurta dhe të shëndetshme të punës.

Në këtë kontekst, qëndrimi institucional i **ISHPSHSH** është i qartë: sektori i ndërtimit do të vijojë të trajtohet si prioritet i veçantë inspektues, me fokus në parandalimin e aksidenteve fatale, forcimin e masave mbrojtëse kolektive dhe individuale, rritjen e përgjegjshmërisë së punëdhënësve dhe ndërgjegjësimin e punëmarrësve. Veprimtaria inspektuese do të orientohet mbi bazë rrisht, e kombinuar me masa parandaluese, këshilluese dhe, kur është e nevojshme, sanksionuese, në mënyrë që të reduktohet ekspozimi ndaj rreziqeve në këtë sektor strategjik.

ANALIZA E TREGUESVE STATISTIKORË TË INSPEKTIMIT

Ky seksion paraqet analizën e treguesve statistikorë të veprimtarisë inspektuese për vitin 2025 krahasimisht, me qëllim ofrimin e një pasqyre të plotë mbi shtrirjen, intensitetin dhe efektet e inspektimit të punës. Analiza fokusohet si në aspektin numerik të subjekteve të inspektuara, ashtu edhe në vlerësimin e numrit të punëmarrësve dhe vendeve të punës që i janë nënshtruar inspektimit gjatë vitit raportues. Në këtë kuadër, paraqiten të dhëna të krahasuara dhe të disagreguara sipas llojit të inspektimit, llojit të aktivitetit ekonomik, shpërndarjes gjeografike, përbërjes gjinore, nivelit të informalitetit dhe strukturës së masave administrative të vendosura. Treguesit e analizuar shërbejnë për identifikimin e problematikave kryesore që reflekton tregu i punësimit dhe për vlerësimin e riskut të zbatimit të legjislacionit, duke mbështetur orientimin e ndërhyrjeve inspektuese drejt subjekteve dhe sektorëve me potencial më të lartë risku.

Gjatë vitit 2025, Inspektorati Shtetëror i Punës ka ushtruar veprimtari inspektuese ndaj 9,532 subjekteve ekonomike, private dhe shtetërore, duke mbuluar një shtrirje të gjerë të tregut të punës. Në kuadër të këtyre inspektimeve janë kontrolluar gjithsej 205,196 vende pune, çka përfaqëson një rritje të ndjeshme të numrit të punëmarrësve të përfshirë në procesin inspektues krahasuar me vitin pararendës. Mesatarisht, çdo subjekt i inspektuar ka pasur rreth 22 punëmarrës, tregues që reflekton një fokus më të madh të inspektimeve në subjekte me strukturë më komplekse organizative dhe me impakt më të lartë.

Në aspektin e ngarkesës së punës, gjatë vitit 2025 janë realizuar mesatarisht 113 inspektime për çdo inspektor, duke dëshmuar një intensitet të lartë të veprimtarisë inspektuese dhe një shfrytëzim efikas të kapaciteteve njerëzore në dispozicion. Ky tregues merr rëndësi të veçantë në kushtet kur veprimtaria inspektuese është zhvilluar në prani të vakancave në organikën e inspektorëve, faktor i cili ka ndikuar në uljen e lehtë të numrit total të inspektimeve, por jo në cilësinë e tyre.

Analiza krahasuese e treguesve për vitet 2023–2025, e paraqitur më poshtë në formë tabelare, tregon se ndonëse numri total i inspektimeve në vitin 2025 është rreth 3% më i ulët krahasuar me vitin 2024, kjo rënie nuk ka reflektuar dobësim të veprimtarisë inspektuese. Përkundrazi, këta tregues dëshmojnë një orientim më të fokusuar dhe cilësor të inspektimeve, të bazuar në analiza risku dhe prioritete të qarta inspektuese. Konkretisht, gjatë vitit 2025 evidentohet rritje e normës së zbulimit të punësimit informal dhe rritje e përqindjes së inspektimeve të shoqëruara me masa administrative, duke reflektuar përmirësim të efektivitetit dhe të cilësisë së ndërhyrjes inspektuese. Në këtë kuptim, ulja relative e numrit të inspektimeve nuk përbën një tregues negativ, por dëshmon një përdorim më racional të burimeve njerëzore dhe një qasje më të targetuar ndaj subjekteve me potencial më të lartë risku për shkelje të legjislacionit të punës.

Në vijim, tabela përkatëse paraqet në mënyrë të detajuar treguesit krahasues të veprimtarisë inspektuese për vitet 2023, 2024 dhe 2025, duke ofruar bazën numerike për analizën e mëtejshme të trendeve dhe performancës institucionale e disagreguar në aspektin gjinor.

Tregues Inspektimi	Viti 2025	Viti 2024	Viti 2023
Subjekte të inspektuara Private + Shtetërore	9,532	9,860	9,938
Vende pune të inspektuara	205,196	190,340	216,594
Punëmarrëse femra Private + Shtetërore	95973	90521	106,368
Mesatare e punëmarrësve për subjekt	21.52	19.3	21.7
Subjekte private të inspektuara	9,374	9,746	9,820
Vende pune të inspektuara në Subjektet Private	184,970	171,201	201,678
Punëmarrëse femra në Subjekte Private	87,137	84,957	92,276
Mesatare punëmar/subjekt në Subjekte Private	19.7	17.6	20.5
Punëmarrës pa kontrata individuale të evidentuar	2,999	3,952	2,502
Punëmarrëse femra pa kontrata individuale	1,138	1,758	1047
Punëmarrës informal të evidentuar	2,591	2,600	1,965
Punëmarrëse informale femra të evidentuar	904	1008	741
Punëmarrës informal të futur në skemën e SSH	2,538	2,575	1,949
Punëmarrëse informale femra të futur në skemën e SSH	976	996	741
Punëmarrës nën 18 vjeç të evidentuar	165	124	215
Punëmarrëse femra nën 18 vjeç të evidentuara	51	51	75
Punëmarrës të huaj të evidentuar	2,484	1536	1,350
Punëmarrës të huaj, pa leje pune	83	93	27
Punëmarrës me aftësi të kufizuar	24	46	103
Punëmarrëse femra me aftësi të kufizuar	10	11	25
Punëmarrës që kryejnë punën në shtëpi (telepuna)	344	2,730	190
Punëmarrëse femra që kryejnë punën në shtëpi(telepuna)	207	1,790	119
Subjekte me masë “Pezullim” për marrëdhëniet e punës	1,003	1,098	936
Subjekte me masë “Pezullim” për sigurinë e shëndetit	266	318	179
Subjekte me masë “Paralajmërim”	4,191	1,807	1,243
Subjekte me masë Gjobë”	268	210	148
Vlera totale e sanksioneve (lekë)	64,584,000	53,770,000	43,735,000
Inspektive të programuara	6,434	7,374	8,254
Inspektive me tematikë	1,652	1,448	848
Inspektive për shkak ankese	963	690	544
Inspektim rastësor	208	124	74
Inspektive për shkak aksidenti në punë	275	224	218
Punëmarrës të aksidentuar në punë	212	177	168
Punëmarrëse femra të aksidentuara në punë	38	22	21
Punëmarrës të aksidentuar në punë me vdekje	48	33	30
Punëmarrëse femra të aksidentuara në punë me vdekje	2	2	1

Në aspektin gjinor, të dhënat reflektojnë një prani të konsiderueshme të punëmarrëseve femra si në sektorin privat ashtu edhe në atë shtetëror pasi në subjektet e inspektuara janë evidentuar në total 95,973 punëmarrëse femra nga të cilat 87,137 në subjektet private. Ky fakt nënvizon rëndësinë e integritimit të perspektivës gjinore në analizën e treguesve të inspektimit dhe në adresimin e problematikave që prekin në mënyrë të veçantë gratë në tregun e punës.

Treguesit që lidhen me formalizimin e marrëdhënieve të punës tregojnë përmirësim gradual, por edhe vijimësi të problematikave strukturore. Në vitin 2025 janë evidentuar 2,999 punëmarrës pa kontrata individuale pune, një rënie krahasuar me vitin 2024, si dhe 2,591 punëmarrës informalë, nga të cilët një pjesë dërrmuese është futur në skemën e sigurimeve shoqërore (2,538 raste). Ky tregues dëshmon efektivitetin e ndërhyrjeve inspektuese në drejtim të formalizimit, por edhe nevojën për vijimësi të kontrollit në sektorët me informalitet të qëndrueshëm.

Një element me rëndësi të veçantë është rritja e numrit të punëmarrësve të huaj të evidentuar, nga 1,350 në vitin 2023 në 2,484 në vitin 2025, çka reflekton ndryshimet strukturore të tregut të punës dhe rritjen e kërkesës për fuqi punëtore nga jashtë vendit. Paralelisht, numri i punëmarrësve të huaj pa leje pune ka shënuar rënie, duke treguar një përmirësim të nivelit të përputhshmërisë ligjore dhe efektin e kontroleve të shtuara në këtë fushë.

Të dhënat mbi punësimin e të miturve nën 18 vjeç tregojnë një rritje të rasteve të evidentuara në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024, çka kërkon vëmendje të shtuar inspektuese dhe masa parandaluese specifike, në përputhje me detyrimet ligjore për mbrojtjen e kësaj kategorie vulnerabël. Ndërkohë, treguesit për punëmarrësit me aftësi të kufizuar dhe për telepunën reflektojnë ndryshime strukturore në organizimin e punës dhe nevojën për përshtatje të vazhdueshme të mekanizmave të kontrollit.

Në aspektin e masave administrative, vërehet një rritje e ndjeshme e përdorimit të masës "Paralajmërim" në vitin 2025, si dhe rritje e numrit të gjobave dhe e vlerës totale të sanksioneve, e cila ka arritur në 64.6 milionë lekë. Kjo strukturë e masave tregon një qasje të balancuar ndërmjet korrigjimit dhe ndëshkimit, të orientuar drejt përmirësimit të përputhshmërisë ligjore dhe parandalimit të shkeljeve të përsëritura.

Së fundi, analiza e llojeve të inspektimeve tregon një zhvendosje graduale nga inspektimet e programuara drejt inspektimeve me tematikë, mbi bazë ankese dhe për shkak aksidenti, duke reflektuar një qasje më dinamike dhe të orientuar mbi bazë risku. Rritja e inspektimeve për shkak ankese dhe aksidenti, si dhe e numrit të punëmarrësve të aksidentuar, përfshirë ata me pasojë fatale, thekson nevojën për forcimin e mëtejshëm të masave parandaluese dhe të kontroleve të synuara në sektorët me risk të lartë.

TIPOLOGJIA E INSPEKTIMEVE DHE PERSPEKTIVA ANALITIKE E VEPRIMTARISË INSPEKTUESE

Struktura e inspektimeve të realizuara gjatë vitit 2025 tregon një ndryshim domethënës në tipologjinë e ndërhyrjeve inspektuese, krahasuar me vitin 2024. Vihet re rritje e inspektimeve për shkak ankese, inspektimeve tematike dhe inspektimeve rastësore, ndërkohë që inspektimet e programuara kanë shënuar ulje. Ky zhvillim reflekton një fleksibilitet më të madh të planifikimit inspektues, të orientuar gjithnjë e më shumë nga risku real, sinjalet konkrete të problematikave në terren dhe nevojat reaguese, pa cenuar parimin e planifikimit sistematik. Në tërësi, nga 9,860 inspektime të realizuara gjatë vitit 2025, 67% kanë qenë inspektime të programuara, 17% inspektime tematike, 10% inspektime për shkak ankese, 3% inspektime për shkak aksidenti në punë dhe 2% inspektime rastësore.

INSPEKTIMET E PROGRAMUARA

Inspektimet e programuara përbëjnë shtyllën kryesore të veprimtarisë inspektuese, me 6,434 raste, duke garantuar parashikueshmëri, standardizim dhe përdorim racional të burimeve. Dominimi i kësaj kategorie dëshmon se **ISHPSHSH** ka vijuar të mbështetet në analiza të strukturuar risku, historik shkeljesh dhe prioritete sektoriale, duke ruajtur qëndrueshmërinë e ndërhyrjeve dhe efektivitetin afatgjatë të kontrollit.

INSPEKTIMET TEMATIKE

Me 1,652 inspektime ose 17% të totalit, inspektimet tematike reflektojnë një qasje më të thelluar dhe të fokusuar ndaj problematikave specifike. Këto përfshijnë riinspektime, inspektime me kërkesë, këshillime, urdhra ministrorë dhe autorizime, duke u shërbyer si mekanizëm korigjues dhe verifikues për zbatimin e masave të lëna më parë. Kjo kategori forcon dimensionin parandalues dhe edukues të inspektimit dhe kontribuon në rritjen e përputhshmërisë ligjore.

INSPEKTIMET PËR SHKAK ANKESE

Inspektimet për shkak ankese, me 963 raste ose 10% të totalit, përfaqësojnë një tregues të rëndësishëm të rritjes së besimit të punëmarrësve dhe qytetarëve ndaj institucionit, si dhe të ndërgjegjësimit për raportimin e shkeljeve. Kjo tipologji kërkon reagim të shpejtë dhe menaxhim të kujdesshëm të burimeve, pasi ankesa përbën një sinjal të drejtpërdrejtë për shkelje me impakt real në marrëdhëniet e punës.

INSPEKTIMET PËR SHKAK AKSIDENTI NË PUNË

Me 275 inspektime ose 3% të totalit, kjo kategori ka peshë të lartë cilësore, pasi lidhet drejtpërdrejt me sigurinë dhe shëndetin në punë. Këto inspektime synojnë identifikimin e shkaqeve, përgjegjësive dhe masave parandaluese, duke kontribuar në uljen e riskut të përsëritjes së aksidenteve dhe në forcimin e kulturës së sigurisë në vendin e punës.

INSPEKTIMET RASTËSORE

Inspektimet rastësore, ndonëse përbëjnë vetëm 2% të totalit, luajnë rol të rëndësishëm parandalues, duke rritur perceptimin e probabilitetit të kontrollit dhe duke ndihmuar në zbulimin e shkeljeve që mund të mos identifikohen përmes planifikimit paraprak.

Arsye e inspektimit	Nr. Inspektimeve	% kundrejt totalit
Të programuara	6,434	67 %
Tematike (riinspektim, kërkesë, këshillim, urdher, etj.)	1652	17%
Ankese	963	10%
Aksidenti në punë	275	3%
Rastësor	208	2%
TOTAL	9,532	100%

Tab. Numri i inspektimeve sipas arsyes së inspektimit

Analiza sipas drejtorive rajonale tregon se 67% e inspektimeve në nivel kombëtar janë të programuara, ndërsa 33% realizohen jashtë programit, duke reflektuar një nivel të konsiderueshëm fleksibiliteti operacional. Rajoni Tiranë mban peshën kryesore të veprimtarisë inspektuese, në përputhje me përqendrimin më të lartë të subjekteve ekonomike dhe punëmarrësve. Drejtoria Qendrore nuk realizon inspektime të programuara, duke reflektuar qartë rolin e saj mbikëqyrës, koordinues dhe mbështetës.

Inspektimet jashtë programit dominohen nga inspektimet tematike (17.3%) dhe ato për shkak ankese (10.1%), të cilat përbëjnë mekanizmat kryesorë korrigjues dhe reagues. Rajoni Dibër dhe Rajoni Gjirokastrë dallohen për peshë më të lartë të inspektimeve për shkak aksidenti dhe rastësore, ndërsa Rajoni Korçë shfaq stabilitet më të lartë planifikimi, me përqindje të ulët të inspektimeve jashtë programit.

INSPEKTIMET QË JANË KRYER MBI BAZË “KËRKESE” TË SUBJEKTIT

Në kuadër të inspektimeve të realizuara jashtë programimit vjetor, përfshihen edhe inspektimet e kryera mbi bazë kërkesë të drejtpërdrejtë nga subjektet, të cilat klasifikohen në grupin e inspektimeve “Tematike (riinspektim, kërkesë, këshillim, urdhër ministri, autorizime, etj.)”, sipas tabelës së inspektimeve sipas arsyes së kryerjes. Kjo kategori përbën të vetmet inspektime që realizohen me procedurë njoftimi paraprak, për shkak të natyrës së tyre verifikuese dhe autorizuese. Kërkesat për këtë lloj inspektimi depozitohen drejtpërdrejt nga subjektet përmes sistemit elektronik “e-Albania”, në kuadër të Reformës së Deregulimit, duke synuar thjeshtimin e procedurave administrative dhe rritjen e transparencës institucionale. Gjatë vitit 2025 janë trajtuar gjithsej 96 kërkesa, të cilat janë shoqëruar me inspektime përkatëse, të shpërndara sipas natyrës së kërkesës si më poshtë:

- 30% e kërkesave kanë pasur si objekt marrjen e autorizimit për punësimin e punëmarrësve nën moshën 18 vjeç;
- 10% janë paraqitur për autorizim për kryerjen e punës në orë shtesë;
- 59% kanë qenë kërkesa për pajisje me leje pune para fillimit të ushtrimit të aktivitetit në ndërmarrje.

PERSPEKTIVA SEKTORIALE DHE ORIENTIMI MBI BAZË RISKU

Analiza krahasuese sipas sektorëve ekonomikë për vitet 2024–2025 tregon një ridimensionim të shpërndarjes sektoriale të inspektimeve, në përputhje me dinamikën e tregut të punës dhe prioritetet e riskut. Në vitin 2025 shënohet rritje e ndjeshme e inspektimeve në sektorin e tregtisë (H-B-R), nga 3,305 në 3,784 inspektime, duke e konsoliduar këtë sektor si prioritar për shkak të volumit të lartë të subjekteve, qarkullimit të punëmarrësve dhe riskut për informalitet. Rritje vihet re edhe në sektorin e transportit dhe në financë e shërbime, ndërsa sektorët e ndërtimit dhe minierave shënojnë ulje të inspektimeve, si rezultat i një qasjeje më selektive dhe të targetuar. Sektorët e prodhimit dhe bujqësisë paraqiten relativisht të qëndrueshëm, ndërsa ulja në kategorinë “Të tjera” reflekton rishpërndarje të burimeve drejt sektorëve me risk më të lartë.

Në tërësi, tipologjia e inspektimeve për vitin 2025 dëshmon një kalim nga një qasje kryesisht sasiore drejt një qasjeje më cilësore dhe të targetuar, të orientuar mbi bazë risku, sinjale reale dhe ndikim në tregun e punës. Kjo qasje rrit efektivitetin e ndërhyrjeve inspektuese, forcon funksionin parandalues dhe mbështet përmirësimin e përputhshmërisë ligjore në sektorët dhe rajonet me potencial më të lartë problematikash.

Analiza e inspektimeve sipas Drejtorive Rajonale tregon se përqindjen më të lartë e inspektimeve në nivel kombëtar janë realizuar në formë të programuar, duke reflektuar një qasje të konsoliduar planifikimi me bazë risku. Rajoni Tiranë mban peshën kryesore të veprimtarisë inspektuese, si për nga numri total i inspektimeve ashtu edhe për inspektimet e programuara, në përputhje me përqendrimin më të lartë të subjekteve ekonomike dhe punëmarrësve. Drejtoria Qendrore nuk ka realizuar inspektime të programuara, duke reflektuar rolin e saj mbikëqyrës, koordinues dhe mbështetës.

Analiza e inspektimeve të kryera jashtë programit tregon se ato përbëjnë 33% të totalit të inspektimeve, duke reflektuar një nivel të konsiderueshëm fleksibiliteti operacional dhe aftësi reagimi ndaj situatave të paparashikuara. Peshën kryesore të kësaj kategorie e zënë inspektimet tematike (1,652 raste) dhe inspektimet për shkak ankese (963 raste), të cilat përfaqësojnë mekanizmat kryesorë korrigjues dhe reagues të veprimtarisë inspektuese.

Rajoni Tiranë paraqet numrin më të lartë absolut të inspektimeve jashtë programit, në përputhje me volumin e përgjithshëm të aktivitetit inspektues dhe kompleksitetin e tregut të punës. Në terma përqindje, Rajoni Vlorë dhe Drejtoria Qendrore shfaqin peshën më të lartë të inspektimeve jashtë programit, përkatësisht 45% dhe 100%, ku kjo e fundit reflekton rolin e saj tërësisht reagues dhe mbështetës. Ndërkohë, Rajoni Korçë evidentohet me përqindjen më të ulët të inspektimeve jashtë programit (15%), duke dëshmuar një stabilitet më të lartë të planifikimit dhe parashikueshmëri të ndërhyrjeve.

Drejtoritë Rajonale	Inspektimeve Jashtë Programi ne % kundrejt totalit te inspektimeve per rajon			
	Tematike	Aksident Punë	Ankesë	Rastësore
Rajoni Tiranë	16.4%	2.8%	13.9%	1.5%
Rajoni Vlorë	27.7%	3.2%	11.0%	2.9%
Rajoni Dibër	11.8%	10.1%	3.9%	8.8%
Rajoni Korcë	9.3%	1.5%	2.9%	1.2%
Rajoni Shkodër	25.4%	3.1%	5.7%	0.3%
Rajoni Gjirokastër	10.4%	1.4%	1.8%	6.9%
Drejtoria Qëndrore	83.6%	2.7%	13.6%	0%
TOTALI	17.3%	2.9%	10.1%	2.2%

Tab. Numri i inspektimeve sipas arsyes së inspektimit

Shpërndarja në përqindje e inspektimeve jashtë programit tregon se, në nivel kombëtar, inspektimet tematike (17.3%) dhe inspektimet për shkak ankese (10.1%) përbëjnë komponentët kryesorë të ndërhyrjeve reaguese, ndërkohë që inspektimet për aksidente në punë (2.9%) dhe ato rastësore (2.2%) mbeten në nivele më të kufizuara.

Në nivel rajonal, Rajoni Dibër dhe Rajoni Gjirokastër dallohen për përqindje relativisht të larta të inspektimeve për shkak aksidenti në punë dhe rastësore. Rajoni Tiranë dhe Rajoni Vlorë shfaqin peshë më të lartë të inspektimeve për shkak ankese, në përputhje me volumin e aktivitetit ekonomik dhe ndërgjegjësimin më të madh për raportimin e shkeljeve.

Rajoni Korçë paraqet nivelet më të ulëta të inspektimeve jashtë programit në të gjitha kategoritë, duke reflektuar një stabilitet më të lartë të planifikimit inspektues, ndërkohë që Drejtoria Qendrore karakterizohet nga një profil kryesisht reagues, me dominim të inspektimeve për shkak ankese, në përputhje me funksionin e saj koordinues dhe mbështetës.

ANALIZA KRAHASUESE E INSPEKTIMEVE SIPAS LLOJIT TË AKTIVITETIT EKONOMIK PËR VITET 2024–2025

Në vitin 2025 është evidentuar një rritje e ndjeshme e inspektimeve në sektorin e tregtisë (H-B-R), nga 3,305 inspektime në vitin 2024 në 3,784 inspektime në vitin 2025, duke e konsoliduar këtë sektor si fushën me peshën më të madhe të ndërhyrjeve inspektuese, për shkak të numrit të lartë të subjekteve, qarkullimit të punëmarrësve dhe riskut për informalitet.

Gjithashtu, rritje shënohet në sektorin e transportit, ku inspektimet janë rritur nga 153 në 272, si dhe në sektorin financë dhe shërbime, nga 54 në 67 inspektime, duke reflektuar një fokus më të shtuar në sektorë në zhvillim dhe me specifika të veçanta rregullatore.

Ndërkohë, sektorët e ndërtimit dhe minierave/karierave kanë shënuar një ulje të inspektimeve, respektivisht nga 2,547 në 2,122 dhe nga 194 në 150 inspektime. Kjo ulje lidhet me një orientim më selektiv të kontrolleve, si dhe me efektin e masave parandaluese dhe korrigjuese të ndërmarra në vitet pararendëse.

Sektorët ndërmarrje prodhuese dhe bujqësi, pyje dhe peshkim paraqiten relativisht të qëndrueshëm duke treguar një stabilitet të riskut të vlerësuar dhe të planifikimit inspektues. Në kategorinë “Të tjera” vihet re një ulje e ndjeshme e inspektimeve, nga 1,923 në vitin 2024 në 1,478 në vitin 2025, çka reflekton një rishpërndarje të burimeve drejt sektorëve prioritarë.

Në tërësi, të dhënat dëshmojnë një qasje më të targetuar dhe më efektive të inspektimeve, të orientuar drejt sektorëve me risk më të lartë dhe ndikim më të madh në tregun e punës.



SIGURIA DHE SHËNDETI NË PUNË, NUK ËSHTË ZGJEDHJE ËSHTË LIGJ

**Mosrepektimi i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë
sjell gjëritje dhe pezullim të aktivitetit pa asnjë tolerancë.**

INSPEKTIMET SIPAS LLOJIT TË AKTIVITETIT EKONOMIK E ANALIZUAR SIPAS RAJONEVE

Në nivel kombëtar, sektori i tregtisë (H-B-R) dhe ndërtimi përbëjnë pjesën dërrmuese të inspektimeve, me përkatësisht 3,784 dhe 2,122 inspektime, duke reflektuar numrin e lartë të subjekteve, dinamikën e punëmarrjes dhe ekspozimin më të madh ndaj informalitetit dhe rrezikut profesional. Këta sektorë dominojnë veçanërisht në Rajonin Tiranë, i cili mban peshën kryesore të inspektimeve në pothuajse të gjitha kategoritë ekonomike.

Ndërmarrjet prodhuese përfaqësojnë sektorin e tretë për nga volumi i inspektimeve (1,519 raste), me përqendrim kryesisht në rajonet Tiranë, Korçë dhe Vlorë, çka tregon rëndësinë e këtij sektori në strukturën industriale të vendit. Transporti dhe telekomunikacioni si dhe financa dhe shërbimet mbeten në nivele më të kufizuara numerike, por me shpërndarje relativisht të balancuar ndërmjet rajoneve.

Sektorët miniera/kariera dhe bujqësi, pyje dhe peshkim paraqiten të përqendruar kryesisht në rajonet përkatëse me aktivitet tradicional në këto fusha, si Dibra dhe Korça, duke reflektuar një qasje të diferencuar rajonale të planifikimit inspektues, të lidhur ngushtë me profilin ekonomik të territorit.

Në tërësi, të dhënat dëshmojnë një orientim të qartë të inspektimeve drejt sektorëve prioritarë dhe rajoneve me peshë më të lartë ekonomike, duke reflektuar zbatim të parimeve të inspektimit me bazë rrisht dhe përdorim më efikas të burimeve inspektuese.

Drejtoritë Rajonale	Lloji i Aktivitetit (ILO)									
	Bujqësi, Pyje Peshkim	Miniera kariera	Ndërmarrje Prodhuese	Elektricitet, Gaz, Ujë	Tregti (H-B-R)	Ndërtim	Transport Telekomunikacion	Financë, Shërbime	Të tjera	TOTAL
	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	
Rajoni Tiranë	5	10	665	17	1966	1407	163	20	1016	5269
Rajoni Vlorë	5	7	228	13	355	234	28	7	77	954
Rajoni Dibër	1	102	20	37	130	77	5	3	32	407
Rajoni Korçë	19	12	359	31	571	157	34	7	172	1362
Rajoni Shkodër	4	9	142	6	347	93	26	27	66	720
Rajoni Gjirokastrë	0	10	87	2	409	152	15	3	32	710
Drejtoria Qëndrore	0	0	18	0	6	2	1	0	83	110
TOTAL	34	150	1519	106	3784	2122	272	67	1478	9532

Tabela: Numri i Inspektimeve sipas Llojit të Aktivitetit (ILO), në sipas rajoneve

TREGUESIT E INSPEKTIMEVE QË JANË KRYER MBI BAZË “ANKESE”

Gjatë vitit 2025, më çështje inspektimi me arsye “Denoncim” nga të tretët ose “Ankesë”, rezultojnë gjithsej 963 inspektime. Krahasimisht me një vit më parë kemi 40 % më shumë çështje inspektimi. Ky është tregues i rritjes së kulturës së ndërgjegjësimit, për të drejtat dhe detyrimet ligjore nga punëmarrësit dhe punëdhënësit, si dhe rritje të besimit ndaj institucionit. Kjo rritje reflektohet dhe në ndërmarrjet shtetërore të cilat zënë 10 % e ankesave totale të realizuara gjatë vitit 2025 duke pësuar një rritje nga viti 2024 në 77 %.

Numrin më i lartë subjekteve, që janë inspektuar në kuadër të ankesave të ardhura i takojnë Rajonit Tiranë me 76% të totalit. Ky rajon rezulton në këtë tregues me rritje me 209 inspektime më shumë se në vitin 2024, tregues që lidhet me faktin e përqendrimit të lartë të bizneseve që zhvillojnë aktivitetin ekonomik në këtë rajon dhe për një ndërgjegjësim më të lartë të punonjësve për të adresuar shqetësimet e tyre për zgjidhje. Gjithashtu tregues më i lartë krahasimisht me një vit më parë është dhe numri i inspektimeve të kryera nga inspektorë të Drejtorisë Qendrore, i cili tregon vëmëndjen e madhe që i është kushtuar trajtimit të ankesave për raste apo situata komplekse.

Drejtoritë Rajonale	Inspektime ankesë sipas Llojit të Aktivitetit (ILO)									TOTAL
	Bujqësi, Pyje Peshkim	Miniera kariera	Ndërmarrje Prodhuese	Elektricitet, Gaz, Ujë	Tregti (H-B-R)	Ndërtim	Transport Teleko munikaion	Financë, Shërbime	Të tjera	
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	
Rajoni Tiranë	0	2	110	1	191	60	69	9	291	733
Rajoni Vlorë	1	0	27	2	33	6	3	1	32	105
Rajoni Dibër	0	6	1	1	1	0	0	1	6	16
Rajoni Korçë	0	0	13	1	5	4	2	0	15	40
Rajoni Shkodër	0	0	9	0	11	2	2	0	17	41
Rajoni Gjirokastrë	0	0	1	0	7	0	0	1	4	13
Drejtoria Qendrore	0	0	4	0	3	0	0	0	8	15
TOTAL	1	8	165	5	251	72	76	12	373	963

Tabela: Numri i inspektimeve për shkak “Ankesë”, sipas Llojit të Aktivitetit (ILO), në nivel rajoni.

Analiza e inspektimeve të kryera për shkak ankesë sipas llojit të aktivitetit ekonomik tregon se, në nivel kombëtar, sektori i tregtisë (H-B-R) përbën kategorinë kryesore të ankesave, me 251 inspektime, i ndjekur nga ndërmarrjet prodhuese (165 raste) dhe kategoria “të tjera” (373 raste). Kjo shpërndarje reflekton dinamikën e lartë të punëmarrjes, qarkullimin e shpeshtë të fuqisë punëtore dhe ekspozimin më të madh ndaj shkeljeve të marrëdhënieve të punës në këta sektorë.

Rajoni Tiranë mban peshën kryesore të inspektimeve për shkak ankesë (733 raste), me përqendrim të lartë në tregti, ndërmarrje prodhuese, transport/telekomunikacion dhe

kategorinë “të tjera”, në përputhje me volumin e aktivitetit ekonomik dhe nivelin më të lartë të raportimeve nga punëmarrësit. Rajonet Vlorë, Korçë dhe Shkodër paraqesin nivele më të moderuara, kryesisht të përqendruara në tregti dhe prodhim.

Sektorët bujqësi, miniera/kariera dhe elektricitet, gaz, ujë paraqiten me numër shumë të kufizuar ankesash, çka lidhet me strukturën e tregut të punës dhe natyrën e veprimtarisë në këto fusha. Drejtoria Qendrore ka trajtuar një numër të kufizuar ankesash, kryesisht në kategorinë “të tjera” dhe prodhim, në përputhje me rolin e saj mbikëqyrës dhe koordinues.

Në tërësi, të dhënat dëshmojnë se inspektimet për shkak ankese mbeten një instrument thelbësor reagues, të përqendruar kryesisht në sektorët me risk më të lartë për shkelje të të drejtave të punëmarrësve. Mbi bazë përqindje të llojit të aktivitetit ekonomik të subjekteve, inspektuar për shkak ankese gjatë vitit 2025, rezulton se sektorët, punëmarrësit e të cilëve adresojnë më shumë ankesa janë:

- 26% janë në Sektorin e Tregtisë (H-B-R), i cili vijon të ketë problematika për respektimin e kontratave të punës për punëmarrësit. Krahasimisht me një vit më parë në këtë sektor kemi një rritje në 60 % të ankesave kjo për shkak dhe të fushatave ndërgjegjësuese dhe informuese në rrjetet e komunikimit online të institucionit.
- 17% janë në Ndërmarrje Prodhuese ku numri më i madh i përket sektorit fason, që dhe gjatë këtij viti është shoqëruar me luhajtje të tregut dhe rrjedhimisht ka dhënë ndikim dhe në raportet e punësimit me punëmarrësit/et duke pësuar një rritje prej 6 % të ankesave nga një vit më parë.
- 7% janë në llojin e aktivitetit Ndërtim, kjo për shkak dhe të ndërgjegjësimit të vazhdueshëm që është bërë për këtë sektor me risk.
- 39% i takojnë Aktivitete “Të tjera”, ku bëjnë pjesë Ndërmarrjet Shtetërore, SHPSF (Shoqëritë e Ruajtjes së Sigurisë Fizike), Arsim, Agjencitë e punësimit etj.

ANALIZË E TË DHËNAVE MBI PUNËMARRËSIT DHE NË INSPEKTIMET MBI BAZË ANKESE, SIPAS LLOJIT TË AKTIVITETIT EKONOMIK

Gjatë vitit 2025, Inspektorati Shtetëror i Punës ka zhvilluar 963 inspektime mbi bazë ankese, të shpërndara sipas llojit të aktivitetit ekonomik të subjekteve të inspektuara. Në kuadër të këtyre ndërhyrjeve janë verifikuar gjithsej 73,338 punëmarrës, nga të cilët 41,230 ishin gra. Analiza sipas aktivitetit ekonomik tregon se kategoria “Të tjera” përbën sektorin me numrin më të lartë të inspektimeve, me 373 raste, ku janë verifikuar 30,365 punëmarrës. Kjo kategori përfshin aktivitete të ndryshme dhe heterogjene, çka shpjegon edhe intensitetin më të lartë të ndërhyrjeve inspektuese. Ndërmarrjet prodhuese përfaqësojnë një tjetër sektor me peshë të konsiderueshme, me 19,712 punëmarrës të verifikuar, ku 69.9% e tyre janë gra, duke e bërë këtë sektor veçanërisht të rëndësishëm për monitorimin e kushteve të punës dhe respektimin e të drejtave të punëmarrësve. Në sektorin Transport dhe Telekomunikacion janë realizuar 76 inspektime, ku janë verifikuar 12,987 punëmarrës, nga të cilët 7,361 gra, tregues që dëshmon përfshirjen e lartë të grave edhe në sektorë me dinamika specifike pune.

Në drejtim të formalizimit të marrëdhënieve të punës, gjatë procesit inspektues janë evidentuar 336 punëmarrës pa kontrata individuale pune. Sektori Tregti (H-B-R) paraqet numrin më të lartë të rasteve (171 punëmarrës), duke konfirmuar nevojën për monitorim të vazhdueshëm dhe ndërhyrje të targetuara në këtë fushë. Problemika të ngjashme

janë evidentuar edhe në ndërmarrjet prodhuese dhe në sektorin e ndërtimit, me përkatësisht 45 dhe 27 raste, duke reflektuar vështirësi të vazhdueshme në respektimin e detyrimeve ligjore për formalizimin e punësimit.



Sa i përket punësimit informal, gjatë vitit 2025 janë konstatuar 269 punëmarrës informale dhe 224 punëmarrës në forma të tjera jo të rregullta të punësimit. Për rreth 83% të rasteve është arritur formalizimi i marrëdhënies së punës gjatë procesit inspektues, duke treguar efektivitetin e ndërhyrjeve korrigjuese të Inspektoratit. Rastet e mbetura janë referuar për ndjekje pranë organeve tatimore kompetente, kryesisht për shkak se ankesat janë paraqitur pas përfundimit të marrëdhënies së punës, duke kufizuar mundësinë e ndërhyrjes së drejtpërdrejtë inspektuese. Sektori i tregtisë dhe ndërmarrjet prodhuese përbëjnë pjesën më të madhe

të këtyre rasteve, çka nënvizon nevojën për vijimësi të kontrolleve në këta sektorë.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i analizës lidhet me sigurimin me pagë minimale, ku janë evidentuar 1,204 punëmarrës të siguruar në këtë nivel. Fenomeni shfaqet kryesisht në ndërmarrjet prodhuese (506 raste), tregti (H-B-R) (154 raste) dhe në kategorinë “Të tjera” (412 raste), duke treguar nevojën për monitorim të posaçëm të respektimit të pagës minimale ligjore, veçanërisht në sektorët me incidencë të lartë të punës pa kontrata ose të informalitetit.

Në përfundim, analiza vjetore sipas llojit të aktivitetit ekonomik tregon se sektorët e tregtisë (H-B-R) dhe ndërmarrjeve prodhuese mbeten prioritarë për ndërhyrje inspektuese, si në drejtim të formalizimit të marrëdhënieve të punës, ashtu edhe në respektimin e pagës minimale dhe detyrimeve të sigurimeve shoqërore. Përqindja e lartë e punëmarrësve femra në disa sektorë kërkon vëmendje të shtuar ndaj garantimit të kushteve të përshtatshme të punës dhe zbatimit të parimit të barazisë gjinore. Kjo analizë përbën një bazë të rëndësishme për orientimin e veprimtarisë inspektuese në vitin pasardhës dhe për forcimin e zbatimit të legjislacionit në fushën e marrëdhënieve të punës dhe sigurisë sociale.

Lloji i Aktivitetit	Nr. Inspektime për ankese	Punëmarrës					
		Gjithsej	Femra	Pa kontrata	Informal	Formalizuar	Siguruar me pagë minimale
1. Bujqësi, Pyje, Peshkim	1	2	0	1	1	1	2
2. Miniera kariera	8	350	286	0	-	-	2
3. Ndërmarrje prodhuese	165	19,712	13,775	45	72	63	506
4. Elektricitet, Gaz, Ujë	5	1,219	52	0	-	-	-
5. Tregti (H-B-R)	251	7,093	3,714	171	123	114	154
6. Ndërtim	72	1,190	310	27	28	9	32
7. Transport, Telekomunikacion	76	12,987	7,361	11	3	3	86
8. Financë, Shërbime	12	420	257	2	-	-	10
9. Të tjera	373	30,365	15,475	79	42	34	412
TOTAL	963	73,338	41,230	336	269	224	1,204

Tabela: Tregues të informalitetit në inspektimet për shkak "Ankese", sipas Llojit të Aktivitetit (ILO)

Në vijim të analizës së inspektimeve të kryera për shkak ankese, konstatimet lidhur me informalitetin e zi dhe gri në marrëdhëniet e punës evidentojnë problematika të rëndësishme, por njëkohësisht tregojnë edhe efektivitetin e ndërhyrjes inspektuese në drejtim të formalizimit të punësimit.

Në drejtim të formalizimit kontraktual, janë evidentuar 363 punëmarrës pa kontratë pune të rregullt, duke shënuar një ulje prej rreth 15% krahasuar me një vit më parë. Ky trend pozitiv lidhet kryesisht me rritjen e ndërgjegjësimit të punëdhënësve dhe punëmarrësve mbi rëndësinë juridike të kontratës individuale të punës, si rezultat i veprimtarisë së vazhdueshme inspektuese dhe këshilluese të institucionit.

Një tjetër element domethënës i analizës lidhet me sigurimin me pagë minimale, ku rezultojnë se 1,204 punëmarrës, ose rreth 1.6% e totalit të punëmarrësve të përfshirë në inspektimet për shkak ankese, ishin të siguruar me pagë minimale. Ky tregues sinjalizon praktika të deklarimit minimal të pagës, të cilat, edhe pse formalisht brenda kuadrit ligjor, kërkojnë monitorim të shtuar për të garantuar respektimin real të të drejtave ekonomike të punëmarrësve dhe për të adresuar format e informalitetit gri në tregun e punës.

Në tërësi, këto të dhëna konfirmojnë se inspektimet për shkak ankese përbëjnë një mekanizëm thelbësor për identifikimin e informalitetit, ndërhyrjen korrigjuese dhe formalizimin e marrëdhënieve të punës, duke kontribuar drejtpërdrejt në forcimin e përputhshmërisë ligjore dhe në rritjen e sigurisë sociale të punëmarrësve.

MASAT ADMINISTRATIVE NË INSPEKTIMET PËR SHKAK ANKESE

Në vijim të analizës së konstatimeve mbi informalitetin e zi dhe gri, masat administrative të aplikuara gjatë inspektimeve për shkak ankese përbëjnë një tregues të drejtpërdrejtë të intensitetit të ndërhyrjes institucionale dhe të qasjes së ndjekur nga Inspektorati Shtetëror i Punës në adresimin e shkeljeve të konstatuara.

Gjatë vitit 2025 evidentohet një rritje prej rreth 86% e masave administrative, çka reflekton një intensifikim të punës së inspektorëve dhe një reagim më të fortë institucional ndaj shkeljeve të evidentuara përmes mekanizmit të ankesave. Kjo rritje lidhet si me rritjen e volumit të inspektimeve për shkak ankese, ashtu edhe me përmirësimin e cilësisë së hetimit administrativ dhe dokumentimit të shkeljeve.

Gjatë vitit 2025 janë kryer 963 inspektime mbi bazë ankese, ku 82% e subjekteve të inspektuara janë shoqëruar me masa administrative. Masat e aplikuara përfshijnë masën urgjente “Pezullim”, si dhe dënimet kryesore “Paralajmërim” dhe “Gjobë”, duke reflektuar një qasje të diferencuar dhe proporcionale, në varësi të natyrës, përsëritjes dhe rrezikshmërisë së shkeljeve të konstatuara. Struktura e masave administrative tregon se paralajmërimet dominojnë me 61% të totalit të masave, çka dëshmon se Inspektorati ka orientuar ndërhyrjen kryesisht drejt korigjimit të shkeljeve dhe rritjes së përputhshmërisë ligjore, përpara penalizimit financiar. Gjobat, të aplikuara në 9% të inspektimeve për shkak ankese, janë përdorur kryesisht në rastet e shkeljeve më të rënda ose të përsëritura, ndërsa pezullimet, që përbëjnë rreth 12%, janë aplikuar në sektorë me risk të lartë me qëllim mbrojtjen e menjëhershme të punëmarrësve.

ANALIZA E MASAVE ADMINISTRATIVE SIPAS LLOJIT TË AKTIVITETIT EKONOMIK

Ndërmarrjet prodhuese dhe sektori i tregtisë (H-B-R) përfaqësojnë sektorët me numrin më të lartë të masave administrative, si në paralajmërimet ashtu edhe në gjoba. Këto rezultate pasqyrojnë nivel më të lartë të shkeljeve dhe informalitetit, por edhe peshën e madhe që këta sektorë zënë në tregun e punës dhe në volumin e ankesave të depozituara. Sektori i ndërtimit dhe ai i transportit/telekomunikacionit shfaqin gjithashtu një numër të konsiderueshëm masash administrative, veçanërisht pezullime dhe gjoba, duke reflektuar risk të shtuar për sigurinë në punë dhe nevojën për ndërhyrje më të fortë parandaluese dhe ndëshkuese. Në total, vlera e gjobave të vendosura për inspektimet mbi bazë ankese arrin në 16,800 mijë lekë, me pjesën më të madhe të saj të përqendruar në sektorët prodhues dhe tregti.

Lloji i Aktivitetit (ILO)	Nr. Inspektime	Pezullim	Paralajmërim	Gjobë	Vlerë (.000 Lekë)
Bujqësi, Pyje, Peshkim	1	1	1	0	0
Miniera, Karriera	8	0	8	0	0
Ndërmarrje prodhuese	165	19	110	24	6,970
Elektricitet, Gaz, Ujë	5	0	3	1	80
Tregti (H-B-R)	251	56	174	18	2,250
Ndërtim	72	13	44	7	1,080
Transport, Telekomunikacion	76	4	41	6	1,760
Financë, Shërbime	12	1	7	0	0
Të tjera	373	21	200	26	4,660
TOTAL	963	115	588	82	16,800

Tabela: Masat Administrative sipas Llojit të Aktivitetit (ILO)

ANALIZA E MASAVE ADMINISTRATIVE SIPAS SHPËRNDARJES RAJONALE

Analiza rajonale e masave administrative tregon se Rajoni Tiranë kryeson si në numrin e inspektimeve për shkak ankese (733 raste), ashtu edhe në masat e aplikuara, me 89 pezullime, 426 paralajmërime dhe 49 gjoba, me një vlerë totale gjobash prej 7,640 mijë lekë. Rajonet Vlorë dhe Korçë shfaqin gjithashtu një nivel të konsiderueshëm masash administrative, veçanërisht në drejtim të gjobave, duke treguar problematika të dukshme në respektimin e legjislacionit nga subjektet ekonomike. Shkodra dhe Dibra paraqiten me një nivel më të moderuar masash, ndërsa Gjirokastra ka aktivitet më të kufizuar në këtë drejtim, në përputhje me volumin e përgjithshëm të inspektimeve dhe strukturën e tregut lokal të punës.

Në tërësi, analiza e masave administrative në inspektimet për shkak ankese tregon se Inspektorati ka ndjekur një qasje të targetuar, proporcionale dhe të balancuar, duke kombinuar masa korigjuese me ndëshkime financiare në sektorët dhe rajonet me risk më të lartë. Dominimi i paralajmërimeve dëshmon orientimin e institucionit drejt përmirësimit të përputhshmërisë ligjore dhe ndërgjegjësimit të subjekteve, ndërsa përdorimi selektiv i pezullimeve dhe gjobave siguron mbrojtje efektive të punëmarrësve dhe respektim të standardeve ligjore.

Drejtoritë Rajonale	Inspektime për shkak Ankese	Masa Administrative			
		Pezullime	Paralajmërim	Gjobë	Vlerë (000) Lekë
Rajoni I - Tiranë	733	89	426	49	7,640
Rajoni II - Vlorë	105	15	97	11	3,000
Rajoni III - Dibër	16	0	10	1	400
Rajoni IV - Korçë	40	4	32	13	3,100
Rajoni V - Shkodër	41	3	6	4	1,560
Rajoni VI - Gjirokastrë	13	1	9	0	0
Drejtoria Qëndrore	15	3	8	4	1,100
TOTAL	963	115	588	82	16,800

Tabela: Masa Administrative në inspektimet për shkak “Ankese”, mbi bazë Rajoni.

TREGUESIT E INSPEKTIMEVE QË JANË KRYER MBI BAZË “AKSIDENTI NË PUNË”

Gjatë vitit 2025, aksidentet në punë kanë mbetur një komponent me peshë të lartë cilësore në veprimtarinë e Inspektoratit, si për ndikimin e tyre të drejtpërdrejtë në jetën dhe shëndetin e punëmarrësve, ashtu edhe për nevojën që imponojnë për ndërhyrje të menjëhershme, hetim administrativ të plotë dhe masa korigjuese efektive. Treguesit e vitit 2025 dëshmojnë një situatë me intensitet të shtuar: janë evidentuar 212 punëmarrës të aksidentuar, nga të cilët 48 me pasojë humbjen e jetës, ndërkohë që janë kryer gjithsej 275 inspektime me arsye “Aksidenti në punë”.

Tabela: Numri i inspektimeve për shkak “Aksidenti në Punë” dhe Numrit i Punëmarrësve të Aksidentuar dhe me Vdekje, mbi bazë Rajoni.

Drejtoritë Rajonale	Nr. Inspektimeve për Aksident në Punë	Punëmarrës	
		Të aksidentuar gjithsej	Të aksidentuar me vdekje
Rajoni I - Tiranë	148	100	14
Rajoni II - Vlorë	31	26	5
Rajoni III - Dibër	41	35	13
Rajoni IV - Korçë	20	25	8
Rajoni V - Shkodër	22	13	6
Rajoni VI - Gjirokastrë	10	10	2
Drejtoria Qendrore	3	3	0
TOTAL	275	212	48

Lloji i Aktivitetit (ILO)	Nr. Inspektimeve për Aksident në Punë	Punëmarrës	
		Të aksidentuar	Të aksidentuar me vdekje
1. Bujqësi pyje peshkim	0	0	0
2. Miniera kariera	32	31	9
3. Ndërmarrje prodhuese	54	44	4
4. Elektricitet. Gaz.Ujë	16	8	3
5. Tregti (H-B-R)	28	21	4
6. Ndërtim	73	48	18
7.Transport, Telekomunikacion	7	5	2
8. Financë. Shërbime	0	0	0
9. Të tjera	65	55	8
TOTAL	275	212	48

Tabela: Numri i inspektimeve për shkak “Aksidenti në Punë” dhe Numrit i Punëmarrësve të Aksidentuar dhe me Vdekje, mbi “Lloji të Aktivitetit” ekonomik.

Krahasimi ndër vite tregon trend rritës si në numrin e punëmarrësve të aksidentuar ashtu edhe në numrin e subjekteve të inspektuara për këtë shkak. Kjo rritje nuk duhet interpretuar vetëm si përkeqësim i kushteve të brendshme të sigurisë në vendin e punës, por edhe si rezultat i një kombinimi faktorësh: rritja e cilësisë së hetimit administrativ, me analizë më të thelluar të fakteve dhe subjekteve të përfshira në ngjarje; rritja e nivelit të deklarimit nga subjektet; si dhe përfshirja më e lartë e aksidenteve rrugore në totalin e aksidenteve të klasifikuara “në punë” për shkak të parashikimeve ligjore.

Në këtë kuadër, aksidentet rrugore të cilat konsiderohen aksidente në punë “për shkak të ligjit”, kanë ndikuar dukshëm në strukturën e përgjithshme të aksidenteve pasi ato përbëjnë 17% të aksidenteve totale dhe 19% të rasteve fatale, në rritje krahasuar me vitin 2024 (14% dhe 9%). Ky ndryshim tregon se një pjesë e rritjes së përgjithshme lidhet me e kspozimin më të madh ndaj riskut rrugor, dhe jo vetëm me faktorët e brendshëm të sigurisë në vendin e punës. Paralelisht, pozitiv mbetet fakti se deklarimi i aksidenteve nga subjektet punëdhënëse ka shënuar rritje rreth +6%, një tregues i rëndësishëm i rritjes së transparencës dhe përgjegjshmërisë, që krijon bazë më të fortë për ndërhyrje parandaluese dhe korrigjuese.

SHPËRNDARJA TERRITORIALE DHE INTERPRETIMI I PESHËS RAJONALE

Shpërndarja sipas rajoneve tregon një përqendrim të dukshëm të inspektimeve dhe rasteve, në funksion të densitetit ekonomik, tipologjisë së aktiviteteve dhe nivelit të riskut. Rajoni Tiranë mban peshën kryesore të inspektimeve për aksident me 148 inspektime (mbi gjysmën e totalit), si dhe numrin më të lartë të punëmarrësve të aksidentuar (100) dhe rasteve me vdekje (14). Ky profil lidhet me përqendrimin e subjekteve dhe aktivitetit ekonomik në zonën Tiranë–Durrës, veçanërisht në sektorë me risk të lartë si ndërtimi dhe shërbimet ndihmëse. Një peshë të veçantë evidentohet në Rajonin Dibër, ku rezultojnë 41 inspektime, 35 punëmarrës të aksidentuar dhe 13 raste me vdekje. Kjo peshë lidhet drejtpërdrejt me praninë e aktiviteteve të minierave dhe karrierave dhe me riskun e lartë të këtij sektori. Në këtë kontekst, theksohet se për çdo rast aksidenti në sektorin minerar, **ISHPSHSH** bashkëpunon me Autoritetin Kombëtar të Sigurisë dhe Emergjencave në Miniera (AKSEM), strukturë përgjegjëse për trajtimin dhe hetimin e aksidenteve të ndodhura në galeri, duke siguruar koordinim të domosdoshëm ndër-institucional për një hetim të plotë dhe për përcaktimin e masave parandaluese. Rajoni Vlorë paraqet 31 inspektime dhe 26 punëmarrës të aksidentuar, me 5 raste me vdekje, duke përbërë një peshë të rëndësishme në strukturën kombëtare të fataliteteve. Ky rezultat lidhet me dinamikën e aktivitetit ekonomik në zonat turistike dhe urbane, si dhe me shtrirjen e veprimtarive ndërtimore dhe shërbimeve sezonale.

SHPËRNDARJA SIPAS LLOJIT TË AKTIVITETIT EKONOMIK DHE PROFILIZIMI I RISKUT

Analiza sipas llojit të aktivitetit ekonomik (ILO) tregon se aksidentet në punë janë më të përqendruara në sektorë me risk teknik të lartë dhe me intensitet të lartë pune. Sektori i ndërtimit kryeson me 73 inspektime, 48 punëmarrës të aksidentuar dhe 18 raste fatale, duke u konfirmuar si sektori me impaktin më të rëndë në jetën dhe shëndetin e punëmarrësve. Ky profil është koherent me natyrën e punës në ndërtim dhe rreziqet e ekspozimit në lartësi, mungesën ose zbatimin e pamjaftueshëm të masave mbrojtëse kolektive dhe individuale, si dhe me nevojën për kontroll të shtuar në kantier. Kategoria “Të tjera” shfaq gjithashtu volum të lartë me 65 inspektime, 55 punëmarrës të aksidentuar dhe 8 raste fatale, ndërkohë që ndërmarrjet prodhuese paraqiten me 54 inspektime, 44 të aksidentuar dhe 4 fatalitete). Në sektorin miniera/karriera rezultojnë 32 inspektime, 31 të aksidentuar dhe 9 raste me vdekje, duke reflektuar risk të lartë dhe rëndësi të veçantë për hetim të thelluar dhe masa teknike parandaluese. Në këtë strukturë, aksidentet rrugore shfaqen si komponent i rëndësishëm në sektorë si tregtia (H-B-R) dhe kategoria “Të tjera”, duke reflektuar tipologjinë e punës dhe lëvizshmërinë e punëmarrësve.

SHKAQET KRYESORE DHE QASJA INSTITUCIONALE E NDËRHJRJES

Të dhënat e hetimit inspektues për aksidentet e vitit 2025 tregojnë se, në pjesën më të madhe të rasteve, shkaqet lidhen me moszbatim të rregullave të sigurisë dhe shëndetit në punë, në forma të ndryshme sipas sektorëve. Në ndërtim, shkaku dominues lidhet me rëniet nga lartësia. Në ndërmarrjet prodhuese, problematikat lidhen kryesisht me përdorimin e makinerive dhe pajisjeve të punës, ndërsa në tregti dhe në “Të tjera” konstatohet ndikimi i aksidenteve rrugore. Në këtë kuadër, vendimmarrja e inspektorëve është orientuar drejt ndërhyrjes së menjëhershme dhe përmirësimit të situatës, përmes detyrave të lëna dhe masave administrative, në përputhje me parashikimet ligjore.

MASAT ADMINISTRATIVE NË INSPEKTIMET PËR SHKAK “AKSIDENT NË PUNË”

Një element që dëshmon rritjen e rigorozitetit institucional është fakti se në 100% të subjekteve të inspektuara për shkak aksidenti janë marrë masa administrative. Në disa raste, ndaj të njëjtit subjekt janë aplikuar më shumë se një masë, në varësi të shkeljeve të konstatuara. Referuar tabelës për masat administrative në inspektimet për aksident (sipas rajonit), masat e aplikuara përfshijnë masën urgjente “Pezullim”, dënimin kryesor “Paralajmërim” dhe dënimin kryesor “Gjobë”, duke reflektuar një qasje të kombinuar midis ndërhyrjes së menjëhershme për eliminimin e riskut dhe ndëshkimit proporcional për shkeljet e rënda.

Drejtoria Rajonale/ Sektori i Inspektimit	Nr. Inspektime për Aksident në Punë	Masa Administrative			
		Pezullim	Paralajmërim	Gjobë	Vlerë (000)
Rajoni I - Tiranë	148	23	104	45	9,910
Sek.Insp Tiranë	100	21	66	36	8,890
Sek.Insp Durrës	48	2	38	9	1,020
Rajoni II - Vlorë	31	3	29	13	4,600
Sek.Insp Berat	11	1	10	6	2,600
Sek.Insp Fier	8	0	7	2	900
Sek.Insp Vlorë	12	2	12	5	1,100
Rajoni III - Dibër	41	4	33	10	3,800
Sek.Insp Dibër	37	2	30	9	2,900
Sek.Insp Kukës	4	2	3	1	900
Rajoni IV - Korçë	20	5	12	9	3,000
Sek.Insp Korçë	10	3	7	5	1,080
Sek.Insp Elbasan	10	2	5	4	1,920
Rajoni V - Shkodër	22	2	5	12	9,760
Sek.Insp Shkodër	12	1	1	7	4,220
Sek.Insp Lezhë	10	1	4	5	5,540
Rajoni VI - Gjirokastrë	10	0	10	1	200
Sek.Insp Gjirokastrë	9	0	9	1	200
Sek.Insp Sarandë	1	0	1	0	0
Drejtoria Qëndrore	3	0	2	1	100
TOTALI	275	37	195	91	31,370

Tabela: Masat administrative për "Aksident në punë", mbi bazë Rajoni.

Në tërësi, kjo strukturë tregon se inspektimet për aksident në punë përbëjnë një mekanizëm të rëndësishëm reagimi dhe parandalimi: ato synojnë jo vetëm evidentimin e shkeljeve dhe përcaktimin e përgjegjësive administrative, por mbi të gjitha vendosjen e masave konkrete që reduktojnë riskun e përsëritjes, fuqizojnë kulturën e sigurisë dhe rrisin përputhshmërinë e subjekteve me standardet e sigurisë dhe shëndetit në punë.

PUNËSIMI INFORMAL

Në zbatim të ligjit nr. 9634/2006 “Për inspektimin e punës” (i ndryshuar), “punësimi informal” përkufizon një marrëdhënie punësimi që nuk i nënshtrohet, në aspektin ligjor dhe në praktikë, kërkesave të legjislacionit të punës. **ISHPSHSH** e trajton informalitetin si fenomen në disa forma, duke përfshirë edhe informalitetin “gri”, i cili shfaqet jo vetëm në mungesë të deklarimit, por edhe në deformime të elementëve të marrëdhënies së punës (p.sh. kontrata jo të rregullta, sigurim mbi pagë minimale, etj.). Fokusi institucional ka qenë dhe mbetet minimizimi i informalitetit, në çdo formë të shfaqjes së tij, përmes një kombinimi të ndërhyrjeve inspektuese, masave administrative dhe komponentit këshillues/informues.

TRENDI I ZBULUESHMËRISË DHE PËRMIRËSIMI I TARGETIMIT TË INSPEKTIMEVE

Një tregues që vlerëson drejtpërdrejt efektivitetin e inspektimeve në luftën ndaj punës së padeklaruar është norma e zbulueshmërisë, e llogaritur si raporti i numrit të punëmarrësve informal të identifikuar ndaj numrit të inspektimeve. Në periudhën 2023–2025, ky tregues ka shënuar një përmirësim të qëndrueshëm: nga 20% në vitin 2023 (1965/9938), në 26% në vitin 2024 (2600/9860) dhe në 27% në vitin 2025 (2591/9532). Kjo rritje dëshmon se inspektimet janë orientuar më saktë drejt subjekteve dhe sektorëve me risk të lartë, duke reflektuar një programim më të fokusuar mbi bazë risku, edhe në kushtet e një uljeje të lehtë të numrit total të inspektimeve (rreth -3% krahasuar me vitin 2024). Pra, ruajtja e një niveli të ngjashëm të informalitetit të evidentuar me më pak inspektime tregon rritje të eficiencës, jo ulje të intensitetit të kontrollit. Ky rezultat lidhet edhe me përmirësimin e koordinimit me institucione dhe partnerë si DPT dhe QKB, ku shkëmbimi i të dhënave dhe informimi i subjekteve (sidomos atyre të reja) mbi detyrimet ligjore ka ndihmuar në kombinimin e masave ndëshkuese me qasje këshilluese, duke e bërë ndërhyrjen institucionale më të balancuar dhe më efektive.

STRUKTURA E INFORMALITETIT SIPAS LLOJIT TË INSPEKTIMIT

Analiza e shpërndarjes së punëmarrësve informal të evidentuar sipas tipologjisë së inspektimit (siç paraqitet në grafikun “Punëmarrës informal 2022–2025 sipas llojit të inspektimit”) tregon se informaliteti nuk është fenomen i izoluar në një formë të vetme kontrolli, por shfaqet si në inspektimet e programuara ashtu edhe në inspektimet jashtë programit. Për vitin 2025 rezultojnë se:

- 1,132 punëmarrës, ose 44% e punëmarrësve informal të konstatuar, i përkasin subjekteve të inspektuara në kuadër të programimit (me ulje 16% në informalitetin e evidentuar në inspektimet e programuara);

- 749 punëmarrës, ose 29%, janë evidentuar në inspektime tematike;
- 710 punëmarrës, ose 27%, janë evidentuar në inspektime jashtë programimi (ankesë, aksident, rastësor).

Kjo strukturë konfirmon se programimi mbetet instrumenti kryesor i kontrollit sistematik, ndërsa inspektimet tematike dhe ato jashtë programit luajnë rol korrigjues dhe reagues, duke nxjerrë në pah informalitetin që lidhet me sinjale konkrete apo ngjarje të caktuara.

REZULTATI I FORMALIZIMIT GJATË PROCESIT INSPEKTUES

Gjatë vitit 2025 janë evidentuar gjithsej 2,591 punëmarrës informal. Një tregues me rëndësi të veçantë për efektivitetin real të ndërhyrjes është fakti se gjatë procesit inspektues janë formalizuar 2,538 punëmarrës, ose 98% e totalit të evidentuar. Rastet kur formalizimi nuk ka qenë i mundur brenda procesit inspektues janë deleguar pranë Organeve të Tatim-Taksave, rast pas rasti, për trajtim sipas kompetencës. Ky rezultat dëshmon një ndërhyrje funksionale të Inspektoratit, e cila nuk kufizohet vetëm në evidentimin e shkeljes, por synon korrigjimin e menjëhershëm të situatës së punësimit, duke rritur mbrojtjen sociale të punëmarrësit dhe formalitetin e marrëdhënies së punës.

SHPËRNDARJA TERRITORIALE E INFORMALITETIT DHE INTERPRETIMI INSTITUCIONAL

Të dhënat evidentojnë se informaliteti është i shpërndarë në të gjitha rajonet, me diferenca që lidhen me madhësinë e tregut, numrin e subjekteve dhe strukturën e aktiviteteve ekonomike. Rajoni Tiranë, për shkak të volumit më të lartë të inspektimeve dhe punëmarrësve të kontrolluar, paraqet edhe numrin më të lartë absolut të informalëve të evidentuar, ndërkohë që rajone si Korçë, Vlorë, Shkodër dhe Dibër shfaqin nivele të konsiderueshme të informalitetit të identifikuar, të shoqëruara në pjesën dërrmuese me formalizim brenda procesit. Prania e formalizimit në shkallë shumë të lartë në të gjitha rajonet konfirmon zbatimin e një praktike të standardizuar dhe të qëndrueshme në terren.

Drejtoria Rajonale/ Sektori i Inspektimit	Nr. Inspektimeve gjithsej	Punëmarrës		
		Gjithsej Punëmarrës	Informal	Formalizuar
Rajoni I - Tiranë	5,269	138,782	848	808
Sek.Insp Tiranë	4,359	115,578	667	631
Sek.Insp Durrës	910	23,204	181	177
Rajoni II - Vlorë	954	26,504	374	370
Sek.Insp Berat	200	5,692	54	51
Sek.Insp Fier	318	11,680	58	57
Sek.Insp Vlorë	436	9,132	262	262
Rajoni III - Dibër	407	9,450	288	287
Sek.Insp Dibër	265	7,367	226	226
Sek.Insp Kukës	142	2,083	62	61
Rajoni IV - Korçë	1,362	14,340	453	452
Sek.Insp Korçë	705	7,521	287	286
Sek.Insp Elbasan	657	6,819	166	166
Rajoni V - Shkodër	720	7,959	359	352
Sek.Insp Shkodër	405	5,184	144	144
Sek.Insp Lezhë	315	2,775	215	208
Rajoni VI Gjirokastrë	710	6,389	260	260
Sek.Insp Gjirokastrë	523	4,710	172	172
Sek.Insp Sarandë	187	1,679	88	88
Drejtoria Qëndrore	110	1,772	9	9
TOTALI	9,532	205,196	2,591	2,538

Tabela: Informaliteti mbi bazë Rajoni/Sektor Inspektimi

SHPËRNDARJA SEKTORIALE DHE SEKTORËT ME RISK MË TË LARTË

Informaliteti në vitin 2025 është i përqendruar kryesisht në sektorë me numër të lartë subjektësh dhe me çarkullim të shpeshtë të punëtorëve. Tregtia (H-B-R) paraqet nivelin më të lartë të punëmarrësve informal të evidentuar dhe peshën më të lartë në përqindje, ndërsa Ndërtimi vijon të mbetet sektor me incidencë të lartë, në përputhje me dinamikën e aktivitetit, punësimin sezonal dhe riskun e shtuar të marrëdhënieve të parregullta të punës. Sektorët prodhues dhe kategoria “Të tjera” shfaqin volum të rëndësishëm në numra absolutë, çka lidhet me madhësinë e bazës së punësimit që inspektohet në këto aktivitete.

Lloji i aktivitetit	Nr. Inspektive Subjekte Private	Punëmarrës		
		Total Punëmarrës	Informal	Në %
1. Bujqësi pyje peshkim	34	251	4	1.6%
2. Miniera kariera	150	6,277	17	0.3%
3. Ndërmarrje prodhuese	1,515	58,406	296	0.5%
4. Elektricitet. Gaz.Ujë	90	721	2	0.3%
5. Tregti (H-B-R)	3,784	42,162	1,567	3.7%
6. Ndërtim	2,121	19,322	488	2.5%
7. Transport, Telekomunikacion	270	17,221	7	0.04%
8. Financë. Shërbime	67	733	2	0.3%
9. Të tjera	1,343	39,877	208	0.5%

Tabela: Informaliteti në subjektet private, mbi bazë Lloji Aktiviteti.

INDIKATORËT E EFICIENCËS SË TRUPËS INSPEKTUESE

Një indikator i drejtpërdrejtë i eficiencës është mesatarja e informalëve të konstatuar për inspektor. Për vitin 2025, ky tregues rezulton 31 informalë/inspektor, në të njëjtin nivel me vitin 2024, duke dëshmuar konsolidim të kapaciteteve dhe eficiencës së identifikimit. Rritja e shpejtë nga 25 informalë/inspektor në 2023 në 31 informalë/inspektor në 2024, dhe ruajtja në 2025, tregon se sistemi i programimit dhe identifikimit të riskut ka arritur një nivel stabil efektiviteti.

Drejtoria Rajonale / Sektori i Inspektimit	Nr. Inspektiveve gjithsej	Punëmarrës		
		Gjithsej Punëmarrës	Informal	Formalizuar
Rajoni I - Tiranë	5,269	138,782	848	808
Sek.Insp Tiranë	4,359	115,578	667	631
Sek.Insp Durrës	910	23,204	181	177
Rajoni II - Vlorë	954	26,504	374	370
Sek.Insp Berat	200	5,692	54	51
Sek.Insp Fier	318	11,680	58	57
Sek.Insp Vlorë	436	9,132	262	262
Rajoni III - Dibër	407	9,450	288	287
Sek.Insp Dibër	265	7,367	226	226
Sek.Insp Kukës	142	2,083	62	61
Rajoni IV - Korçë	1,362	14,340	453	452
Sek.Insp Korçë	705	7,521	287	286
Sek.Insp Elbasan	657	6,819	166	166
Rajoni V - Shkodër	720	7,959	359	352
Sek.Insp Shkodër	405	5,184	144	144
Sek.Insp Lezhë	315	2,775	215	208
Rajoni VI Gjirokastrë	710	6,389	260	260
Sek.Insp Gjirokastrë	523	4,710	172	172
Sek.Insp Sarandë	187	1,679	88	88
Drejtoria Qëndrore	110	1,772	9	9
TOTALI	9,532	205,196	2,591	2,538

Tabela: Informaliteti mbi bazë Rajoni/Sektor Inspektimi

Treguesi i numrit mesatar të punëmarrësve informal për subjekt të inspektuar konfirmon se inspektimet vazhdojnë të orientohen drejt subjekteve ku informaliteti shfaqet më i prekshëm dhe me ndikim më të madh në të drejtat e punëmarrësve.

Përveç punësimit informal “të zi”, të dhënat dëshmojnë edhe praninë e formave të informalitetit “gri”, të lidhura me elementët e kontratës së punës dhe deklarimit të pagës. Sipas Tabelës: Kategoritë e punëmarrësve me shpërndarje mbi bazë rajoni, vërehet se:

- punëmarrësit nën 18 vjeç përbëjnë një përqindje shumë të ulët në total, por kërkojnë vëmendje të veçantë për shkak të natyrës mbrojtëse të legjislacionit;
- punëmarrësit me aftësi të kufizuar (PAK) paraqiten në nivel minimal, por mbeten indikator i rëndësishëm për monitorimin e standardeve të barazisë dhe përfshirjes;
- ndërkohë, elementët e informalitetit “gri” shfaqen më qartë në treguesit “pa kontratë” dhe “pagë minimale”.

Rajoni /Sektori i Inspektimit	Punëmarrës						
	Gjithsej	Femra	Pa kontrata individuale	Siguruar me pagë minimale	PAK	Nën 18 Vjeç	Të huaj
Rajoni I - Tiranë	138,782	69,005	876	3,469	8	110	1,528
Sek.Insp Tiranë	115,578	57,573	640	2,378	8	48	950
Sek.Insp Durrës	23,204	11,432	236	1,091	0	62	578
Rajoni II - Vlorë	26,504	12,130	472	1,156	0	23	483
Sek.Insp Berat	5,692	2,749	85	135	0	0	52
Sek.Insp Fier	11,680	5,420	63	652	0	5	168
Sek.Insp Vlorë	9,132	3,961	324	369	0	18	263
Rajoni III - Dibër	9,450	2,596	260	258	11	0	18
Sek.Insp Dibër	7,367	1,796	196	65	11	0	18
Sek.Insp Kukës	2,083	800	64	193	0	0	0
Rajoni IV - Korçë	14,340	6,111	509	2,780	4	12	122
Sek.Insp Korçë	7,521	3,475	336	2,036	3	12	24
Sek.Insp Elbasan	6,819	2,636	173	744	1	0	98
Rajoni V- Shkodër	7,959	2,983	361	132	0	1	69
Sek.Insp Shkodër	5,184	1,809	138	105	0	0	32
Sek.Insp Lezhë	2,775	1,174	223	27	0	1	37
Rajoni VI- Gjirokastrë	6,389	2,447	512	666	1	19	182
Sek.Insp Gjirokastrë	4,710	1,901	311	433	1	18	158
Sek.Insp Sarandë	1,679	546	201	233	0	1	24
Drejtoria Qëndrore	1,772	701	9	176	0	-	82
Totali	205,196	95,973	2,999	8,637	24	165	2,484

Tabela: Kategoritë e Punëmarrësve me shpërndarje mbi bazë Rajoni.

PUNËMARRËS PA KONTRATA INDIVIDUALE PUNE

Punësimi pa kontratë individuale është një nga format tipike të informalitetit “gri”, pasi cenon sigurinë juridike të marrëdhënies së punës dhe dobëson mekanizmat e mbrojtjes sociale. Gjatë vitit 2025 janë evidentuar 2,999 punëmarrës pa kontratë individuale pune, rreth 1.5% e totalit të punëmarrësve të kontrolluar, me një rënie të dukshme krahasuar me vitin 2024 (-953 punëmarrës, ose -24%). Ky rezultat sugjeron rritje të ndërgjegjësimit të subjekteve dhe ndikim të qasjes parandaluese të inspektimeve, ku formalizimi kontraktual është trajtuar si detyrim bazik.

Punëmarrës pa kontrata individuale pune sipas llojit të aktivitetit, incidenca më e lartë evidentohet në Tregti (H-B-R) dhe Ndërtim, çka përputhet me sektorët ku ka qarkullim të shpejtë të punonjësve, punësim sezonal dhe praktikë më të lartë të marrëveshjeve joformale. Në këtë kuadër, orientimi i inspektimeve dhe ndërhyrjeve këshilluese duhet të mbetet i përqendruar në këto sektorë.

Lloji i aktivitetit	Nr. Inspektime Subjekte Private	Punëmarrës		
		Në sektorin privat	Pa Kontrata Individuale	Në %
1. Bujqësi pyje peshkim	34	251	4	1.6%
2. Miniera kariera	150	6,277	21	0.3%
3. Ndërmarrje prodhuese	1515	58,406	278	0.5%
4. Elektricitet. Gaz.Ujë	90	721	1	0.1%
5. Tregti (H-B-R)	3,784	42,162	1,921	4.6%
6. Ndërtim	2,121	19,322	439	2.3%
7. Transport, Telekomunikacion	270	17,221	14	0.1%
8. Financë, Shërbime	67	733	12	1.6%
9. Të tjera	1,343	39,877	263	0.7%
TOTALI	9,374	184,970	2,953	1.6%

Tabela: Punëmarrës pa kontrata individuale pune sipas llojit të aktivitetit.

PUNËMARRËS QË SIGUROHEN MBI PAGËN MINIMALE

Sigurimi mbi pagën minimale, ndonëse nuk është automatikisht shkelje në çdo rast, përbën indikator rrisht për deformime të deklaratimit dhe për ulje të bazës reale të kontributeve, duke prodhuar pasoja fiskale dhe sociale afatgjata për punëmarrësit. Për vitin 2025, punësimi i siguruar me pagë minimale rezultoi 4.6% e punëmarrësve të evidentuar në subjektet private, ndërkohë që krahasuar me vitin 2024 evidentohet një rënie e ndjeshme (rreth -75%). Ky rezultat sugjeron një ndikim të drejtpërdrejtë të kontrollit inspektues dhe bashkëpunimit institucional, si dhe një orientim më të mirë të subjekteve ndaj deklaratimeve më të sakta. Ky fenomen shfaqet më i përqendruar në sektorë ku pagat dhe struktura e punësimit janë tipikisht më të ndjeshme ndaj rrishtit të nën-deklaratimit (p.sh. tregtia, prodhimi dhe ndërtimi), duke e bërë të domosdoshme vazhdimësinë e monitorimit të këtij treguesi si pjesë e luftës ndaj informalitetit “gri”.

Lloji i aktivitetit	Nr. Inspektive Subjekte Private	Punëmarrës		
		Në sektorin privat	Siguruar mbi pagë minimale	Në %
1. Bujqësi pyje peshkim	34	251	50	19.9%
2. Miniera kariera	150	6,277	60	1.0%
3. Ndërmarrje prodhuese	1,515	58,406	2,755	4.7%
4. Elektricitet. Gaz.Ujë	90	721	41	5.7%
5. Tregtia (H-B-R)	3,784	42,162	3,036	7.2%
6. Ndërtim	2,121	19,322	798	4.1%
7. Transport, Telekomunikacion	270	17,221	260	1.5%
8. Financë. Shërbime	67	733	20	2.7%
9. Të tjera	1,343	39,877	1,433	3.6%
TOTALI	9,374	18,4970	8,453	4.6%

Tabela: Punëmarrës që sigurohen me Pagë Minimale sipas Llojit të Aktivitetit.

PËRFUNDIM ANALITIK DHE ORIENTIM INSTITUCIONAL

Në përmbledhje, të dhënat e vitit 2025 konfirmojnë një përmirësim të targetimit dhe një rritje të qëndrueshme të zbulueshmërisë së punës së padeklaruar, shoqëruar me një rezultat shumë të lartë të formalizimit gjatë procesit inspektues (98%). Informaliteti vazhdon të jetë më i përqendruar në sektorë me risk të lartë si Tregti (H-B-R) dhe Ndërtim, ndërsa format e informalitetit “gri” (pa kontratë, pagë minimale) mbeten indikatorë kyç për monitorim të vazhdueshëm, edhe kur shënojnë ulje krahasuese. Në këtë logjikë, prioriteti institucional për vitin pasardhës duhet të ruajë kombinimin e inspektimeve të programuara mbi bazë risku, ndërhyrjeve reaguese jashtë programit dhe rritjes së komponentit këshillues e informues, të mbështetur nga bashkëpunimi ndërinstitutional dhe përdorimi më i thelluar i të dhënave për targetim.

PUNËMARRËSIT E HUAJ

Rritja e ndjeshme e punësimit të punëmarrësve të huaj gjatë viteve të fundit ka sjellë një vëmendje të shtuar në veprimtarinë inspektuese, veçanërisht në drejtim të kontrollit të kushteve të punës, respektimit të standardeve të sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe garantimit të trajtimit të barabartë dhe pa diskriminim në marrëdhëniet e punës. Ky zhvillim lidhet drejtpërdrejt me nevojat e tregut të punës, mungesën e fuqisë punëtore në sektorë të caktuar dhe rritjen e aktiviteteve ekonomike, kryesisht në ndërtim, prodhim dhe tregti.

Gjatë vitit 2025 janë konstatuar gjithsej 2,484 punëmarrës të huaj, duke shënuar një rritje prej rreth 62% krahasuar me vitin 2024. Ky tregues dëshmon jo vetëm një prani në rritje të punëmarrësve të huaj në tregun shqiptar të punës, por edhe një intensifikim të kontrolleve inspektuese dhe përmirësim të evidentimit të tyre nga ana e **ISHPSHSH**-së. Në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë nr. 757, datë 30.09.2024, “Për procedurat e shqyrtimit, vlerësimit dhe miratimit të kërkesave për licencim të subjekteve që kryejnë veprimtari të ndërmjetësimit në tregun e punës dhe monitorimin e tyre”, gjatë vitit 2025 janë kryer inspektime të posaçme në Agjencitë Private të Punësimit, si dhe në subjekte ekonomike që rezultojnë me marrëdhënie pune me punëmarrës të huaj. Këto kontrolle kanë pasur për qëllim verifikimin e ligjshmërisë së punësimit, ekzistencës së kontratave të punës, pajisjes me leje pune dhe respektimit të kushteve të sigurisë dhe shëndetit në punë.

SHPËRNDARJA E PUNËMARRËSVE TË HUAJ SIPAS LLOJIT TË KTIVITETIT EKONOMIK

Analiza e të dhënave sipas llojit të aktivitetit ekonomik tregon se ndërmarrjet prodhuese përbëjnë sektorin me numrin më të lartë të punëmarrësve të huaj (860 raste), duke reflektuar nevojën e këtij sektori për fuqi punëtore shtesë dhe specializime të caktuara. Sektori i tregtisë (H-B-R) paraqitet gjithashtu me një numër të konsiderueshëm (668 punëmarrës të huaj), i ndjekur nga kategoria “Të tjera” (536 raste), ku përfshihen aktivitete të ndryshme shërbimi dhe veprimtari ndihmëse. Në sektorin e ndërtimit janë konstatuar 199 punëmarrës të huaj, ndërsa transporti dhe telekomunikacioni paraqiten me 154 raste, duke reflektuar rritjen e lëvizshmërisë së fuqisë punëtore dhe kërkesën për profile specifike pune. Sektorët bujqësi, pyje dhe peshkim si dhe miniera dhe karriera paraqiten me numër më të kufizuar punëmarrësish të huaj, ndërkohë që në sektorët elektricitet, gaz, ujë dhe financë e shërbime nuk janë evidentuar raste punësimi të të huajve.

PUNËMARRËSIT E HUAJ PA LEJE PUNE

Nga totali i punëmarrësve të huaj të evidentuar, 83 raste rezultojnë pa leje pune, duke përbërë një përqindje relativisht të ulët në raport me numrin total. Këto raste janë përqendruar kryesisht në sektorët tregti (H-B-R), ndërtim dhe ndërmarrje prodhuese, sektorë që karakterizohen nga dinamika e lartë e punësimit dhe fluksi i shtuar i fuqisë punëtore. Këto gjetje kanë shërbyer si bazë për marrjen e masave administrative përkatëse dhe për referimin e rasteve pranë institucioneve kompetente, sipas parashikimeve ligjore.

Lloji i aktivitetit	Nr. Inspektime Subjekte Private	Punëmarrës	
		Të Huaj	Pa Leje Pune
1. Bujqësi pyje peshkim	34	7	2
2. Miniera karriera	150	54	3
3. Ndërmarrje prodhuese	1515	860	8
4. Elektricitet. Gaz. Ujë	90	0	0
5. Tregti (H-B-R)	3784	668	26
6. Ndërtim	2121	199	23
7. Transport, Telekomunikacion	270	154	0
8. Financë. Shërbime	67	0	0
9. Të tjera	1343	536	21
TOTALI	9374	2478	83

Tabela: Punëmarrës “Të huaj”, të shpërndarë, sipas llojit të aktivitetit.

Në tërësi, analiza e punësimit të punëmarrësve të huaj gjatë vitit 2025 tregon se ky fenomen përbën një trend në rritje, i diktuar nga zhvillimet ekonomike dhe struktura e tregut të punës. Ndërhyrjet inspektuese të **ISHPSHSH**-së kanë synuar garantimin e kushteve të ligjshme të punësimit, mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve të huaj dhe parandalimin e praktikave abuzive, duke kontribuar në krijimin e një tregu pune të drejtë, të sigurt dhe të përputhshëm me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

MASAT ADMINISTRATIVE

Gjatë vitit 2025, veprimtaria inspektuese e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore është shoqëruar me 5,728 masa administrative, të aplikuara ndaj rreth 60% të subjekteve të inspektuara, si rezultat i evidentimit të shkeljeve të ndryshme të legjislacionit të punës. Krahasuar me vitin 2024, ky tregues shënon një rritje prej rreth 67%, duke reflektuar një intensifikim të ndjeshëm të ndërhyrjes institucionale dhe një forcim të mekanizmave të kontrollit dhe reagimit.

Struktura e masave administrative tregon qartë orientimin e institucionit drejt qasjes korrigjuese dhe parandaluese. Dominimi i masës “Paralajmërim”, që përbën rreth 73% të totalit, dëshmon se ndërhyrja inspektuese synon në radhë të parë korrigjimin e shkeljeve dhe rritjen e përputhshmërisë ligjore. Masat urgjente të pezullimit, që përbëjnë rreth 22%, janë aplikuar në raste të shkeljeve flagrante që lidhen me marrëdhëniet e punës dhe sigurinë dhe shëndetin në punë, ndërsa gjobat, me rreth 5%, janë përdorur në mënyrë selektive për shkelje më të rënda ose të përsëritura.

Analiza krahasuese për periudhën 2023–2025 evidenton një prirje të qëndrueshme rritëse të masave administrative, duke reflektuar forcimin progresiv të procesit inspektues dhe rritjen e efektivitetit të ndërhyrjeve. Rritja e ndjeshme e paralajmërimeve, veçanërisht gjatë vitit 2025, tregon një konsolidim të qasjes parandaluese, ndërsa rritja graduale e gjobave dhe përdorimi i masave urgjente dëshmon një balancim më të mirë ndërmjet masave korrigjuese dhe ndëshkuese.

SHPËRNDARJA RAJONALE E MASAVE ADMINISTRATIVE

Shpërndarja e masave administrative sipas rajoneve tregon diferenca të dukshme në intensitetin e ndërhyrjes, në varësi të strukturës së tregut të punës dhe volumit të aktivitetit inspektues. Drejtoria Rajonale Dibër paraqitet me një raport të masave administrative ndaj inspektimeve prej 121%, duke reflektuar raste kur ndaj të njëjtit subjekt janë aplikuar më shumë se një masë administrative, në varësi të natyrës dhe numrit të shkeljeve të konstatuara. Drejtoria Rajonale Vlorë shënon një raport prej 91%, ndërsa Drejtoria Rajonale Korçë prej 79%, tregues që dëshmojnë një qasje më intensive dhe reaguese në këto rajone.

Rajoni / Sektori i Inspektimit	Nr. Inspektive	Masa Administrative				Në % kundrejt nr/ inspekti- meve
		Pezullim	Paralajmërim	Gjobë	Totale	
Rajoni I - Tiranë	5,269	529	1945	126	2,600	49%
Sek.Insp Tiranë	4,359	445	1543	97	2,085	48%
Sek.Insp Durrës	910	84	402	29	515	57%
Rajoni II - Vlorë	954	156	677	34	867	91%
Sek.Insp Berat	200	37	178	9	224	112%
Sek.Insp Fier	318	22	176	7	205	64%
Sek.Insp Vlorë	436	97	323	18	438	100%
Rajoni III - Dibër	407	160	318	16	494	121%
Sek.Insp Dibër	265	106	210	12	328	124%
Sek.Insp Kukës	142	54	108	4	166	117%
Rajoni IV - Korçë	1,362	250	776	56	1,082	79%
Sek.Insp Korçë	705	136	421	26	583	83%
Sek.Insp Elbasan	657	114	355	30	499	76%
Rajoni V - Shkodër	720	65	48	23	136	19%
Sek.Insp Shkodër	405	27	13	13	53	13%
Sek.Insp Lezhë	315	38	35	10	83	26%
Rajoni VI- Gjirokastër	710	94	411	7	512	72%
Sek.Insp Gjirokastër	523	58	331	7	396	76%
Sek.Insp Sarandë	187	36	80	0	116	62%
Drejtoria Qëndrore	110	15	16	6	37	34%
TOTALI	9,532	1,269	4,191	268	5,728	60%

Tabela: Masa Administrative, në shpërndarje, sipas Rajoneve.

Rajoni Tiranë, ndonëse përqendron numrin më të madh absolut të inspektimeve dhe masave administrative, paraqet një raport më të balancuar ndaj totalit të inspektimeve, çka lidhet me volumin e lartë të subjekteve dhe diversitetin e problematikave të trajtuara. Rajonet Shkodër dhe Gjirokastër shfaqin nivele më të moderuara të masave administrative, në përputhje me strukturën dhe shkallën e aktivitetit ekonomik lokal.

SHPËRNDARJA SIPAS LLOJIT TË AKTIVITETIT EKONOMIK

Analiza sipas llojit të aktivitetit ekonomik tregon se sektori i tregtisë (H-B-R) dhe sektori i ndërtimit përbëjnë fushat me peshën më të madhe të masave administrative, duke reflektuar nivel më të lartë të shkeljeve, por edhe rëndësinë e këtyre sektorëve në tregun e punës. Ndërmarrjet prodhuese dhe minierat/karrierat paraqesin gjithashtu përqindje të larta të masave administrative në raport me inspektimet, duke dëshmuar risk të shtuar për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe nevojë për ndërhyrje të vazhdueshme inspektuese. Sektorët financë dhe shërbime, si dhe kategoria “Të tjera”, shfaqin përqindje më të ulëta të masave administrative, çka lidhet me natyrën e aktivitetit dhe nivelin relativisht më të ulët të riskut të identifikuar.

Lloji i Aktivitetit	Masa Administrative	Në %
1. Bujqësi, Pyje, Peshkim	21	62%
2. Miniera kariera	139	93%
3. Ndërmarrje prodhuese	812	53%
4. Elektricitet, Gaz, Ujë	64	60%
5. Tregti (H-B-R)	2,413	64%
6. Ndërtim	1,509	71%
7. Transport	132	49%
8. Financë. Shërbime	20	30%
9. Të tjera	618	42%
TOTALI	5,728	60%

Tabela: Masa Administrative, në shpërndarje, sipas Llojit të Aktivitetit (ILO)

Rritja e masave administrative në sektorët me risk të lartë nuk pasqyron vetëm nivelin e shkeljeve të konstatuara, por edhe politikën institucionale të mos-tolerimit ndaj kushteve të papërshtatshme të punës, me synim parandalimin e aksidenteve dhe promovimin e një kulture sigurie në vendin e punës.

MASAT ADMINISTRATIVE SIPAS LLOJIT TË INSPEKTIMIT

Analiza sipas llojit të inspektimit tregon se inspektimet rastësore, inspektimet për shkak aksidenti në punë dhe inspektimet për shkak ankese shfaqin një raport të lartë të masave administrative ndaj numrit të inspektimeve, duke reflektuar natyrën e tyre reaguese dhe fokusin në situata me risk të lartë. Në veçanti, raportet mbi 100% në këto kategori tregojnë aplikimin e më shumë se një mase administrative ndaj të njëjtit subjekt, në varësi të shkeljeve të evidentuara.

Lloji i Inspektimit	Nr.Inspektimeve	Totali i masave administrative	Në % kundrejt Inspektimeve
Inspektime të Programuara	6,434	3,275	51%
Inspektime Tematike	1,652	1,001	61%
Inspektime për Aksident në Punë	275	323	117%
Inspektime për shkak Ankese	963	785	82%
Inspektime Rastësore	208	344	165%

Tabela: Masa Administrative (Pezullim, Paralajmërim, Gjobë), në shpërndarje, sipas Llojit të inspektimit.

Ndërkohë, inspektimet e programuara dhe inspektimet tematike paraqesin një raport më të moderuar të masave administrative, duke reflektuar karakterin e tyre më të parashikueshëm dhe orientimin drejt parandalimit dhe përmirësimit gradual të përputhshmërisë ligjore.

ANALIZA E GJOBAVE DHE SHPËRNDARJA E TYRE

Gjatë vitit 2025 janë vendosur 268 gjoba, për 285 shkelje të dispozitave ligjore, duke reflektuar raste ku ndaj një subjekti janë konstatuar më shumë se një shkelje. Vlera totale e gjobave të vendosura arrin në 64,584 mijë lekë, me përqendrimin më të madh në Rajonin Tiranë, i ndjekur nga Shkodra, Korça dhe Vlora. Ky shpërndarje pasqyron si intensitetin e veprimtarisë inspektuese, ashtu edhe kompleksitetin e shkeljeve të konstatuara në këto rajone.

Rajoni /Sektori i Inspektimit	Nr. Inspektive	Gjobë	Vlerë (000) Lekë
Rajoni I - Tiranë	5,269	126	23,274
Sek.Insp Tiranë	4,359	97	18,920
Sek.Insp Durrës	910	29	4,354
Rajoni II - Vlorë	954	34	9,730
Sek.Insp Berat	200	9	4,600
Sek.Insp Fier	318	7	2,180
Sek.Insp Vlorë	436	18	2,950
Rajoni III - Dibër	407	16	6,100
Sek.Insp Dibër	265	12	4,200
Sek.Insp Kukës	142	4	1,900
Rajoni IV - Korçë	1,362	56	8,270
Sek.Insp Korçë	705	26	2,950
Sek.Insp Elbasan	657	30	5,320
Rajoni V - Shkodër	720	23	15,260
Sek.Insp Shkodër	405	13	7,520
Sek.Insp Lezhë	315	10	7,740
Rajoni VI - Gjirokastrë	710	7	650
Sek.Insp Gjirokastrë	523	7	650
Sek.Insp Sarandë	187	0	0
Drejtoria Qëndrore	110	6	1,300
TOTALI	9,532	268	64,584

Tabela: Masa Administrative “Gjobë”, sipas Rajoneve/Sektorëve të Inspektimit

Në tërësi, analiza e masave administrative për vitin 2025 tregon një qasje të konsoliduar, proporcionale dhe të targetuar të Inspektoratit, e cila kombinon masa parandaluese dhe ndëshkuese në funksion të mbrojtjes së punëmarrësve, rritjes së sigurisë në vendin e punës dhe forcimit të zbatimit të legjislacionit të punës.

TIPOLOGJIA E SHKELJEVE TË SANKSIONUARA ME GJOBË

Gjatë vitit 2025, Inspektorati Shtetëror i Punës ka marrë gjithsej 268 vendime përfundimtare me gjobë, si rezultat i shkeljeve të konstatuara gjatë procesit inspektues, kryesisht në zbatim të Kodit të Punës dhe ligjit nr. 10237/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, si dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi. Këto vendime përfaqësojnë ndërhyrjen ndëshkuese të institucionit në rastet kur shkeljet kanë qenë të rënda, të përsëritura ose me ndikim të drejtpërdrejtë në të drejtat e punëmarrësve dhe sigurinë në vendin e punës.

Në aspektin tematik, shkeljet e sanksionuara me gjobë lidhen kryesisht me pagesën e punës dhe garantimin e të drejtave ekonomike të punëmarrësve, përfshirë mënyrën dhe afatet e pagesës së pagës, respektimin e pagës minimale, përlllogaritjen e saktë të pagës për orët shtesë dhe punën në ditë pushimi. Një peshë e konsiderueshme e shkeljeve lidhet gjithashtu me formalizimin e marrëdhënieve të punës, veçanërisht me mungesën ose formën jo të rregullt të kontratës individuale të punës, si dhe me ndryshime të njëanshme të kushteve të punës. Një tjetër grup i rëndësishëm shkeljesh përfshin detyrimet e punëdhënësve në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, ku janë evidentuar mangësi në marrjen e masave mbrojtëse kolektive dhe individuale, moszbatim të kërkesave minimale të sigurisë në vendin e punës, si dhe mosrespektim të detyrimeve për parandalimin dhe raportimin e aksidenteve në punë. Këto shkelje kanë impakt të drejtpërdrejtë në jetën dhe shëndetin e punëmarrësve dhe për këtë arsye janë trajtuar me masa ndëshkuese.

Në aspektin procedural, 100% e subjekteve ndaj të cilave janë vendosur gjoba janë njoftuar për vendimin përfundimtar, duke e bërë atë titull ekzekutiv, çka dëshmon një proces të konsoliduar, transparent dhe ligjërisht të sigurt të komunikimit administrativ. 74% e vendimeve janë njoftuar përmes dorëzimit personal, metodë që garanton komunikim të drejtpërdrejtë, efikas dhe shmangie të pasigurive procedurale.

SHPËRNDARJA E SHKELJEVE SIPAS AKTEVE LIGJORE

Analiza e vendimeve me gjobë sipas akteve ligjore të shkelura tregon se Kodi i Punës përbën bazën kryesore të sanksioneve, me 57% të totalit të gjobave. Kjo pasqyron faktin se problematikat më të shpeshta lidhen me marrëdhëniet individuale të punës, pagesën, orarin, pushimet dhe formalizimin kontraktual.

Një peshë e konsiderueshme e gjobave është vendosur për shkelje të ligjit nr. 10237/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i cili përfaqëson 20 % të totalit. Ky tregues konfirmon se siguria dhe shëndeti në punë mbetet një nga fushat më problematike dhe me risk të lartë, ku kërkohet ndërhyrje e vazhdueshme inspektuese dhe ndëshkuese.

Shkeljet e ligjit nr. 9634 “Për inspektimin në punë” përbëjnë 11% të gjobave dhe lidhen kryesisht me mosrespektimin e detyrimeve procedurale ndaj inspektimit, pengimin e veprimtarisë inspektuese ose moszbatimin e masave të lëna nga inspektorët e punës.

Një pjesë më e vogël e gjobave lidhet me shkelje të ligjit nr. 9136/2003 për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (4.5%), duke reflektuar raste të mospagimit ose deklarimit të pasaktë të kontributeve, që cenojnë drejtpërdrejt të drejtat sociale të punëmarrësve.

Në nivel aktesh nënligjore, gjobat janë vendosur edhe për shkelje të rregulloreve specifike në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, përfshirë:

- VKM nr. 1012 për sinjalizimin në kantier dhe vendin e punës (0.7%),
- VKM nr. 564/2013 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës (1.4%),
- VKM nr. 563/2013 për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale (2.1%),
- VKM nr. 562/2013 për përdorimin e pajisjeve të punës (1.7%),
- VKM nr. 312/2010 për sigurinë në kantier (0.3%),
- VKM nr. 639/2016 për ekzaminimet mjekësore dhe shërbimin mjekësor në punë (0.3%).

Edhe pse në përqindje më të ulëta, këto shkelje kanë rëndësi të veçantë, pasi lidhen me standarde teknike specifike të sigurisë, moszbatimi i të cilave mund të çojë në aksidente serioze dhe pasoja të rënda për jeten.

Në tërësi, tipologjia e shkeljeve të sanksionuara me gjobë gjatë vitit 2025 tregon se ndërhyrja ndëshkuese e **ISHPSHSH**-së është e fokusuar në mbrojtjen e të drejtave themelore të punëmarrësve dhe në garantimin e kushteve të sigurta të punës, duke ruajtur një balancë ndërmjet respektimit të ligjit, parandalimit të shkeljeve dhe forcimit të kulturës së përputhshmërisë ligjore në tregun e punës.

ASISTENCA TEKNIKE, MBËSHTETJA METODOLOGJIKE DHE UNIFIKIMI I PRAKTIKËS INSPEKTUESE

Gjatë vitit 2025, **ISHPSHSH** ka ndjekur një qasje të konsoliduar dhe sistematike në ofrimin e asistencës teknike, metodologjike dhe ligjore për strukturat inspektuese në nivel qendror dhe rajonal, me synim rritjen e cilësisë së veprimtarisë inspektuese, unifikimin e praktikave administrative dhe garantimin e zbatimit të njëtrajtshëm të legjisllacionit të punës, si dhe të kuadrit të sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo mbështetje ka shërbyer si instrument i drejtpërdrejtë për forcimin e standardeve të procesit, rritjen e sigurisë juridike të vendimmarrjes dhe uljen e riskut të praktikave jo të njëjta ndërmjet strukturave.

Asistenca teknike është materializuar kryesisht përmes udhëzimeve të brendshme, interpretimeve ligjore, shkresave orientuese, dokumenteve shpjeguese dhe standardizimit të praktikave procedurale, të cilat kanë funksionuar si bazë reference për trupën inspektuese dhe strukturat drejtuese rajonale. Në këtë kuadër, një fokus i veçantë i mbështetjes ka qenë adresimi i problematikave që lidhen me format e reja të punësimit (p.sh. puna në distancë/telepuna), ku janë dhënë sqarime mbi trajtimin e orëve jashtë orarit, ditëve festive, kompensimeve dhe rolit të kontratës së punës në përcaktimin e kushteve specifike të marrëdhënies së punës.

Paralelisht, strukturat janë orientuar drejt unifikimit të praktikës administrative dhe procedurale, veçanërisht në elementë kyç si: njoftimi i akteve të inspektimit, standardet e komunikimit administrativ me subjektet, procedurat e ankimit administrativ, si dhe ekzekutimi i masave administrative. Kjo linjë pune ka synuar rritjen e transparencës, parashikueshmërisë dhe sigurisë juridike, duke forcuar gjithashtu konsistencën e vendimmarrjes në raport me subjektet dhe reduktimin e hapësirave për interpretime të ndryshme në praktikë.

Në të njëjtën kohë, mbështetja metodologjike është përdorur edhe për të konsoliduar rolin parandalues të inspektimit, përmes komunikimeve informuese dhe udhëzimeve për fushata parandaluese, duke orientuar veprimtarinë drejt një qasjeje të balancuar: jo vetëm sanksionuese, por edhe edukative dhe këshilluese. Kjo qasje është e rëndësishme sidomos në sektorët me risk të lartë, ku ndërhyrja e hershme dhe standardizimi i kërkesave minimale mund të ndikojnë drejtpërdrejt në uljen e rreziqeve dhe shkeljeve të përsëritura.

Një dimension i rëndësishëm i asistencës ligjore ka qenë edhe përafrimi me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe detyrimet e raportimit, duke reflektuar rekomandimet e mekanizmave ndërkombëtarë (përfshirë CCPR) në fusha të ndjeshme si parandalimi i trafikimit të qenieve njerëzore, format më të këqija të punës së fëmijëve dhe mbrojtja e grupeve vulnerabël. Në këtë drejtim, mbështetja ligjore ka shërbyer si urë lidhëse ndërmjet praktikës inspektuese dhe detyrimeve ndërkombëtare të shtetit.

Në funksion të tranzicionit institucional, **ISHPSHSH** ka ofruar orientim të vazhdueshëm për zbatimin e kuadrit të ri të inspektimit, të sjellë nga ligji nr. 99/2024 dhe aktet shoqëruese, me synimin që ndryshimet të aplikohen pa ndërprerë funksionimin e veprimtarisë inspektuese dhe pa krijuar paqartësi operative. Kjo mbështetje është plotësuar edhe me kontributin në dokumente strategjike kombëtare, përfshirë Dokumentin e Politikave për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe Planin e Veprimit 2025–2030, ku janë reflektuar problematikat reale të evidentuara në terren dhe janë përkthyer në objektiva dhe masa konkrete institucionale.

Në tërësi, asistenca teknike dhe metodologjike e ofruar gjatë vitit 2025 ka funksionuar si instrument kyç për forcimin e kapaciteteve institucionale, rritjen e profesionalizmit të inspektorëve, standardizimin e praktikave inspektuese dhe konsolidimin e rolit të Inspektoratit të Punës si autoritet qendror mbikëqyrës, këshillues dhe garantues i zbatimit të ligjit në tregun e punës.

KONTRIBUTI NË HARTIMIN DHE PËRMIRËSIMIN E KUADRIT LIGJOR DHE NËNLIGJOR

Gjatë vitit 2025, **ISHPSHSH** ka luajtur një rol aktiv në proceset ligjore dhe nënligjore, duke sjellë një qasje të bazuar në përvojën praktike të zbatimit të legjisllacionit dhe në nevojat reale të terrenit. Ky kontribut ka synuar rritjen e zbatueshmërisë së akteve, qartësimin e paqartësive normative dhe standardizimin e procedurave, në funksion të një inspektimi më efektiv dhe të një vendimmarrjeje më të qëndrueshme.

Në nivel të hartimit dhe shqyrtimit të akteve, institucioni ka dhënë mendime mbi projektligjin e inspektimit në RSH, si dhe ka kontribuar me vlerësime për një numër të konsiderueshëm aktesh nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 99/2024. Paralelisht

ka marrë pjesë në hartimin e projekt-VKM-së për krijimin dhe organizimin e Inspektoratit Qendror të Punës (IQP), si dhe në përgatitjen e Urdhrit të Kryeministrit për strukturën dhe organikën e IQP-së, duke garantuar që arkitektura institucionale dhe rolet të jenë të qarta, funksionale dhe të zbatueshme në praktikë.

Kontributi ligjor është shtrirë edhe në fusha të ndërlidhura me standardet e të drejtave të njeriut dhe detyrimet ndërkombëtare, përmes vlerësimeve të drafteve për mbrojtjen e viktimave të trafikimit, sinjalizuesve, barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës në familje, si dhe në dokumente strategjike si Dokumenti i Politikave për SSHP. Në këtë linjë, janë adresuar edhe nisma të tjera ligjore me ndikim në tregun e punës, përfshirë kontribute në projektligje për nxitjen e punësimit dhe për kuadrin e të huajve, duke reflektuar nevojën për përputhshmëri me realitetin e tregut dhe dinamikat e punësimit.

Përtej pjesëmarrjes në hartime, **ISHPSHSH** ka ofruar sugjerime konkrete për përmirësimin e zbatueshmërisë praktike dhe harmonizimin e kuadrit ligjor, duke identifikuar paqartësi dhe mospërputhje që krijojnë vështirësi në zbatim. Shembuj tipikë janë çështje që lidhen me ndërveprimin e akteve të vjetra (p.sh. VKM nr. 356/1996) me dispozita të Kodit të Punës (p.sh. neni 70), ku është rekomanduar ndërhyrje për përafrim me kushtet aktuale të tregut të punës dhe praktikën administrative. Kjo qasje synon që legjislacioni të jetë jo vetëm formal, por edhe i aplikueshëm dhe i kuptueshëm për subjektet dhe punëmarrësit.

Në funksion të standardizimit procedural, është përforcuar edhe linja e dokumenteve udhëzuese për elementët kritikë të procesit: njoftimin e akteve të inspektimit, shqyrtimin e ankimeve administrative dhe përdorimin e masave urgjente. Këto ndërhyrje kanë ndihmuar në unifikimin e praktikës dhe në rritjen e cilësisë së dokumentacionit administrativ, duke forcuar qëndrueshmërinë e vendimeve edhe në rastet e kontestimit administrativ apo gjyqësor.

Në përfundim, kontributi i Inspektoratit të Punës në vazhdim ka qenë i orientuar drejt përputhshmërisë me legjislacionin kombëtar, standardet ndërkombëtare dhe nevojat praktike të inspektimeve, duke e vendosur institucionin si aktor të rëndësishëm në përmirësimin e kuadrit rregullator të tregut të punës.

ANKIMIMI ADMINISTRATIV I VENDIMEVE PËRFUNDIMTARE TË INSPEKTIMIT

Pasqyra e ankimeve administrative ndaj vendimeve përfundimtare të inspektimit për vitin 2025 tregon një vijimësi të trendit pozitiv të konsoliduar në vitet e fundit, duke reflektuar rritjen e pranueshmërisë së vendimmarrjes inspektuese dhe forcimin e besimit të subjekteve ndaj procesit. Ruajtja e kurbës në ulje të ankimeve gjatë vitit 2024 dhe vijimi i këtij trendi edhe në vitin 2025 lidhen drejtpërdrejt me përmirësimin e komunikimit me subjektet, transparencën procedurale, si dhe me rritjen e standardeve profesionale të dokumentimit dhe arsyetimit të vendimeve.

Në veçanti, ankimi i vetëm 21% të vendimeve me gjobë në vitin 2025 përbën një nivel dukshëm të ulët krahasuar me vitet e mëparshme. Evolucionin e kësaj treguesi në kohë rezultojnë 64% në vitin 2020, 36% në 2021, 30% në 2022 dhe 2023, si edhe 21% në 2024, për

të vijuar në të njëjtin nivel edhe në vitin 2025 që dëshmon për një prirje afatgjatë në rënie të kontestimit administrativ. Ky zhvillim tregon jo vetëm rritje të pranueshmërisë së masave ndëshkuese, por edhe një konsolidim të marrëdhënies institucionale ndërmjet subjekteve dhe **ISHPSHSH**-së, ku procesi inspektues perceptohet gjithnjë e më shumë si i bazuar në standarde të qarta ligjore dhe profesionale. Sipas të dhënave të regjistrit të Komisionit të Ankimit pranë **ISHPSHSH**-së, gjatë vitit 2025 janë shqyrtuar gjithsej 28 ankime ndaj vendimeve përfundimtare të inspektimit, nga të cilat:

- 19 vendime janë lënë në fuqi;
- 8 vendime janë ndryshuar;
- 1 vendim është shfuqizuar.

Raporti i vendimeve të lëna në fuqi, në krahasim me ato të ndryshuara, tregon se vendimmarrja inspektuese është e qëndrueshme dhe e argumentuar, ndërkohë që rastet e ndryshimit ose shfuqizimit dëshmojnë funksionimin të mekanizmit rishikues si instrument garantues i ligjshmërisë dhe proporcionalitetit.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 99/2024, sistemi i trajtimit të ankimeve pëson një riorganizim institucional, pasi Komisioni i Shqyrtimit të Ankimit qëndron pranë Inspektoratit të Përgjithshëm dhe do të shqyrtojë ankimet administrative. Ky ndryshim përbën një arkitekturë të re të ankimit administrativ, e cila pritet të standardizojë më tej praktikën, të rrisë uniformitetin e vendimmarrjes dhe të forcojë garancitë procedurale.

Paralelisht, vihet re edhe një rënie e ndjeshme e numrit të vendimeve të ankimuara në gjykatë, nga 20 raste në vitin 2024 në 9 raste aktualisht, tendencë që reflekton përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes administrative dhe rritjen e besueshmërisë institucionale. Në tërësi, këto të dhëna konfirmojnë kalimin gradual nga një model më konfliktual i marrëdhënies institucion-subjekt, drejt një modeli më bashkëpunues, të bazuar në profesionalizëm, transparencë dhe besim institucional.

PROCESET GJYQËSORE

Në vijim të veprimtarisë administrative, **ISHPSHSH** ka vijuar edhe ndjekjen e proceseve gjyqësore si pjesë e mbrojtjes së interesit publik dhe garantimit të ligjshmërisë së veprimtarisë inspektuese. Gjatë vitit 2025, Sektori i Çështjeve Ligjore ka realizuar përfaqësimin ligjor të institucionit në gjithsej 72 procese gjyqësore, të ndara si më poshtë:

- 51 çështje me objekt ankime ndaj vendimeve përfundimtare të inspektimit;
- 4 çështje që lidhen me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës nga stafi i **ISHPSHSH**-së;
- 17 çështje ku **ISHPSHSH** ka marrë pjesë si palë e tretë në procese civile.

Në këto procese, gjykatat kanë vendosur:

- 25 çështje me rrëzim të kërkesë-padisë, ku **ISHPSHSH** është shpallur palë fituese (vendime të formës së prerë);
- 5 çështje me pranimin e kërkesë-padisë, ku **ISHPSHSH** ka humbur procesin;
- 42 çështje janë ende në proces gjyqësor.

Fakti që në rreth 90% të rasteve të përfunduara, gjykata ka vendosur në favor të ISHPSHSH-së (krahasuar me 77% në vitin 2023 dhe 89% në vitin 2024) dëshmon një forcim të qëndrueshëm të cilësisë së përfaqësimit ligjor dhe profesionalizmit institucional. Ky progres lidhet drejtpërdrejt me përmirësimin e standardeve të procesit inspektues, rritjen e cilësisë së vendimmarrjes administrative dhe asistencën juridike sistematike të ofruar për trupën inspektuese, duke ndikuar në përgatitjen më të saktë të akteve dhe mbrojtjen më solide të tyre në gjykatë.

Ndjekja e strukturuar e proceseve gjyqësore reflekton përkushtimin institucional për garantimin e ligjshmërisë administrative, mbrojtjen e interesit publik dhe zbatimin e drejtë të legjisllacionit në fuqi.

EKZEKUTIMI I GJOBAVE


Në vijim të vendimmarrjes administrative, një element kyç i efektivitetit institucional është ekzekutimi i dënimeve me gjobë. Gjatë vitit 2025, ISHPSHSH ka konsoliduar procesin e vënies në ekzekutim të gjobave, përmes bashkëpunimit të strukturuar ndërmjet Sektorit të Çështjeve Ligjore, Komisionit të Ankimit dhe Drejtorive Rajonale. Në këtë kuadër, janë ndjekur në proces ekzekutimi 100% e gjobave të vendosura, ndërsa janë likuiduar 45% e gjobave të vitit 2025, me një vlerë prej 19,530,000 Lekë + 35,950 Lekë kamata. Ky rezultat reflekton një performancë të qëndrueshme krahasuese, në raport me vitet e mëparshme (41% në vitin 2023 dhe 46% në vitin 2024), duke dëshmuar stabilitet të mekanizmave të ndjekjes dhe arkëtimit. Paralelisht, gjatë vitit 2025 janë arkëtuar edhe 78 gjoba të viteve të shkuara, me vlerë 18,817,218 Lekë + 347,590 Lekë kamata, çka dëshmon funksionimin real të mekanizmave të ekzekutimit ndërvite. Në total, për vitin kalendarik 2025 rezultojnë të arkëtuara 196 gjoba me vlerë të përgjithshme 38,730,758 Lekë.

KOMUNIKIMI DHE INFORMIMI PUBLIK

Komunikimi dhe informimi publik përbëjnë elementë thelbësorë të veprimtarisë së Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore duke garantuar transparencën institucionale dhe ndërtimin e marrëdhënieve të drejtpërdrejta me publikun. Përmes kanaleve tradicionale dhe digjitale të komunikimit si faqja zyrtare, rrjetet sociale dhe media audiovizive, ISHPSHSH informon dhe ndërgjegjëson punëmarrësit dhe punëdhënësit mbi të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga legjisllacioni i punës, si dhe mbi rëndësinë e respektimit të standardeve të sigurisë dhe shëndetit në punë. Gjatë vitit 2025, komunikimi institucional u konkretizua përmes:

- informimit të 19679 subjekteve ekonomike të reja, nëpërmjet platformës e-Albania, mbi detyrimet ligjore në fushën e punës;
- realizimit të 166 postimeve informuese në rrjetet sociale, dhe
- 13 prezencave televizive, me fokus punën e denjë, sigurinë dhe shëndetin në punë.





ZGJIDHJE DIXHITALE PËR TË PËRBALLUAR SFIDAT

2017 e-inspection

2021 Matrica e Penaliteteve

2024 **MIRA**
Matrica e Inteligjencës & Analizës së Riskut

abcnews.al


LUFTA NDRYSHJE ME INFORMALITETIN
 MUÇAJ: PERZGJEDHJA DO REALIZOHET NE BAZE TE SEKTOREVE PROBLEMATIKE

Livestream worldwide: abcnews.al/live

FUSHATA NDËRGJEGJËSUESE DHE AKTIVITETE ME IMPAKT

Gjatë vitit 2025, ISHPSHSH ka qenë aktiv në organizimin dhe zbatimin e fushatave ndërgjegjësuese me impakt kombëtar dhe sektorial, ndër të cilat veçohen:

- Fushata e 28 Prillit – Dita Ndërkombëtare e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, në kuadër të së cilës u përgatitën dhe shpërndanë materiale informuese në të gjithë territorin e vendit, me angazhimin e plotë të trupës inspektuese.
- Fushata Evropiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2023–2025, nën sloganin “Vende pune të shëndetshme në epokën dixhitale”, ku ISHPSHSH, në bashkëpunim me MEKI dhe EU-OSHA, realizoi:
 - ▶ Vizita ndërgjegjësuese në 36 subjekte ndërtimi, ku u informuan 1,050 punëmarrës;
 - ▶ Vizita dhe takime informuese në 45 subjekte të sektorëve prodhim, shërbime dhe call-center, duke informuar 2,987 punëmarrës;
 - ▶ Aktivitete ndërgjegjësuese në 18 shkolla të formimit profesional, ku u informuan 1,716 nxënës.



ZHVILLIMI PROFESIONAL DHE FORCIMI I KAPACITETEVE TË STAFIT

Gjatë vitit 2025, ISHPSHSH ka vënë theks të veçantë në zhvillimin profesional të stafit dhe forcimin e kapaciteteve administrative dhe teknike, si një element thelbësor për përmirësimin e performancës institucionale, rritjen e cilësisë së inspektimit dhe garantimin e zbatimit efektiv të legjisllacionit të punës. Qasja e ndjekur ka qenë e strukturuar dhe e orientuar drejt nevojave reale të institucionit, duke kombinuar përditësimin e njohurive profesionale me zhvillimin e aftësive praktike dhe etike të punonjësve.

Trajnimet e realizuara gjatë vitit kanë përfshirë fusha të ndryshme, si zbatimi i legjisllacionit të shërbimit civil dhe Kodit të Punës, siguria dhe shëndeti në punë sipas standardeve evropiane dhe ndërkombëtare, etika institucionale, komunikimi administrativ, përdorimi i teknologjisë në inspektim dhe menaxhimi i procedurave administrative. Aktivitetet trajnuese janë zhvilluar si në formë modulare brenda institucionit, ashtu edhe në bashkëpunim me institucione dhe organizata kombëtare e ndërkombëtare, duke siguruar një qasje gjithëpërfshirëse dhe cilësore në ndërtimin e kapaciteteve njerëzore.

Një fokus i rëndësishëm i trajnimeve ka qenë forcimi i kapaciteteve profesionale të trupës inspektuese, veçanërisht në drejtim të përafrimit të praktikave kombëtare të inspektimit me standardet ndërkombëtare, rritjes së aftësive për identifikimin dhe parandalimin e rreziqeve të SSHP-së, si dhe trajtimin e çështjeve të ndjeshme si punësimi i punëtorëve migrantë, përdorimi i kimikateve të rrezikshme dhe ndikimi i ndryshimeve klimatike në sektorë me risk të lartë, si bujqësia dhe ndërtimi. Paralelisht, janë zhvilluar trajnime të dedikuara për etikën institucionale, udhëheqjen, kulturën organizative dhe komunikimin shkresor.

Tabela përmbledhëse e temave të trajnimeve të realizuara, së bashku me numrin e pjesëmarrësve dhe institucionet organizuese, pasqyron qartë shtrirjen dhe diversitetin e aktiviteteve trajnuese, si dhe angazhimin e gjerë të stafit në proceset e zhvillimit profesional. Trajnime si përmirësimet e aplikacionit mobile të inspektimit, kurikula themeltare për inspektorët e punës, komunikimi shkresor dhe trajnimi gjithëpërfshirës mbi etikën institucionale dhe kulturën organizative kanë përfshirë një pjesë të konsiderueshme të stafit, duke garantuar një ndikim të drejtpërdrejtë në funksionimin e përditshëm të institucionit. Paraqitja e të dhënave në formë tabelare me përqindje të stafit pjesëmarrës tregon nivelin e përfshirjes së burimeve njerëzore në trajnimet e zhvilluara gjatë vitit 2025. Përqindjet e larta të pjesëmarrjes në trajnime kyçe, si komunikimi shkresor (80%), përmirësimet e aplikacionit mobile të inspektimit (78%) dhe kurikula themeltare për inspektorët e punës (76%), dëshmojnë një përfshirje të gjerë dhe sistematike të stafit në proceset e rritjes profesionale. Këto tregues konfirmojnë se trajnimi nuk është trajtuar si proces sporadik, por si instrument strategjik për rritjen e kapaciteteve institucionale.

Rezultatet e këtyre aktiviteteve trajnuese kanë kontribuar në krijimin e një administrate më profesionale, më transparente dhe më të orientuar drejt rezultateve, duke forcuar aftësinë e stafit për të përballuar sfidat aktuale dhe të ardhshme të inspektimit të punës. Investimi i vazhdueshëm në zhvillimin profesional të punonjësve ndikon drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit organizativ, forcimin e etikës në punë dhe përshtatjen me ndryshimet ligjore dhe institucionale, duke garantuar një institucion më të përgjegjshëm, të qëndrueshëm dhe të aftë për realizimin e objektivave strategjike.

Nr.	Tema e Trajnimit	Data e Realizimit	Numri i Pjesëmarrësve	Përqindja e Stafit (%)	Institucioni Organizues
1	Përmirësime të aplikacionit mobile të inspektimit.	01/2025	120	78 %	Inspektorati Përgjithshëm
2	Etika në Institucion.	01/2025	3	2 %	IDM-DAP
3	Basic OSH legislation in the European Model.	03/2025	81	53 %	EU-OSHA
4	Rritja e kapaciteteve dhe kompetencave profesionale te inspektorëve dhe përafrimi i praktikave kombëtare të inspektimit me ato ndërkombëtare.	03/2025	41	27 %	ILO
5	Kurikula themeltare për inspektorët e punës.	03/2025	116	76 %	ASPA
6	Parandalimi i risqeve të SSHP-së që lidhen me kimikatet e rrezikshme në vendin e punës.	05/2025	46	30%	EU-OSHA
7	Forcimi i mekanizmave për mbrotjen e punëtorëve migrantë në Shqipëri dhe Rajon.	05/2025	40	26%	GIZ
8	Parandalimi i rreziqeve të SSHP-së që lidhen me ndryshimet klimatike në bujqësi dhe ndërtim.	10/2025	40	26%	EU-OSHA
9	Komunikimi shkresor në ISHPSHSH.	11/2025	117	80%	ISHPSHSH/ Burimet Njerzore
10	Trajnim dy ditor mbi etikën institucionale, udhëheqjen, kulturën organizative dhe analizën përmbyllëse vjetore	12/2025	100	66%	ISHPSHSH

Temat specifike me përqindje të pjesmarrjes



PROGRAMI I TRANSPARENCËS DHE ADMINISTRIMI I KËRKESAVE PËR INFORMIM

Në zbatim të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ISHPSHSH ka vijuar gjatë vitit 2025 zbatimin e Programit të Transparencës si një instrument thelbësor për garantimin e së drejtës së informimit të qytetarëve dhe subjekteve të interesuara mbi informacionin publik që disponohet prodhohet nga institucioni. Përmirësimi i aksesit në informacion dhe rritja e transparencës institucionale përbëjnë elementë kyç në forcimin e llogaridhënies publike, besueshmërisë dhe komunikimit të hapur me publikun. Programi i Transparencës është publikuar dhe përditësohet në mënyrë të vazhdueshme në faqen zyrtare të institucionit, ndërkohë që funksioni i Koordinatorit për të Drejtën e Informimit është i përcaktuar qartë dhe i aksesueshëm për publikun, në përputhje me kërkesat ligjore. Kanali zyrtar i komunikimit për kërkesat për informacion, përmes adresës elektronike të dedikuar, ka garantuar trajtimin korrekt, të dokumentuar dhe në afatet ligjore të çdo kërkesë të paraqitur.

Gjatë vitit 2025, pranë ISHPSHSH janë depozituar gjithsej 39 kërkesa për informacion, duke shënuar një rritje prej 22% krahasuar me vitin pararendës. Të gjitha kërkesat janë trajtuar brenda afateve ligjore dhe në përputhje të plotë me dispozitat e ligjit për të drejtën e informimit, duke reflektuar një funksionim të konsoliduar të mekanizmave të transparencës dhe një rritje të ndërgjegjësimit publik për të drejtën e informacion.

ROLI I SQDNE NË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMEVE ONLINE PËRMES PORTALIT “E-ALBANIA”

Në kuadër të digjitalizimit të shërbimeve publike dhe Reformës së Deregulimit, SQDNE luan një rol kyç në garantimin e funksionimit efikas, transparent dhe të standardizuar të shërbimeve online që ISHPSHSH ofron përmes portalit qeveritar e-Albania. Ky rol ka kontribuar ndjeshëm në përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve dhe subjekteve, si dhe në rritjen e efikasitetit administrativ të institucionit.

Koordinatori dhe procesuesi i platformës SQDNE sigurojnë që çdo aplikim i paraqitur nëpërmjet e-Albania të trajtohet në kohë, me saktësi dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, procedurat e brendshme dhe afatet e përcaktuara. Procesi i administrimit të aplikimeve përfshin një zinxhir të qartë veprimesh, që garanton gjurmueshmëri, përgjegjshmëri dhe transparencë në çdo fazë të trajtimit të kërkesës.

Në mënyrë të veçantë, SQDNE është përgjegjës për:

- marrjen, regjistrimin dhe sistemimin e të gjitha aplikimeve të depozituara përmes portalit e-Albania për shërbimet që ofron ISHPSHSH;
- orientimin dhe përcjelljen e kërkesave drejt strukturave përkatëse për trajtim;

- monitorimin e respektimit të afateve ligjore dhe procedurale për çdo shërbim;
- finalizimin dhe lëvrimin e përgjigjes përfundimtare ndaj aplikantit.

Ky mekanizëm ka garantuar një administrim më të strukturuar dhe të kontrolluar të shërbimeve online, duke reduktuar barrën administrative, rritur transparencën dhe përmirësuar ndjeshëm ndërveprimin e institucionit me qytetarët dhe subjektet ekonomike.

BUXHETI DHE MENAXHIMI FINANCIAR

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore financohet kryesisht nga buxheti i shtetit, i cili përbën instrumentin themelor për realizimin e politikave dhe objektivave institucionale, duke pasqyruar të ardhurat dhe shpenzimet për një periudhë të caktuar buxhetore. Për vitin 2025, institucionit i është akorduar një fond total prej 282,370 mijë lekë. Struktura e buxhetit reflekton natyrën e tij si shërbim publik me intensitet të lartë në burime njerëzore: 79% e fondit është orientuar për paga dhe sigurime shoqërore, 13% për mallra dhe shërbime, ndërsa 8% për shpenzime kapitale (investime). Kjo shpërndarje dëshmon se performanca institucionale lidhet drejtpërdrejt me mirëfunksionimin e trupës inspektuese dhe mbështetjes administrative, ndërkohë që hapësira për modernizim logjistik dhe teknologjik mbetet relativisht e kufizuar.

Në kuadër të pavarësisë së menaxhimit buxhetor dhe zbatimit të parimeve të transparencës financiare, zbatimi i buxhetit është realizuar në përputhje me Ligjin nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, si dhe udhëzimet standarde të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e buxhetit vjetor. Sipas të dhënave të realizimit (janar–dhjetor 2025), buxheti është realizuar në masën 99%, nivel që dëshmon një administrim të rregullt, kontroll të mirë të shpenzimeve dhe një planifikim funksional të nevojave operacionale. Në mënyrë të detajuar, paga dhe sigurimet janë realizuar në 100%, duke konfirmuar prioritetin institucional për stabilitetin e trupës inspektuese; mallrat dhe shërbimet janë realizuar në 93%, ndërsa investimet në 98%. Fondi i veçantë rezulton me realizim 43%, tregues që kërkon interpretim të kujdesshëm: Në praktikën buxhetore, mosrealizimi i plotë i këtij zëri lidhet me natyrën e tij kontingjente, pasi ai parashikohet për nevoja të paparashikuara ose për përdorim të kushtëzuar, si dhe me faktin që gjatë vitit buxhetor nuk janë krijuar situata të cilat kërkojnë përdorimin efektiv të këtij fondi.

EFIKASITETI I ZBATIMIT BUXHETOR DHE KUPTIMI INSTITUCIONAL I REALIZIMIT 99%

Realizimi në masën 99% i buxhetit për vitin 2025 dëshmon për një kapacitet të konsoliduar të strukturave përgjegjëse financiare në Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore në menaxhimin efektiv të fondeve dhe në mbështetjen e funksionimit të strukturave qendrore dhe rajonale. Ky nivel realizimi tregon se planifikimi buxhetor është bazuar në parashikime realiste dhe se angazhimet financiare janë ndjekur në mënyrë të kontrolluar, duke garantuar pagesa të rregullta, furnizime të nevojshme dhe realizimin e investimeve të planifikuara. Megjithatë, realizimi i plotë i buxhetit mbart edhe një dimension tjetër institucional. Në një institucion me kërkesë të lartë për ndërhyrje në terren dhe shtrirje operacionale kombëtare, niveli 99% shpesh reflekton përdorimin maksimal të fondeve për sigurimin e funksionimit bazë, duke lënë hapësirë të kufizuar për zgjerim kapacitetesh. Në këtë kuptim, ky tregues mbështet nevojën për burime financiare shtesë, veçanërisht në komponentin e investimeve dhe logjistikës, ku përmirësimi i mjeteve dhe infrastrukturës së punës ndikon drejtpërdrejt në cilësinë, efikasitetin dhe shtrirjen e veprimtarisë inspektuese.

INVESTIMET: RITJE FONDI DHE NDIKIM I DREJTPËRDREJTË NË KAPACITETE

Për vitin 2025, ISHPSHSH ka pasur të miratuar fond investimesh në vlerën 22,000 mijë lekë, (sipas tabelës), duke qenë niveli më i lartë i tre viteve të fundit. Rritja e fondit të investimeve është një sinjal pozitiv i orientimit drejt forcimit të kapaciteteve logjistike dhe teknologjike të inspektimit, veçanërisht në funksion të nevojave të terrenit dhe objektivave të lidhura me standardet e BE-së.

	2023	2024	2025
Buxheti miratuar	5,000 lekë	10,000 lekë	22,000 lekë

Realizimi i investimeve në masën 98%, i shoqëruar me përdorimin e fondeve për blerjen e 9 automjeteve, 36 tabletave dhe pajisjeve të tjera zyre, përbën një ndërhyrje me ndikim të drejtpërdrejtë në performancën institucionale. Automjetet kontribuojnë në rritjen e mbulimit territorial, ndërsa tabletat dhe pajisjet mbështetëse mundësojnë dokumentimin e inspektimit në kohë reale, raportimin e standardizuar dhe gjurmueshmërinë e proceseve inspektuese. Këto investime marrin rëndësi të veçantë në kushtet e digjitalizimit dhe të përdorimit të sistemeve elektronike të punës në terren, duke rritur efikasitetin, transparencën dhe cilësinë e veprimtarisë inspektuese.

Kodi	Emërtimi	Buxheti 2025	Plani 12-mujor	Fakti 12-mujor	Realizimi %
600+601	Paga & Sigurime	222,965	222,965	222,965	100%
602	Mallra Shërbime	36,957	36,957	34,382	93%
231	Investime	22,000	22,000	21,522	98%
606	Fondi i veçantë	448	448	191	43%
TOTALI		282,370	282,370	279,060	99%

TË ARDHURAT DYTËSORE: EKZEKUTIMI I GJOBAVE DHE DISIPLINIMI I TREGUT

Përveç fondeve buxhetore, institucioni gjeneron edhe të ardhura dytësore, kryesisht nga gjobat e ekzekutuara dhe kamatëvonesat. Për periudhën janar–dhjetor 2025, këto të ardhura arrijnë vlerën 39,471,947 (tridhjetë e nëntë milion e katërqind e shtatëdhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzet e shtatë) lekë, me komponentë kryesorë:

□ të ardhura nga gjobat	37,555,318 lekë
□ të ardhura nga kamatëvonesat	367,620 lekë
□ të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve	152,400 lekë
□ të ardhura të tjera (për plotësim)	1,796,609 lekë
□ sistemim llogarie	400,000 lekë

Rritja e të ardhurave nga gjobat, krahasuar me vitin 2024, reflekton forcimin e kapacitetit ekzekutiv të institucionit, përmirësimin e koordinimit institucional për ndjekjen e detyrimeve dhe efektin disiplinues të masave administrative ndaj subjekteve shkelëse. Këto të ardhura, ndonëse nuk zëvendësojnë financimin bazë nga buxheti i shtetit, përbëjnë një tregues të rëndësishëm të funksionimit efektiv të zinxhirit institucional duke dëshmuar rritjen e përgjegjshmërisë dhe zbatueshmërisë së vendimeve administrative.

PRIORITETET PËR 2026 DHE SFIDAT E MENAXHIMIT FINANCIAR

Në kuadër të përmbushjes së kërkesave të closing benchmark dhe objektivave të forcimit të sistemit të inspektimit të punës, fokusi për vitin 2026 mbetet rritja e investimeve në automjete, mjete pune dhe pajisje teknologjike për inspektorët, me qëllim garantimin e kapaciteteve logjistike dhe operacionale për inspektime të qëndrueshme në të gjithë territorin. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kushtet e rritjes së kërkesës për inspektim, kompleksitetit të tregut të punës dhe nevojës për dokumentim më të plotë, të shpejtë dhe cilësor në procesin inspektues.

Pavarësisht realizimit të lartë të buxhetit, sektori financiar përballet shpesh me sfida që ndikojnë në efektivitetin e funksionimit institucional. Këto sfida lidhen kryesisht me kufizimet e strukturës buxhetore (peshë e lartë e zërit personel), nevojat në rritje për logjistikë dhe shërbime mbështetëse, si dhe kërkesat procedurale për prokurime e ekzekutim shpenzimesh që mund të ndikojnë në ritmin e zbatimit. Në këtë kuadër, mbështetja e vazhdueshme financiare dhe rritja graduale e investimeve mbeten parakushte për rritjen e eficiencës dhe arritjen e objektivave operacionale të ISHPSHSH-së.

INSPEKTIMI I STANDARDEVE TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore merr një formë të re organizative dhe funksionale, duke reflektuar ndarjen e domosdoshme të fushave të inspektimit. Në këtë kuadër, inspektimi i punës konsolidohet si një strukturë e veçantë, në përputhje me standardet dhe praktikat ndërkombëtare, ndërsa inspektimi i standardeve të shërbimeve të kujdesit shoqëror ripozicionohet si fushë. Në zbatim të ligjit të ri, shkëputja funksionale dhe organizative e inspektimit të punës nga inspektimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror është e domosdoshme dhe e pashmangshme.

INSPEKTIMET E STANDARTEVE TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE – ANALIZË PËRMBLEDHËSE VITI 2025

Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Standardeve të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, ka vijuar ushtrimin e funksioneve të saj mbikëqyrëse si pjesë e ISHPSHSH-së, duke garantuar zbatimin e kërkesave ligjore dhe standardeve profesionale nga ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Veprimtaria inspektuese është përqendruar në ruajtjen e cilësisë së shërbimeve, mbrojtjen e të drejtave të përfituesve dhe forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe parandalimit. Gjatë vitit 2025 janë realizuar 134 inspektime në qendrat dhe shërbimet e përkujdesit shoqëror, duke tejkaluar mesataren vjetore prej 128 inspektimesh dhe duke shënuar rritje krahasuar me vitin 2024. Kjo ecuri dëshmon konsolidimin e veprimtarisë inspektuese dhe orientimin e saj drejt fushave prioritare për zhvillimin dhe garantimin e standardeve në sistemin e shërbimeve sociale.

Nr	Prioriteti	Aktiviteti	Rezultati
1	Forcimi i kapaciteteve inspektuese	Tryeza teknike dhe ëorkshop kombëtar për promovimin e rolit të inspektoriatit dhe rishikimin e standardeve	1 aktivitet
2	Garantimi i cilësisë së shërbimit të përkujdesit shoqëror	Takime vlerësuese me strukturat përgjegjëse në Bashki/Qark dhe aktorë të tjerë	45 takime
3	Inspektimi i ofruesve të shërbimeve shoqërore	Kontroll dhe vlerësim i qendrave të përkujdesit shoqëror	134 inspektime

Nga totali i inspektimeve, 119 ishin të planifikuara, të fokusuar kryesisht në qendrat e përkujdesit të mbështetura me Fond Social, si dhe në qendrat me historik inspektimi, ndërsa 15 inspektime u realizuan jashtë planit, si rezultat i ankesave dhe proceseve të liçensimit. Qendrat/Shërbimet e mbështetura me Fond Social vijojnë të përbëjnë indikatorin kryesor të zhvillimit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, duke përfaqësuar edhe prioritetin kryesor të kontrollit institucional. Krahasuar me vitin 2022, 2023, 2024, gjatë vitit 2025 numri i inspektimeve jepet si mëposhtë:

Viti	Numri i inspektimeve
2022	145
2023	108
2024	126
2025	134

Gjatë vitit 2025, drejtoria mori pjesë në tryezat dhe konsultimet kombëtare për hartimin e aktëve nënligjorë lidhur me organizimin, funksionimin dhe procesin e inspektimit të shërbimeve shoqërore. Po ashtu, u përfshi në konsultime me MSHMS-në për Planin Kombëtar të Veprimit për Moshimin 2025–2030.

GARANTIMI I CILËSISË SË SHËRBIMEVE DHE RITJA E ROLIT TË INSPEKTORATIT

- Janë realizuar 45 takime vlerësuese me strukturat përgjegjëse të shërbimeve sociale, të cilat shërbyen për:
 - ▶ Informimin mbi zbatimin e Ligjit Nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror”;
 - ▶ Mbledhjen e informacionit teknik dhe financiar mbi administrimin e shërbimeve;
 - ▶ Këshillimin mbi standardet e përkujdesit dhe praktikën e mira.
- Janë kryer 134 inspektime dhe vlerësime në qendrat dhe njësitë e shërbimeve sociale, duke kontrolluar përmbushjen e standardeve ligjore dhe profesionalizmin e ofruesve të shërbimeve.

Për sa i përket statusit të subjekteve të kontrolluara, edhe në vitin 2025 numri i subjekteve publike të inspektuara mbetet më i lartë se ai i subjekteve jopublike (70 publike kundrejt 58 jopublike). Megjithatë, diferenca është ngushtuar krahasuar me vitet pararendëse, si rezultat i rritjes së shërbimeve të financuara nga Fondi Social, të cilat klasifikohen kryesisht si shërbime publike.

Analiza sipas tipologjisë së shërbimit tregon se shërbimet komunitare përbëjnë fokusin kryesor të veprimtarisë inspektuese, duke zënë 77% të totalit të kontrolleve në vitin 2025. Ky orientim lidhet drejtpërdrejt me zgjerimin e shërbimeve komunitare të mbështetura me Fond Social, ku janë inspektuar 60 nga 68 shërbime ekzistuese (89%), si dhe me inspektimet e subjekteve jopublike të liçensuara për shërbime komunitare dhe veprimtari arsimore,

në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe QKB-në. Nga inspektimi i 121 Qendrave/Shërbimeve publike dhe jopublike, rezultoi se, në përgjithësi, kërkesat procedurale dhe standardet e miratuara janë respektuar. Megjithatë, u lanë 279 rekomandime/detyra me afate, të përqendruara kryesisht në çështje që lidhen me liçensimin, dokumentacionin e qendrës dhe të përfituesve, ekipin e profesionistëve, dosjet e stafit, mekanizmat e sigurisë dhe mbrojtjes, si dhe procesin e ankimeve.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet ecuria në numër dhe lloje përkujdesi të Qendrave/Shërbimeve të mbështetura me Fond Social.

Edhe për vitin 2025, numri i subjektet publike të kontrolluara është më i lartë se numri i subjekteve jopublike, (70 publike përkundrejt 58 shërbimeve jopublike), por krahasuar me 2 vitet pararendës, diferenca është ulur. Kjo ka ndodhur për të njëjtin faktor, Fondin Social, sepse është në rritje numri i Qendrave/Shërbimeve të klasifikuara shërbime Publike dhe për rrjedhojë edhe numri subjekteve publike të inspektuara në këto 4 vite në analizë.

Përsa i përket tipologjisë së përkujdesit, për vitin 2025 Qendrat/Shërbimet komunitare janë shërbimet më të kontrolluara, konkretisht ato janë në masën 77% të gjithë kontrolleve. Në tabelën në vijim paraqitet % e kontrolleve të ushtruara sipas tipologjisë së shërbimit.

Tipologjia e Shërbimit	2022	2023	2024	2025
Qendrat e përkujdesit rezidencial të inspektuara	25 %	20 %	27 %	19%
Qendra/shërbime e përkujdesit komunitar të inspektuara	63 %	69 %	66 %	77%
Qendra/shërbime emergjente të inspektuara	12 %	9 %	7 %	4%

INSPEKTIMET DHE SANKSIONIMET PËR VITIN 2025 NË FUSHËN E STANDARTEVE SHOQËRORE

Rritja e numrit të inspektimeve të shërbimeve komunitare në vitin 2025 (134 kontrolle gjithsej) është ndikuar kryesisht nga zgjerimi i shërbimeve të mbështetura me Fond Social, ku janë kontrolluar 60 nga 68 Qendra/Shërbime (89%). Një ndikim shtesë ka pasur edhe inspektimi i subjekteve jopublike të liçensuara për shërbime komunitare dhe veprimtari arsimore, që përbëjnë 15% të totalit të inspektimeve, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe QKB-në.

Propozim për revokim liçense: 13 subjekte jopublike, për ofrim të shërbimeve jashtë fushës së përkujdesit social.

Masa plotësuese: 2 propozime për lirim nga detyra për mungesë arsimit të punonjësve; 279 detyra me afate për të përmirësuar zbatimin e standarteve.

Çështja sipas standardit	Gjithsej detyra	Publikë	Jopublikë
Liçensimi	37	36	1
Aksesueshmëria	9	6	3
Ekipi profesionistësh	25	18	7
Mjedisi fizik	11	7	4
Dokumentacioni i Përfituesve	32	21	11
Dokumentacioni i Qendrës/Shërbimit	35	20	15
Siguria dhe mbrojtja	30	23	7
Ankime	40	31	9
Dosjet e stafit	45	26	19
Të tjera	15	11	4
Gjithësej detyra të lëna	279	199	80

Nga inspektimi i 121 Qendra/Shërbimeve publike dhe jopublike rezultoi se, përgjithësisht, janë respektuar kërkesat proceduriale dhe standardet, megjithatë janë lënë 279 rekomandime/detyra me afate, kryesisht për: liçensim, dokumentacion, ekipin e profesionistëve, dosjet e stafit, mekanizmat e sigurisë dhe mbrojtjes, si dhe procesin e ankimeve. Problematikat kryesore të identifikuar janë:

- Mungesa e liçensimit të Qendrave/Shërbimeve publike mbetet një problematikë e konstatuar, kryesisht për shkak të mosplotësimit të dokumentacionit dhe NIPT-it.
- Plani për plotësimin e vakancave për specialistë (Logoped, Psikolog, Fizioterapist) është ende një sfidë për Qendrat publike, sidomos për shërbimet për PAK.
- Rritja e shërbimeve të përkujdesit lëvizës ka ndikuar në vështirësinë e realizimit të të drejtës së ankimit, duke rekomanduar përdorimin e pyetësorëve periodik për përfituesit/familjarët.
- Shumica e rekomandimeve janë dhënë për shërbimet e reja ose për ato në transformim të modelit të përkujdesit, ku shpesh nuk është afishuar informacioni për përfituesit.

Drejtoria do të vazhdojë të mbajë kontakte dhe raporte këshillimi me strukturat përgjegjëse në nivel Bashkie, për të siguruar plotësimin e detyrave dhe garantimin e cilësisë së shërbimit. Drejtoria do të intensifikojë rolin këshillues dhe bashkëpunimin me strukturat përgjegjëse në nivel vendor dhe rajonal, me qëllim përmbushjen e detyrave të lëna dhe garantimin e cilësisë së shërbimeve. Njëkohësisht, do të vijoje forcimi i kapaciteteve inspektuese përmes kontributit në përmirësimin e kuadrit nënligjor dhe standardeve të përkujdesit shoqëror, duke synuar realizimin e të paktën 120 inspektimeve vjetore dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve për grupet në nevojë.

AKTIVITETE DHE PUBLIKIME

Komunikimi dhe informimi publik përbëjnë një komponent thelbësor të veprimtarisë së Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore në funksion të transparencës, ndërgjegjësimit dhe ndërtimit të marrëdhënieve të qëndrueshme me publikun, punëdhënësit, punëmarrësit dhe partnerët institucionalë. Gjatë vitit 2025, aktivitetet dhe publikimet janë fokusuar në promovimin e punës së denjë, respektimin e legjislacionit të punës dhe forcimin e kulturës së sigurisë dhe shëndetit në punë.

FUSHATA NDËRGJEGJËSUESE DHE INFORMUESE

Gjatë vitit janë zhvilluar fushata kombëtare dhe sektoriale ndërgjegjësuëse, ndër të cilat veçohet fushata e 28 Prillit – Dita Ndërkombëtare e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, si dhe zbatimi i Fushatës Europiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2023–2025. Aktivitetet janë shoqëruar me vizita në subjekte ekonomike, takime sensibilizuese dhe shpërndarje materiale informuese, duke përfshirë mijëra punëmarrës, nxënës të formimit profesional dhe subjekte të reja ekonomike.

KONFERENCA, TAKIME DHE BASHKËPUNIME INSTITUCIONALE


ISHPSHSH ka organizuar dhe ka marrë pjesë në konferenca, seminare dhe tryeza të rumbullakëta në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, me fokus sigurinë dhe shëndetin në punë, luftën kundër informalitetit dhe përafrimin me standardet e Bashkimit Evropian. Gjatë vitit janë forcuar bashkëpunimet ndërinstitucionale përmes nënshkrimit dhe zbatimit të marrëveshjeve të mirëkuptimit, duke kontribuar në ndërgjegjësimin e sektorëve specifikë dhe në përmirësimin e praktikave të punës.





PËRFAQËSIMI RAJONAL DHE NDËRKOMBËTAR

Institucioni ka përfaqësuar Shqipërinë në forume dhe platforma rajonale e ndërkombëtare, duke prezantuar përvojën dhe praktikën e inspektimit të punës, përfshirë zhvillimet në digjitalizim dhe inspektimet e bazuara në risk. Këto pjesëmarrje kanë kontribuar në shkëmbimin e praktikave të mira dhe forcimin e rolit të ISHPSHSH-së si aktor aktiv në proceset rajonale dhe evropiane të punësimit dhe mbrojtjes së të drejtave të punëmarrësve.



VLERËSIM PËRMBYLLËS

Në tërësi, aktivitetet dhe publikimet e vitit 2025 kanë rritur dukshmërinë publike të institucionit, kanë forcuar komunikimin me aktorët e tregut të punës dhe kanë mbështetur zbatimin efektiv të legjislacionit të punës dhe sigurisë e shëndetit në punë, duke përmbyllur raportin vjetor me një pasqyrë të angazhimit aktiv institucional.

SFIDA TË HASURA

Gjatë vitit 2025, ISHPSHSH është përballur me disa sfida strukturore, operative dhe institucionale, të cilat kanë ndikuar në ritmin dhe mbulimin e veprimtarisë inspektuese:

- Reforma e inspektorateve, ndonëse në proces, nuk është ende e konsoliduar plotësisht, duke reflektuar sfida në riorganizimin strukturor, proceduror dhe funksional të sistemit të inspektimit.
- Ndërgjegjësimi për zbatimin e ligjit dhe SSHP-në mbetet një sfidë e vazhdueshme, duke kërkuar fushata të qëndrueshme informimi dhe trajnime për punëdhënësit dhe punëmarrësit, veçanërisht në sektorët me risk të lartë.
- Kapacitetet inspektuese dhe logjistike kanë qenë të kufizuara, për shkak të mungesës së mjeteve operative, pajisjeve digjitale dhe nevojës për trajnime të specializuara, sidomos në ndërtim, miniera dhe shërbime.
- Vakancat në trupën inspektuese, me 7 pozicione rajonale të paplotësuara, kanë ndikuar në frekuencën dhe shtrirjen territoriale të inspektimeve, duke e bërë të domosdoshëm përshpejtimin e proceseve të rekrutimit.
- Inspektimi i subjekteve për herë të parë, si dhe mbikëqyrja e subjekteve me punëmarrës të huaj, ka kërkuar angazhim të shtuar, në kushtet e rritjes së këtij fenomeni dhe nevojës për garantimin e trajtimit të barabartë dhe ligjor.
- Monitorimi i kategorive vulnerabël, veçanërisht punëmarrësve nën 18 vjeç, ka kërkuar vëmendje të shtuar për parandalimin e shkeljeve dhe mbrojtjen e interesit më të lartë të të miturve.
- Moskonstituimi i Komisionit të Ankimit Administrativ pranë IP gjatë vitit 2025 ka sjellë vonesa në shqyrtimin e ankimeve, rrezik parashkrimi të gjobave dhe rritje të çështjeve të referuara drejtpërdrejt në gjykatë.
- Kufizimet buxhetore mbeten një sfidë e përsëritur, pasi fondet aktuale nuk mbulojnë plotësisht nevojat operative, investimet infrastrukturore dhe pajisjet bazë, duke e bërë të domosdoshme një rritje të qëndrueshme buxhetore në funksion të objektivave strategjike deri në vitin 2026.
- Moslicensimi i Qendrave/Shërbimeve publike të mbështetura me Fond Social vijon të jetë problematikë strukturore, kryesisht për shkak të dokumentacionit të pronësisë dhe mungesës së NIPT-it, çështje e adresuar edhe zyrtarisht pranë MSHMS-së.

Adresimi i këtyre sfidave mbetet prioritet institucional për ISHPSHSH, me synim forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve, rritjen e efektivitetit të inspektimeve dhe konsolidimin e një sistemi modern dhe funksional të inspektimit të punës.

OBJEKTIVAT KRYESORE STRATEGJIKE (2026)

Në vijim të reformës institucionale dhe hyrjes në fuqi të ligjit nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, objektivat e ISHPSHSH-së për vitin 2026 fokusohen në konsolidimin e modelit të ri të inspektimit, rritjen e cilësisë dhe efikasitetit të proceseve inspektuese, si dhe forcimin e rolit parandalues dhe mbikëqyrës të institucionit në tregun e punës.



FORCIMI I SISTEMIT TË INSPEKTIMIT TË PUNËS

Forcimi i kapaciteteve institucionale, njerëzore, digjitale dhe logjistike të Inspektoratit të Punës, me qëllim rritjen e efektivitetit, qëndrueshmërisë dhe profesionalizmit të veprimtarisë inspektuese në të gjithë territorin e vendit.



FINALIZIMI I REFORMËS SË INSPEKTIMEVE

Përmbyllja dhe zbatimi i reformës së inspektimeve përmes përshtatjes institucionale, duke përfshirë rishikimin dhe përmirësimin e strukturës organizative, procedurave operationale, manualeve të punës dhe çdo ndryshimi tjetër të nevojshëm që diktohet nga kuadri i ri ligjor dhe institucional.



INTEGRIMI NË BASHKIMIN EVROPIAN DHE ZHVILLIMI I STRATEGJIVE

Përmbushja e detyrimeve institucionale për raportim dhe monitorim në kuadër të Closing Bnechamrks, si dhe zbatimi i strategjive ndërsektoriale dhe sektoriale në fushën e punësimit, sigurisë dhe shëndetit në punë.



DIGJITALIZIMI I PROCESIT TË INSPEKTIMIT

Zhvillimi, ndërveprimi dhe përmirësimi i mëtejshëm i sistemeve digjitale, MIRA (Matrica e Inteligjencës dhe Analizës së Riskut) dhe e-Inspection, me qëllim rritjen e eficiencës, transparencës dhe cilësisë së inspektimeve të punës.

Inspektorati i Punës

+355 042 36 84 66



info@sli.gov.al



www.inspektoriatipunes.gov.al



Drejtoria Qëndrore :
Rruga “Sheh Ahmet Pazari”, Nr. 10, Tiranë